



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin tematik “Për verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E SHKAQEVE, PASOJAVE DHE REAGIMIT TË
INSTITUCIONEVE, LIDHUR ME SITUATËN E KRIJUAR NGA
PËRMBYTJET MASIVE NË QYTETIN E VLORËS”**

**BASHKIA VLORË
PREFEKTURA E QARKUT VLORË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE VLORË
DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT FIER
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE**

Tiranë 2025

I. PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA	4
II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
II.1 Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit.	12
III. HYRJE	12
3.1 Objektivat dhe qëllimi i auditimit:	13
3.2 Identifikimi i çështjeve.....	13
3.3 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.	13
3.4 Përgjegjësitë e audituesve.....	13
3.5 Kriteret e vlerësimit.	14
3.6 Standartet e auditimit.	14
3.7 Metodatat e auditimit	14
3.8 Dokumentimi i auditimit.....	14
IV. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	15
4.1 Bashkia Vlorë.....	15
4.2 Prefektura e Qarkut Vlorë	15
4.3 Këshilli i Qarkut Vlorë	19
4.4 Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë	19
4.5 Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier	22
4.6 Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Vlorë.....	29
4.7 Autoriteti Rrugor Shqiptar	37
4.8 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.....	45
4.9 Të ndryshme	56
4.10 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	56
4.11 Politikatat detyruese dhe detyrimet ndërkombëtare	57
4.12 Kuadri institucional	58
4.13 Situata në kontekstin kombëtar dhe rajonal.....	60
4.14 Përshkrimi i sistemit hidrik në zonën e përmytur	61
V. GJETJE DHE REKOMANDIME.....	63
VI. ANEKSET	73

Lista e shkurtimeve

AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
BE	Bashkimi Evropian
CBC	Bashkëpunimi Ndërkufitar
CECIS	Sistemi i Përbashkët i Komunikimit dhe Informacionit të Emergjencave
DSID	Desinventar Sistema de Inventario de Desastres (Sistemi i Inventarit të Fatkeqësive)
DPEC	Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (Paraardhësja e AKMC)
EERC	Kapaciteti Evropian i Përgjigjes Emergjente (European Emergency Response Capacity)
EM-DAT	Baza e të dhënave të ngjarjeve emergjente
ERCC	Qendra e Koordinimit të Përgjigjes Emergjente
FRB	Shpëtimi nga Përmbytjet duke përdorur Barkat
FRMP	Plani i Menaxhimit të Riskut të Përmbytjeve
GPMSZRF	Grupi i Punës për Monitorimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IGJEO	Instituti i Gjeoshkencave
IN	Instituti i Ndërtimit
INSTAT	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
IPA	Instrumenti i Ndhmës së Para Aderimit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KSZRF	Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MMC BE	Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së
MRF	Menaxhimi i riskut të fatkeqësive
MZSH	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
NDC	Kontributi i përcaktuar kombëtar (Nationally Determined Contribution)
OBM	Organizata Botërore e Meteorologjisë
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PDNA	Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësive
PEC	Planifikimi/plani i Emergjencave Civile
PHEOC	Qendra Operacionale Emergjente e Shëndetit Publik
PKEC	Plani Kombëtar për Emergjencat Civile
PNK	Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike
RBMP	Plani i Menaxhimit të Basenit Lumor
RESEAL	Forcimi i Aftësisë Ripërtëritëse në Shqipëri (Projekti i UNDP)
SKZRF	Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
SLR	Rritja e nivelit të detit (Sea-level rise)
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
SKMI	Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Incidentit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SËOT	Pikat e forta, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet
TESTA	Shërbimet Trans Evropiane për Telematikë midis Administratave
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNDRR	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime Projektsh
UPT	Universiteti Politeknik i Tiranës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKR	Vlerësimi Kombëtar i Riskut
VRF	Vlerësimi i Riskut të Fatkeqësive
ZRF	Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive

I. PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

“Basen ujqor” është sipërfaqja e tokës prej ku, përmes një numri përrrenjsh, lumenjsh apo edhe liqenesh, të gjitha rrjedhat sipërfaqësore derdhen në një lumë, i cili derdhet në det, në një grykëderdhje të gjerë të vetme, në një deltë apo në një lumë tjetër.

“Burime ujqore” janë të gjitha ujërat e brendshme detare, ujërat territoriale, vija bregdetare, zona ekonomike ekskluzive, shelfi kontinental, ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, së bashku me shtresat ujëmbajtëse, reshjet atmosferike, nën juridiksionin dhe kontrollin e Republikës së Shqipërisë.

“Burimet ujqore gjeotermale” janë ujërat që kanë temperatura vazhdimisht më të larta se temperaturat mesatare vjetore atmosferike të rajonit, me efektin e temperaturës së nëntokës, në varësi të strukturës gjeologjike, që mund të përmbajnë materiale të shkërra dhe gaz në një sasi më të lartë se burimet ujqore përreth, ku uji, avujt dhe gazi natyrshëm shpërthejnë ose nxirren nga vendet ku ato mbahen nëpërmjet ngrohjes nga nëntoka ose nga shkëmbinj të e thatë dhe të nxehtë, nëpërmjet strukturave nëntokësore të modifikuar nga njeriu.

“Burimet ujqore minerale dhe termominerale” janë ujërat e ngrohta dhe të ftohta natyrore që ndodhen natyrshëm në thellësi të ndryshme të nëntokës e në kushte të përshtatshme gjeologjike, që ndodhen ose janë nxjerrë në sipërfaqe të tokës më vete nga një ose shumë burime, që janë të përcaktuara nga përmbajtja e tyre minerale apo komponentë të tjerë, të tillë si uji i pijshëm, uji kurativ dhe emra të ngjashëm

“Kontrollet e shkarkimeve” janë kontrollet që kërkojnë një kufi specifik të shkarkimit, për shembull një vleftë kufi të shkarkimit ose ndryshe specifikimin e kufijve apo kushteve mbi efektet, natyrën ose karakteristika të tjera të një emisioni ose kushtet operacionale, të cilat ndikojnë në shkarkimet.

“Kufijtë territorialë të menaxhimit” janë kufijtë artificialë të miratuar për arsye menaxhimi, brenda të cilëve përfshihen një ose më shumë basene apo pjesë basenesh hidrografike.

“Lumë” është një trup ujqor i brendshëm, me ujë, që në pjesën më të madhe të tij rrjedh mbi sipërfaqen e tokës, por që në një pjesë të rrjedhës së tij mund të rrjedhë edhe nën tokë.

“Ndotës” është çdo substancë e rrezikshme që shkaktton ndotje, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

“Ndotje” është futja e drejtpërdrejtë ose jo, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit, sipas kuptimit të dhënë në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”

“Normë e cilësisë së mjedisit për ujërat” është përqendrimi i një substance ndotëse të veçantë ose i një grupi substancash ndotëse në ujë, në sedimente ose në biotë.

“Normë e cilësisë së ujërave nëntokësore” është norma mjedisore, teknike dhe shëndetësore që shprehet si përqendrim i një substance ndotëse të veçantë apo i një grupi substancash ndotëse ose si tregues i ndotjes së ujërave nëntokësore.

“Normë teknike e shkarkimit në mjedis” janë kufijtë e vlerave dhe të përqendrimeve të parametrave fiziko-kimikë të ujërave të ndotura industriale, të cilat derdhen në sistemin e kanalizimeve publike, sipas kuptimit të dhënë në vendimin nr. 1340, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës - kanalizimeve”

“Rezerva ujqore” janë të gjitha burimet ujqore sipërfaqësore dhe nëntokësore që gjenden brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë.

“Ujëra të ndotura” janë ato ujëra që janë përdorur për qëllime hidrosanitare dhe industriale, grumbullimi, përpunimi dhe largimi i të cilave është urdhëruar për shëndetin dhe komoditetin publik.

“Sektori i furnizimit me ujë” ka të bëjë me të gjitha veprimtaritë që kanë të bëjnë me grumbullimin, trajtimin dhe shpërndarjen e burimeve ujore për qëllime publike.

“Prodhimi i ujit” ka të bëjë me të gjitha burimet natyrore të ujit brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë shtresat ujëmbajtëse nëntokësore (akuaferet) dhe të gjitha burimet e tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore.

“Grumbullimi i ujit” ka të bëjë me të gjitha ato veprimtari që nëpërmjet strukturave apo mekanizmave të tillë, si: diga, puse, depo uji, cisterna, kanale, ujësjellësa, tubacione, kanale kulluese dhe kanalizime të ujërave të zeza grumbullojnë, kanalizojnë, ndryshojnë drejtimin apo nxjerrin ujin për përfitim publik.

“Shpërndarja e ujit” ka të bëjë me të gjitha veprimtaritë me anë të të cilave uji pompohet, transportohet dhe shpërndahet nga një vend në tjetrin për përfitim publik.

“Trajtimi i ujit” ka të bëjë me të gjitha metodat dhe mjetet, qofshin këto kimike, mekanike, elektrike etj., që përdoren për pastrimin apo ndryshimin e gjendjes së ujit për përfitim publik.

“Stacion pompash kullimi” është tërësia e pompave, të vendosura në grup apo të veçanta, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe aksesore të tjerë në funksion të tyre, që shërbejnë për kullimin e tokave.

“Vepra të mbrojtjes nga përmytja” janë pendë/argjinaturë të mbrojtjes nga përmytja dhe ndërtimet përgjatë lumenjve, bregdetit, përrenjve dhe rrjedhave të tjera ujore, kanaleve të ujërave të larta, kanale kullues për parandalimin nga përmytja dhe erozioni të tokave bujqësore dhe të zonave rurale.

“Zonë nën kullim” është një zonë e caktuar gjeografike që përfiton prej një sistemi kullimi.

“Zonë e shërbimit të ujitjes” është një zonë e caktuar gjeografike që furnizohet me ujë dhe përdor një ose disa sisteme ujitjeje.

“Sistem ujitjeje” është një rrjet kanalesh ujitëse, së bashku me veprat përkatëse hidroteknike, rezervuarët, digat, strukturat devijuese, stacionet e pompave, rrugë, ndërtesa të furnizuara nga një kanal parësor ose një rezervë ujore parësore, për ujitjen e një sipërfaqeje toke. Sistemi i ujitjes përfshin edhe tokën bashkëngjitur me kanalet e ujitjes, e cila është mbajtur nën pronësinë e shtetit për sigurimin e aksesit në kanale të tilla.

“Sistem kullimi” është një rrjet kullimi, me kanale të ndërtuara/tubacione dhe kanale natyrore, si dhe me veprat përkatëse hidroteknike, përfshirë stacionet e pompave të kullimit, rrugët dhe ndërtesat. Sistemi i kullimit shërben për të kulluar tokën, përfshirë edhe tokën bujqësore, rrugët dhe zonat urbane. Sistemi i kullimit përfshin edhe tokën bashkëngjitur me kanalet kulluese, të ndërtuara dhe ato natyrore, e cila është mbajtur në pronësinë e shtetit, për sigurimin e aksesit në kanale të tilla.

“Rezervuar” është rezervë artificiale uji, formuar nga akumulimi ose bllokimi i ujit me anë të një dige.

“Digë” ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 8681, datë 2.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”.

“Infrastruktura e ujitjes dhe e kullimit” janë asetet e patundshme, pjesë përbërëse të një sistemi ujitjeje apo kullimi.

“Infrastruktura kryesore e ujitjes dhe e kullimit” janë veprat kryesore hidroteknike të një sistemi ujitjeje apo kullimi.

“Ujërat e ndotura urbane” janë ujërat e përdorura që shkarkohen nga banesat dhe veprimtaritë e caktuara industriale, të cilat përmbajnë lëndë të tretura dhe lëndë në pezulli.

“Ujërat e ndotura shtëpiake” janë ujërat e përdorura të çdo lloji, me përbërje organike, të degradueshme, lëndë minerare në formë të tretur ose në pezulli, të shkarkuara nga instalimet hidraulike të çdo lloji.

“Ujërat e ndotura industriale” janë ujërat e përdorura nga veprimtaritë tregtare dhe industriale.

“Mjedis pritës” përfaqëson zonat e shkarkimit të ujërave të përdorura.

“Aglomerat-zonë urbane intensive” është një zonë ku popullsia dhe veprimtaria ekonomike ka një përqendrim të tillë, i cili bën të nevojshëm që shkarkimet e lëngëta urbane të

grumbullohen dhe të sistemohen në një pikë të vetme shkarkimi ose të futen në një impiant trajtimi.

“Sistemi kolektor” është sistem kanalizimesh, unik ose i ndarë, që grumbullon dhe sistemon shkarkimet e ujërave të ndotura urbane dhe industriale.

“Njëvlerës për popullsinë” është ndotja mesatare e derdhjes për banorë në ditë, që ka 90 gr/ditë lëndë në pezulli, 60 gr/ditë lëndë organike, 15 gr/ditë azot amoniakal dhe 4 gr/ditë fosfor.

“Trajtim parësor” është trajtimi i ujërave të përdorura, nëpërmjet procesit fizik me anë të dekantimit parësor, që mënjanon 60 për qind të lëndës në pezulli dhe 20 për qind të NBO5.

“Trajtim dytësor” është trajtimi i ujërave të ndotura nëpërmjet procesit biologjik, me shtratbakterial, basen ajrimi, llum aktiv, duke u shoqëruar, në raste të veçanta, me trajtim tretës (dekantim/filtrim), për realizimin e denitrifikimit dhe defosfatimit.

“Trajtim i përshtatshëm” është trajtimi i ujërave të ndotura urbane, nëpërmjet një procesi të dhënë, nga i cili rezulton që shkarkimet e lëngëta në ujërat pritëse nuk dëmtojnë cilësitë e këtyre ujërave, në përputhje me ligjin.

“Llum” është mbetja e ngurtë dhe gjysmë e ngurtë, që përftohet gjatë proceseve të trajtimit të ujërave të ndotura.

“Eutrofikim” është pasurimi i një ekosistemi ujor me lëndë ushqyese, veçanërisht, me përbërës azoti dhe fosfori dhe me prodhimtari të lartë biologjike, duke shkaktuar një rritje të vrullshme të algave dhe formave të larta të jetës bimore, të shoqëruara me ndryshime të cilësisë së ujit.

“Estuar” është zona kalimtare e ujërave sipërfaqësore në grykëderdhjen e lumit në det.

“Ujëra bregdetare” janë ujërat jashtë vijës së ujërave të ulëta ose ujërat jashtë kufijve të estuarit.

“Nevoja biologjike për oksigjen NBO5” është sasia e oksigjenit të konsumuar gjatë 5 ditëve nga bakteret aerobe në prani të ajrit. Ajo përfaqëson ndotjen organike të biodegradueshme.

“Zona të ndjeshme” janë zonat që përfshihen në liqenet natyrore me ujë të ëmbël; ujërat e ëmbla sipërfaqësore, të destinuara për nxjerrjen e ujit të pijshëm; grykëderdhjet, estuaret dhe ujërat bregdetare, të cilat janë përcaktuar si eutrofike, ose vlerësohen të mundshme për t'u bërë të tilla.

“Zonat më pak të ndjeshme” janë zonat që përfshihen: në gjiret e hapura, grykat dhe ujërat e tjera bregdetare me një shkëmbim të kënaqshëm të ujërave dhe që nuk janë subjekt ndaj eutrofikimit ose shterimit të oksigjenit, ose vlerësohen të vështira për t'u bërë eutrofike, si pasojë e shkarkimeve të ujërave të ndotura.

“Monitorimi” është grumbullimi, vlerësimi dhe përgjithësimi i të dhënave mjedisore me anë të vëzhgimit të vazhdueshëm ose periodik të një grupi treguesish mjedisorë, cilësorë dhe sasiorë, që karakterizojnë përbërësit e mjedisit dhe ndryshimet e tyre nga ndikimi i faktorëve natyrorë ose njerëzorë.

Shënim: Për përkufizimet janë përdorur: Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, i ndryshuar; Ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” dhe Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1191/8 prot; datë 10.10.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH^{ssë}, zhvilloi Auditimin Tematik me objekt, “Për verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës”.

Në përfundim të auditimit u konstatuan disa probleme konkretisht:

- Bashkisë Vlorë i janë transferuar disa kanale, të cilat janë jashtë territorit të Qytetit të Vlorës, si dhe i është transferuar vetëm godina e hidrovorit (si ndërtesë), ndërsa kanali që dërgon ujin tek hidrovori nuk është transferuar;
- Procesi i transferimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit ka mungesë të dokumentacionit teknik shoqërues në lidhje me kanalet, plan vendosjen, profilet gjatësore/tërthore të tyre, etj.;
- Hidrovori punon pa pompa rezervë, linja elektrike që furnizon me energji hidrovorin e Qytetit të Vlorës është e vjetër, mungon një gjenerator i dedikuar për emergjencat, niveli i tensionit në Hidrovorin Akërnë nuk është i qëndrueshëm, pasi në linjën e furnizimit të hidrovorit marrin energji subjekte private, duke ndikuar në uljen e kapacitetit të punës së hidrovorit;
- Kanalet kulluese KK2 Akërnë, KK3 Akërnë dhe KUL Orikum, rezultuan më shumë se 15 vjet të pa pastruara.

a. Përshkrim i shkurtër i institucioneve nën auditim

Auditimi Tematik me objekt, “Për verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës”, u zhvillua në subjektet si vijon:

1. Bashkia Vlorë;
2. Prefektura e Qarkut Vlorë;
3. Këshilli i Qarkut Vlorë;
4. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë;
5. Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Fier;
6. Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizime Vlorë;
7. Autoriteti Rrugor Shqiptar;
8. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;

Referuar objektit të auditimit institucionet e sipër përmenduar janë përgjegjëse për të zbatuar dispozitat ligjore lidhur me planifikimin e investimeve, mirëmbajtjen e rrjetit të kanaleve kulluese dhe stacioneve të pompimit, reagimin e strukturave përgjegjëse para, gjatë dhe pas përmbytjeve. Konkretisht:

1. Bashkia Vlorë

Në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27, përcaktohen funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e njërive të qeverisjes vendore, si dhe funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Referuar këtij ligji bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dytësore **dhe menaxhimin e kullimit**, për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe sigurinë e digave të rezervuarëve që përdoren për ujitje. Bashkitë kanë detyrë, në lidhje me sektorin e ujitjes dhe kullimit, pastrimin e kanaleve të para, të dyta dhe të treta, veprat e artit, rehabilitimin e tyre, pastrimin e rrjetit të kanaleve kulluese.

Me marrjen e inventarit fizik të kanaleve kulluese të dyta dhe treta, Bashkisë Vlorë, i janë shtuar detyrimet për administrimin e një territori mjaft të gjerë dhe me një kompleksitet të madh problematikash, në administrimin e ujërave. Për pjesën më të madhe të problematikave nuk mund të thuhet se varen direkt nga bashkia, **veçanërisht problemi i menaxhimit të përmbytjeve periodike**, shkarkimeve të kontrolluara dhe jo të ujërave të basenit të lumit Vjosë.

2. Prefektura e Qarkut Vlorë

Në ligjin nr. 107/2016 *“Për Prefektin e Qarkut”*, janë të përcaktuara misioni, përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat e Prefektit të Qarkut, marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe me organet e qeverisjes vendore. Konkretisht në nenin 13 janë përcaktuar detyra në lidhje me strukturat e mbrojtjes, ku përcaktohet *“...Në raste të veçanta, në përputhje me legjislacionin përkatës, u kërkon komandave të njësisë ushtarake në territorin e qarkut mbështetje për përballimin e detyrave me karakter civil dhe në veçanti në përballimin e situatave emergjente”*.

Prefekti i Qarkut Vlorë, ka kompetenca ligjore për të vepruar gjatë përmbytjeve masive të ndodhura në qytetin e Vlorës, përkatësisht, VKM-së nr. 329, datë 16.5.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*, Planit të Emergjencave Civile të Qarkut Vlorë, pika 2.1 ku përcaktohet se: *“Prefekti në rolin e kryetarit të komisionit të emergjencave civile, është përgjegjës për planizimin e emergjencave në shkallë qarku, duke koordinuar veprimet e të gjitha strukturat të cilat janë përfshirë në planin e emergjencave në nivel qarkut. Prefekti kërkon shpalljen e gjendjes së Emergjencave Civile në një pjesë ose në të gjithë territorin e Qarkut Vlorë”*.

3. Këshilli i Qarkut Vlorë

Nga shqyrtimi i detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, neni 72 deri neni 85, Kryetari dhe Këshilli i Qarkut Vlorë, nuk ka patur kompetenca ligjore për të vepruar gjatë përmbytjeve masive të ndodhura në qytetin e Vlorës.

4. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë

Spektori “Bordi i Ujitjes dhe Kullimit”, pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë, ushtron veprimtarinë e tij bazuar në ligjin nr. 24/2017 *“Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”*, Kreu IV *“Bashkitë”*, Udhëzimit nr. 12, datë 30.12.2019 *“Rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”*, ligjet për digat dhe dambat.

5. Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Fier

Drejtorja e Ujitjes dhe Kullimit Fier është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ushtron aktivitetin e saj bazuar në ligjin nr. 24/2017 *“Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”*, si dhe VKM-në nr. 437, datë 17.05.20217 *“Për krijimin, organizimin, dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe kullimit Lezhë, Durrës Fier dhe Korçë”*.

Struktura e DUK Fier është miratuar me Urdhrin e KM nr. 78, datë 07.05.2024 dhe ka në përbërje 3 sektorë kryesorë: Sektori i Financës, Sektori Teknik, Sektori Hidrovore – Makineri; si dhe ka, në varësi 4 sektorë rajonalë: Sektori Fier, Sektori Lushnjë, Sektori Vlorë-Sarandë dhe Sektori Gjirokastrë.

6. Ujësjellës - Kanalizime Vlorë

Shoqëria Ujësjellës - Kanalizime Vlorë SHA, funksionon në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”* dhe Rregullores së Brendshme të funksionimit. UKV SHA ka mbuluar me shërbim Vlorën, Novoselën, Orikuin dhe Shushicën. Gjatë vitit 2023, Sektori Ujësjellës - Kanalizime ka patur ndryshime thelbësore sa i përket riorganizimit dhe operimit të tij, në zbatim të VKM-së nr. 302, datë 11.05.2022 *“Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”*.

Sistemi i grumbullimit të ujërave në varësi të SHRUKV SHA përbëhet nga kanalet e ujërave të larta (sekondar dhe tercial) KUB, KUZ dhe Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN), stacionet e pompimit dhe hidrovorët e qyteti.

7. Autoriteti Rrugor Shqiptar

Në qytetin e Vlorës po zbatohet projekti By-Pass i Vlorës. Për zbatimin e këtyre punimeve është lidhur fillimisht kontrata me kompaninë “S. C.” S.P.A, e cila ka falimentuar dhe autoriteti kontraktor ka ndërprerë kontratën më 15.05.2017. Për përfundimin e këtij projekti, zbatimin e

punimeve, ARRSH ka lidhur kontratën nr. 9946, datë 08.11.2018 me BOE “G. 2” ShPK & “I. Di C.” Ing. E. M., me afat përfundimtar të punimeve 823 ditë (22 shkurt 2021 dhe afat të shtyrë deri më 30 qershor 2022). Afati i përfundimit të punimeve është ndryshuar dhe afati i fundit i miratuar është dhjetor 2024.

Supervizionimi dhe konsulenca e këtij projekti kryhet nga kompania BOE “E. O.” S.A & “P.” S.A, sipas kontratës fillestare të lidhur më datë 22.11.2013. Për shkak të pezullimit të punimeve me arsyen e ndërprerjes së kontratës me kontraktorin “S. C.” S.P.A, për shkak falimentimi të kësaj të fundit, kontratës së supervizionimi i janë bërë ndryshime, duke zgjatur afatin e saj.

8. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile (AKMC) është strukturë përgjegjëse për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në ligjinnr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, hartimi dhe miratimin i 3 (tre) dokumenteve të rëndësishëm në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile është bërë në nivel kombëtar dhe qendror:

- Strategjia Kombëtare e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë;
- Vlerësimi i Riskut në nivel qendror;
- Plani Kombëtar për Emergjencat Civile.

b. Rëndësia e institucioneve dhe auditimi i tyre

Si pjesë e task forcës së Grupit të Auditimit Mjedisor në Europë, KLSH vitet e fundit është fokusuar së tepërmi në vlerësimin e problemeve sociale që ndikohen nga mjedisi dhe duke patur parasysh trendin e problematikës që lidhet me përmbytjet në vendin tonë së fundmi, mori angazhimin të kryejë një auditim tematik me këtë fokus.

Përmbytjet në dimër dhe thatësira në verë sa vjen e janë bërë më prezente në Shqipëri, sidomos gjatë dy dekadave të fundit. Së fundmi, vihet re se situata më problematike paraqitet në zonat pranë lumenjve. Në Shqipëri rreth 130,000 ha janë të pajisur me infrastrukturë mbrojtëse për përmbytjet nga lumenjtë dhe deti. Sasia mesatare e reshjeve vjetore në Shqipëri shkon në 1,485 mm/vit. Ajo varion nga 1,000 mm/vit për zonat e ulëta deri në 3,000 mm/vit në zonat malore. Rreth 70% e sasisë totale vjetore të reshjeve bie në periudhën tetor – mars. Largimi i ujërave të përmbytjes është përkeqësuar për shkak të mbushjeve në kanalet kullues dhe uljes së kapacitetit largues të hidrovorëve. Pritet që situata të përkeqësohet akoma më shumë për shkak të ndryshimeve klimatike, të cilat reflektohen me fenomene moti ekstreme. Është vlerësuar se janë rreth 3285 ndërtime pa leje në infrastrukturën ujitëse, kulluese dhe të mbrojtjes nga përmbytja. Këto ndërhyrje ndikojnë negativisht në infrastrukturën e ujitje / kullimit apo mbrojtjes nga përmbytjet. Urbanizimi dhe ndërhyrjet njerëzore nga njëra anë, degradimi natyror i veprave nga ana tjetër, kanë bërë, që shumë prej veprave mbrojtëse të jenë jashtë funksionit apo gjysmë funksionale, në një mjedis ku frekuenca, ashpërsia dhe vendndodhjet e përmbytjeve po rriten. Përmbytjet e fundit në qytetin Vlorës nuk janë nga vërshimi i lumit Vjosë (ka dalë nga shtrati për herë të fundit në vitin 2021).

Gjatë viteve të fundit është vërejtur një boshllëk institucional në rritje për sa i takon faktit se cila strukturë është përgjegjëse për administrimin e sistemeve ujitës¹. Rëndësia e këtij auditimi ka të bëjë me vlerësimin e efektivitetit të politikave të hartuara në funksion të parandalimit dhe minimizimit të përmbytjeve, si dhe me nivelin e angazhimit dhe koordinimit të aktorëve të përfshirë në këtë çështje.

Auditimi i institucioneve të sipërpërmenduar ka një rëndësi të veçantë për të verifikuar shkaqet, pasojat dhe bashkëpunimin e institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës.

¹Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2023-2030.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i auditimit me objekt *“Për verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës”*, është nxjerrja e mangësive dhe problematikave të cilat shkaktuan përmbytjet në Qytetin e Vlorës, si dhe çfarë masash janë marrë nga institucionet përgjegjëse para dhe gjatë situatës së përmbytjeve.

d. Metodologjia dhe analizimi i të dhënave

Grupi i auditimit, për të realizuar objektin e auditimit, u fokusua në analizimin e çështjeve si vijon:

- Buxheti dhe planet e investimit të parashikuara nga institucionet e përfshira në këtë program auditimi, për përmirësimin e sistemit të kullimit, në zbatim të strategjive kombëtare për mbrojtjen civile. Investimet në ujitje, kullim dhe mbrojtjen nga përmbytjet, që janë realizuar në funksion të sigurimit të menaxhimit të qëndrueshëm dhe produktiv të sistemeve të ujitjes dhe kullimit, krahas me reduktimin e rrezikut nga përmbytjet;
- Dokumentimi i gjendjes së sistemit të kullimit dhe masat e marra nga institucionet e përfshira në këtë program auditim, për rritjen e gatishmërisë në prag të fillimit të stinës së reshjeve;
- Dokumentimi i procesit të transferimit të objekteve nga Bordi i Kullimit Fier tek Bashkia Vlorë dhe procedura e ndjekur për kontabilizimin e aseteve të transferuara;
- Masat e marra dhe administrimi i situatës para, gjatë dhe pas përmbytjeve. Bashkëpunimi ndërinstytucional për përballimin e kësaj situatë, në funksion të ndihmës së dhënë për qytetarët e dëmtuar nga përmbytjet;
- Investimet infrastrukturore të realizuara në territorin e Bashkisë Vlorë dhe ndikimi i tyre në situatën e përmbytjeve;
- Vlerësimi i riskut në rastet e sjelljes ekstreme të natyrës, në kuptimin e menaxhimit të qëndrueshëm mjedisor.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi dhe analizimi i të gjithë dokumentacionit të grumbulluar nga grupi i auditimit janë konstatuar probleme lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ nga institucionet objekt auditimi në disa drejtime. Për këtë grupi i auditimit ka rezultuar me 20 gjetje dhe për këto gjetje ka dhënë 23 rekomandime.

f. Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Nga auditimi në institucionet e sipërpërmendura lidhur me drejtimet e auditimit u konstatua si vijon:

- Për përmbytjet masive që ndodhën në Qytetin e Vlorës më datë 04.10.2024, nuk u shpall gjendja e emergjencës civile, nga Këshilli i Qarkut, sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor përkatës.
- Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, nuk është dërguar asnjë kërkesë për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet e banimit, por strukturat e Bashkisë Vlorë janë në proces vlerësimi vetëm për dëmet e pësuar në orenditë shtëpiake. Në drejtim të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk është akorduar asnjë fond nga Këshilli i Ministrave për këtë qëllim.
- Procesit të transferimit të objekteve nga Bordi i Kullimit Fier tek Bashkia Vlorë nuk është kryer në mënyrë të rregullt, pasi ka mungesë të dokumentacionit teknik shoqërues në lidhje me kanalet, planvendosjen, profilet gjatësore / tërthore të tyre, parametrat e digave, dampave dhe tobinove ekzistuese që janë pjesë e infrastrukturës së ujitjes / kullimit.
- Sektori i Bordit të Ujitjes dhe Kullimit pranë NSHP Vlorë nuk disponon informacione teknike në lidhje me kanalet që ka në ngarkim, mungojnë hartat e azhornuara me informacione si planvendosje, profilet gjatësore / tërthore etj., në lidhje me kanalet apo argjinaturat.

- Nga kanalet e planifikuara për t'u pastruar, referuar planeve të punës për vitin 2023 dhe 2024, rezulton se nuk janë pastruar përfundimisht kanalet KKP Bunavi, KKP Armen, KKP Selenicë.
- Hidrovori Akërnë nuk punon me kapacitet të plotë sepse niveli i tensionit nga ora 07:00 deri në orën 23:00 është 360V, kjo pasi në linjën e furnizimit të hidrovorit marrin energji subjekte private. Hidrovori Akërnë, më datë 04.10.2024, nuk ka punuar me kapacitet të plotë ($Q=18.35 \text{ m}^3/\text{sek}$; $P_n=11 \text{ kW}$), por me 45% të kapacitetit.
- SHRUKV SHA nuk ka hartuar plane investimi, si dhe nuk ka kryer investime për periudhën 2023 - 2024, lidhur me përmirësimin e sistemit kullues dhe mbrojtjen nga përmytjet në Qytetin e Vlorës dhe në zonat urbane në juridiksion të saj. Nga UKV SHA dhe SHRUKV SHA nuk është planifikuar apo realizuar asnjë investim në sistemin e kullimit në vitet e fundit.
- Në territorin e Bashkisë Vlorë, nuk funksionojnë të ndara KUN dhe KUB. Kanalet e ujërave të ndotura në Qytetin e Vlorës nuk qarkullojnë vetëm ujërat të ndotura kur ka reshje të dendura, pasi për të shmangur përmytjet punonjësit e Ujësjellës - Kanalizimeve hapin pusetat për depërtimin e ujërave sipërfaqësor, të cilat përzihen me ujëra të ndotura, duke shumëfishuar volumin e fluidit që duhet të largohet nga pompat në stacionet KUN.
- Disa nga kanalet janë të pa pastruar mbi 30 vite dhe janë të bllokuar nga aluvionet dhe mbeturinat e ndryshme. Pjesa dërmuese e puseta të KUB janë jashtë funksionit pasi janë të pa pastruara nga mbeturina dhe inertet, si dhe kanë dimensione që nuk përballojnë reshjet. Gjatë situatës së përmytjes, është konstatuar prania e madhe e inerteve të ndryshme në rrjetin e kanalizimeve të shkaktuara edhe nga ndërtimi i ujësjellësit të ri në të gjitha rrugët e Qytetit të Vlorës.
- Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve nuk është efektiv. Skema e kullimit është një skemë që nuk është 100% në vartësi të bashkisë dhe institucioneve të saj. Kanalet e dyta e të treta janë objekt pune i bashkisë dhe kanalet e para në vartësi të bordit të kullimit, që për Vlorën, ndodhet në autoritetin e DPUK Fier.
- Gjatë reshjeve të dendura, të cilat krijuan probleme dhe përmytje në zonën e Vlorës më datë 04.10.2024, u krijua një rrëshqitje skarpati në km 15+000 në rrugën kryesore të Bypass-it të Vlorës duke shkaktuar një bllokim të përkohshëm të qarkullimit të mjeteve. Në km 0+000 është realizuar rreth-rrotullim që lidh aksin Fier-Vlorë me Bypass-in e Vlorës, rrugët hyrëse të qytetit (hyrja e vjetër dhe zgjatimi i rrugës Transballkanike) dhe rruga e Nartës. Në këtë rreth - rrotullim në projektin fillestar ishte parashikuar të ndërtohej një nënkallim me gjatësi 100 m për shkarkimin e reshjeve me tre tombino me diametër 1000 mm, me hapësirë drite $2,355 \text{ m}^2$. Faktikisht, në terren nga kompania "S. C." S.P.A është ndërtuar një tombino box me përmasa $2.5 * 1 \text{ m}$, me hapësirë drite 2.5 m^2 . Ky ndryshim është kryer si rezultat i kërkesës së Bashkisë Vlorë për të mundur pastrimin dhe duke krijuar akses me puseta gjatë gjithë gjatësisë së saj. Dalja e kësaj tombino box është në kanalën e kullimit të ujërave të larta që kalon paralel me aksin e autostradës Vlorë – Fier, në anën perëndimore të saj, i cili është i pa pastruar dhe krijon vështirësi në shkarkimi e tij. Mospastrimi i kanalit kryesor të kullimit në dalje të tombinos e bën këtë tombino jo funksionale në rast të reshjeve të dendura.

h. Përmbledhje e rekomandimeve kryesore

Me qëllim adresimin e problemeve të konstatuara nga grupi i auditimit janë dhënë disa rekomandime për institucionet objekt auditimi, të cilat konsistojnë në marrjen e masave:

- për të përcaktuar qartë përgjegjësitë për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanalit që dërgon ujin në hidrovori;
- për të korrigjuar pasaktësitë në të dhënat mbi kapacitetin e hidrovorit;
- për të siguruar mbarëvajtjen e punës së hidrovorit, si dhe funksionalitetit të tij duke:
- përmbushur kushtet teknike për të siguruar funksionimin pa ndërprerje të hidrovorit;

- përmirësuar linjën elektrike të hidrovorit, nga 6 KË në një tension më të lartë 20 KW, me qëllim përbalimin e ngarkesën dhe shmangien e ndërprerjes së energjisë;
- për arritjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet “SHRUKV” SHA dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike (NSHP) në Bashkinë Vlorë, për të siguruar menaxhim më efikas dhe të koordinuar të aseteve;
- për të përfunduar procesin e transferimit, duke përpiluar dhe kërkuar dokumentacionin teknik të plotë, përfshirë hartat dhe të dhënat e azhornuara për kanalet ujitëse dhe kulluese, argjinaturat dhe veprat e marrjes;
- për pastrimin e kanaleve të cilat janë klasifikuar si urgjente në zonat e Novoselës dhe Nartës me qëllim shmangien e rrezikut të përmytjeve;
- për të realizuar pastrimin e plotë të kanaleve kulluese dhe sigurimin e argjinaturave, duke përcaktuar më parë objektet më prioritare që do t’i nënshtrohen procesit të pastrimit dhe mirëmbajtjes;
- për kryerjen e inspektime të vazhdueshme lidhur me gjendjen teknike të hidrovorëve, duke dokumentuar të dhënat që konstatohen si dhe të përcaktohen nevojat për remonte vjetore të tyre;
- për të vijuar procesin e regjistrimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të aseteve së bashku me strukturat përkatëse, mbi të cilët është vendosur sistemi kullues dhe i mbrojtjes nga përmytjet;
- për identifikimin e:
 - të gjitha ndërtimeve të ngritura brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të kullimit të ujërave sipas legjislacionit në fuqi, si dhe pjesëve të dëmtuara të sistemit të kullimit me qëllim kthimin në gjendjen e tij funksionale.
 - të gjitha kanalizimeve të ujërave të ndotura që derdhen në sistemet kryesore të kullimit të ujërave.
- Etj.

II.1 Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit.

Nga evidencat e marra mbi veprimtarinë e projektit rezultoi se:

Sa trajtuar në këtë raport, mosfunksionimi i kolektorëve dhe kanaleve kryesore kullues, mosfunksionimi në kapacitetin maksimal i hidrovorit të qytetit dhe ITUN, mund të konsiderohet se është arsyeja kryesore e përmytjes së qytetit. Pastrimi i kanaleve dhe rehabilitimi i sistemit kullues është një detyrë urgjente, sepse pa një funksionim të mirë të kullimit qyteti është i rrezikuar gjithmonë nga përmytjet. ***Mospastrimi i kanaleve të hapura është shkaku kryesor për përmytjen e datës 04.10.2024, pasi janë arteriet kryesore të kullimit të reshjeve për relievin e qytetit.*** Mangësitë e evidentuara në lidhje me kryerjen e procesit të pastrimit të kunetave dhe puseta të shiut në mënyrë periodike, krijon kushtet për bllokimin e kanaleve të kullimit, për shkak të grumbullimit të materialeve dhe mbetjeve në pika të ndryshme të tubacioneve të kullimit. ***Si përfundim, në qoftë se e gjithë infrastruktura dhe sistemi i kanaleve kulluese do të ishte në funksion dhe do të punonte me kapacitet të plotë, risku do të ishte i ulët që Qyteti i Vlorës të pësonte përmytje sikurse ajo e datës 04.10.2024.***

III. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit Tematik nr. 1191/1 prot; datë 10.10.2024, “Për verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmytjet masive në qytetin e Vlorës”, (i ndryshuar), të miratuar nga Kryetari i KLSH^{së}, në subjektet: Bashkia Vlorë, Prefektura e Qarkut Vlorë, Këshilli i Qarkut Vlorë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë, Drejtoria e Ujitjes Dhe Kullimit Fier, Ujësjellës Kanalizime Vlorë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes

Civile, nga data 10.10.2024 deri në datën 06.12.2024 u krye auditimi nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. G.K. - *Përgjegjës Grupi*;
2. A. Z. - *Anëtar*;
3. L. K. - *Anëtar*;
4. S. H. - *Anëtar*;
5. A. S. - *Anëtar*;
6. P. I. - *Anëtar*

3.1 Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Për auditimin tematik, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për veprimtarinë e subjekteve të audituara, në lidhje me parandalimin, gatishmërinë dhe reagimin ndaj përmbytjeve.

Çdo mjet i shtuar në vlerësimin e situatave të përmbytjeve, kërkon edhe kapacitetet e duhura në infrastrukturën mbështetëse, për mirëfunksionimin e tij. Gjithashtu, rritja e kapaciteteve njerëzore me trajnimet e duhura, është e nevojshme në përdorimin e sistemeve të reja të parashikimit.

Auditimi tematik me objekt *“Për verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës”* synon të ofrojë një panoramë të plotë mbi situatën legjislative dhe situatën aktuale, duke analizuar performancën e Bashkisë Vlorë, Prefekturës së Qarkut Vlorë, Këshillit të Qarkut Vlorë, Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Vlorë, Drejtorisë së Ujitjes dhe Kullimit Fier, Ujësjellës - Kanalizime Vlorë, Autoritetit Rrugor Shqiptar, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Megjense gjatë viteve të fundit problemi social në fjalë nuk ka gjetur përmirësime, auditimi kishte si objektiv efektivitetin e masave të marra dhe përmbushjes së objektivave nga institucionet subjekt auditimi, në parandalimin dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Nëpërmjet këtij auditimi synojmë të krijojmë një panoramë nëse aktorët e përfshirë kanë bërë gjërat e duhura në mënyrën e duhur.

Ky auditim u fokusua në nivelin mikro të politikave, duke u përqendruar më shumë në evidentimin e problematikave dhe përmirësimin e kuadrit ligjor, përditësimin e tij, bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm përgjegjës lidhur me përmbytjet.

3.2 Identifikimi i çështjeve.

Subjektet e audituara në këtë program tematik, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të punimeve/shërbimeve të ofruara duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet. Idenifikimi i çështjeve është i lidhur me situatën e përmbytjeve të ndodhura në qytetin e Vlorës.

3.3 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat përgjegjëse të subjekteve në auditim duhet të kryejnë funksionin e tyre në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre. Menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij.

3.4 Përgjegjësitë e audituesve.

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit mbi çështjet nën auditimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike si dhe është planifikuar dhe kryer auditimi sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

3.5 Kriteret e vlerësimit.

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH; Ligjet e funksionimit të institucioneve të audituara dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me veprontarinë e tyre.

3.6 Standartet e auditimit.

- Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:

- **ISSAI (100)** “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” që përcakton parime themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- **ISSAI (400)** “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë” që përcakton parime themelore **ISSAI (100)** dhe zhvillon më tej ato, duke përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- **ISSAI (4000)** “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe **ISSAI (4200)**;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Federata Ndërkombëtare kontabilisteve (IFAC);
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesis të IDI¹,
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë.

3.7 Metodatat e auditimit

Për arritjen e objektivave, metoda e auditimit u bazua tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në kryerjen e auditimit janë përdorur metoda e bazuar në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, metoda e bazuar në procedurat bazë dhe në procedurat analitike. Pas testimit të kryer, për të kuptuar sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm dhe pas marrjes së informacionit në mënyre të përgjithshme, në ushtrimin e auditimit për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar u bënë teste lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm morëm dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ja nënshtruar skepticismit profesional nga ana e audituesve.

Po kështu nga ana jonë u përshkrua legjislacioni autorizues, rregullat e vendosura sipas legjislacionit autorizues, caktimi i përgjegjësisë dhe autoritetit, etj.

Teknikat e kontrollit të përdorura gjatë auditimit janë; kontrolli aritmetik, kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, kontrolli i vlerësimit, konfirmim nga të tretët, kontrolli sipas një treguesi.

3.8 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{-së} nr. 196, datë 29.12.2015 si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

IV. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

4.1 Bashkia Vlorë

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2023-2030) bën thirrje për fuqizimin e qeverive lokale, forcimin e demokracisë dhe përmirësimin e efikasitetit të ofrimit të shërbimeve.

Gjashtë funksione të reja janë transferuar në qeverinë lokale në vitin 2016, në përputhje me Ligjin për Qeverisjen Lokale, përfshirë personelin e arsimit parashkollor dhe të mesëm, menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, menaxhimin e rrugëve rurale, menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dytësore **dhe menaxhimin e kullimit**, menaxhimin e shërbimeve sociale dhe zjarrin mbrojtje dhe shpëtim.

Transferimi nuk ka qenë i qetë. Procesi nuk ndodhi në çast dhe është ende në vazhdim për disa funksione. Ekzistojnë çështje rreth përfundimit të kornizës ligjore për transferimin, ka probleme të mbetura institucionale për të zgjidhur, ka nevojë për kapacitetet lokale për t'u marrë me funksionet e reja dhe një planifikim të duhur për menaxhimin e këtyre funksioneve në mënyrë efektive.

Bashkitë tashmë janë përgjegjëse për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe sigurinë e digave të rezervuarëve që përdoren për ujitje. Bashkitë kanë detyrë tashmë në sektorin e ujitjes dhe kullimit pastrimin e kanaleve të para, të dyta dhe të treta, veprat e artit, rehabilitimin e tyre, pastrimin e rrjetit të kanaleve kulluese.

Me marrjen e inventarit fizik të kanaleve kulluese të dyta dhe treta, Bashkisë Vlorë, i janë shtuar detyrimet për administrimin e një territori mjaft të gjerë dhe me një kompleksitet të madh problematikash në administrimin e ujërave. Pjesa më e madhe e problematikave, nuk mund të thuhet se varet direkt nga bashkia, *veçanërisht problemi i menaxhimit të përmblytjeve periodike*, shkarkimeve të kontrolluara dhe jo, të ujërave të basenit të lumit Vjosë. Shtrirja në kohë e efekteve të përmblytjeve, është evidente gjatë gjithë sezonit të lagësht, duke ndikuar në mbajtjen lart të nivelit të ujërave nëntokësore.

Ndikimet në bujqësi dhe degët e tjera ndihmëse ekonomike, përfshirë dhe kushtet e jetesës, janë dhe mbeten të mëdha dhe të përhershme, për aq kohë sa nuk ka një sistem të mirë të administrimit të ujërave, për këtë zonë shumë specifike hidrike, në nivel kombëtar, rajonal dhe shumë më gjerë.

Bashkia është përgjegjëse për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të saj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Në vijim të zbatimit të reformës territoriale, është miratuar ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e njësive të qeverisjes vendore. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohen dhe funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Nga ana e Bashkisë Vlorë janë transferuar në Ujësjellës - Kanalizime Vlorë, gjithë sistemi hidrik i qytetit të Vlorë, proces që ka filluar nga viti 2006 dhe ka përfunduar në 2023. Kjo procedurë është përshkruar hollësisht në pjesën e materialit për SHRUKV SHA.

4.2 Prefektura e Qarkut Vlorë

Ndër masat e marra nga ana e Prefektit në lidhje me situatën para përmblytjes po i rendisim si më poshtë:

Me shkresën nr. 170 prot; datë 09.02.2024, me lëndë: “Kërkesë për informim lidhur me kanalet kullues/vaditës nën administrimin tuaj”; z. Flamur Mamaj, Prefekti i Qarkut Vlorë i është drejtuar Bashkive të Qarkut: Vlorë, Selenicë, Sarandë, Konispol, Finiq, Himarë e Delvinë, ku kërkohet informacion për:

- Sipërfaqen e tokës bujqësore që disponon bashkia;
- Ndarjen e sipërfaqes sipas vlerësimit të cilësisë të mirë dhe aftësisë të lartë prodhuese, dhe si klasifikohen nga kategoria e parë deri në kategorinë e katërt;
- Sipërfaqen e tokës me troje, toka të pafrytshme dhe brigje të lumenjve;
- Sipërfaqen pyje, livadhe, kullota dhe toka të tjera;
- Zonat me kullota livadhe dhe pyje që kanë shtrirje në zonën tuaj administrative (emërtimet sipas njësisë administrative).

Me shkresën nr. 171 prot; datë 09.02.2024, me lëndë “Kërkesë për informim lidhur me kanalet kullues/vaditës nën administrimin tuaj” z. F.M, Prefekti i Qarkut Vlorë i është drejtuar Bashkive të Qarkut: Vlorë, Selenicë, Sarandë, Konispol, Finiq, Himarë e Delvinë, ku kërkohet informacion për:

- Metrat linear të kanaleve kulluese dhe metrat lineare të kanaleve vaditëse që ndodhen nën administrimin tuaj.
- Kanalet që janë pastruar dhe janë nën administrim, dhe sa kanale ngelen emergjente për pastrim (të ndarë sipas Njësisë Administrative).
- Mundësimi nga bashkia juaj me mjete pastruese

Më datë 22.02.2024 Prefekti i Qarkut Vlorë, ka dërguar raportin mbi masat e marra në lidhje me diskutimin: “**1. Infrastruktura**” dhe “**2. Siguria ushqimore**”.

1. Rakordimi i DUK-ve me bashkitë për pastrimin e kanaleve dhe bashkëpunimin për mjetet në bashkitë që nuk i disponojnë me ato që i disponojnë.

Krijimi i një kalendari të përbashkët midis bashkive dhe DUK-ve për pastrimin e kanaleve duke vënë në dispozicion mjetet e punës nga DUK dhe plotësimin i naftës nga bashkitë të cilat nuk disponojnë mjete, por gjithashtu dhe bashkitë brenda qarqeve të tyre mund të krijojnë një organizim të përbashkët ku ato bashki që kanë mjete mund të ndihmojnë bashkitë të cilat nuk kanë, dhe nafta të vihet në dispozicion nga bashkitë që kërkojnë mjete. Ky lloj koordinimi do e bëjë më eficientë **pastrimin e kanaleve në kohë dhe do të paraprijë rrezikun e emergjencave.**

Nga monitorimet e bëra nga Prefekti i Qarkut Vlorë janë hasur disa problematika në punën e Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit Vlorë – Sarandë:

- a. Në këtë sektor mungon rimorkiatori i cili është mjeti më i domosdoshëm i punës;
 - b. Mungon mjeti transportues i cili ndodhet në inventar dhe është jashtë çdo kushti teknik.
- Kjo ka sjellë si pasojë një mungesë bashkëpunimi me bashkitë si dhe moskryerja në afat dhe me cilësi të punimeve.

Më datë 23.02.2024, Prefekti i Qarkut Vlorë, në vijim të takimit në datë 31.01.2024, me Ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka dërguar materialin, ku citohet:

Rakordimi i DUK-ve me Bashkitë për pastrimin e kanaleve dhe bashkëpunimin për mjetet në bashkitë që nuk i disponojnë me ato që i disponojnë. Krijimi i një kalendari të përbashkët midis bashkive dhe DUK-ve dhe plotësimi i naftës nga bashkitë të cilat nuk disponojnë mjete, por gjithashtu dhe bashkitë Brenda qarqeve të tyre mund të krijojnë një organizim të përbashkët ku bashkitë që kanë mjete mund të ndihmojnë bashkitë të cilat nuk kanë dhe nafta të vihet në dispozicion nga bashkitë që kërkojnë mjetet. Ky lloj kordinimi do të bëjë më eficientë pastrimin e kanaleve në kohë dhe do të paraprijë rrezikun e emergjencave.

Tabelë: Bashkia Vlorë

Kanale në total (km)	Kanale Sekondare Vaditës	Kanale terciare Vaditës	Kanale Sekondare Kulluese	Kanale terciare Kulluese
601.5	131	99	101.5	270

NSHP e Bashkisë Vlorë ka 4 mjete tip eskavator në dispozicion, ka pastruar 11.2 km kanale kullues, nuk ka planifikuar për pastrim për vitin 2024 dhe nuk ka dhënë informacion në lidhje me realizimin e pastrimit të kanaleve.

Bashkia Vlorë ka emergjente për pastrim: Kanale Kullimi - Myzeqe (13.2 km); Llakatund (4-6 km); Dukat – Tragjas (16 km); Babicë – Xhuherinë (5 km).

Me shkresën nr. 5634 prot; datë 23.08.2024, me lëndë “*Mbi sigurinë e digave në pronësi të bashkive*” drejtuar 61 bashkive, z. A.M., Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes nga Ministri i Buqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Me shkresën nr. 848 prot; datë 12.09.2024, me lëndë “*Kërkohet informacion mbi masat e mara për përballimin me sukses të situatave emergjente në periudhën vjeshte-dimër 2024-2025*”, z. K.K., Prefekti i Qarkut Vlorë i është drejtuar Bashkive të Qarkut: Vlorë, Selenicë, Sarandë, Konispol, Finiq, Himarë e Delvinë, ku kërkohet informacion për:

- *Gjendjen aktuale të digave, rezervuarëve dhe hidrovorëve, si dhe mbajtjen nën monitorim të vazhdueshëm të gjendjes teknike të tyre.*
- *Masat e marra nga bashkitë për përballimin me sukses të problematikave që mund të krijohen nga reshjet në territor.*
- *Përditësimin dhe dërgimin e planit të masave për parandalimin dhe përballimin e emergjencave për periudhën vjeshtë dimër 2024- 2025.*

Me shkresën nr. 863 prot; datë 17.09.2024, me lëndë “*Kërkohet informacion mbi masat e mara për përballimin me sukses të situatave emergjente në periudhën vjeshte-dimër 2024-2025*”, z. K. K., Prefekti i Qarkut Vlorë, i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit, Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit Vlorë - Sarandë, ku i kërkohet informacion për:

- *Gjendjen aktuale hidrovorëve, ndërhyrjet e kryera gjatë 2024 si dhe mbajtjen nën monitorim të vazhdueshëm të gjendjes teknike të tyre.*
- *Masat e marra për përballimin me sukses të problematikave që mund të krijohen nga rreshjet në territor.*
- *Gjendja e kanaleve kullues si dhe volumin e punëve që është kryer për vitin 2024.*

Me Urdhrin nr. 29 e nr. 806 prot; datë 22.08.2024 “*Për mbledhjen e Komisionit të Mbrojtjes Civile në Qark, Mbi përballimin e emergjencave të shkaktuara nga zjarret si rezultat I temperaturave të larta*”, është urdhëruar të mbledhet KMC në qark, në datë 29.08.2024, ora 11:00, në ambientet e Prefekturës, një pjesë e anëtarëve do të jenë online.

Me Urdhrin nr. 33 e nr. 904 prot; datë 07.10.2024 “*Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin dhe raportimin e situatës së përmbytjes në qytetin e Vlorës*” në pikën 3 përcaktohet se:

Tematikat në të cilat do të përqendrohet puna e grupit të punës, ka të bëjë me:

- furnizimi me energji elektrike;
- furnizimi me ujë dhe problematikat e mosfunksionimit të rrjetit ujësjellës-kanalizime;
- pastrimi dhe problematikat e funksionimit të akseve rrugore;
- gjendja e situatës në shkolla;
- heqja e baltës dhe mbetjeve në rrugët e qytetit;
- heqja e ujit nga banesat dhe garazhet.

Ndërsa në lidhje masat e marra nga ana e Prefektit në lidhje me situatën pas përmbytjes po i rendisim si më poshtë:

Me shkresën nr. 941 prot; nr.848 prot; datë 17.10.2024 kërkohet informacion për situatën mjedisore ndaj Agjencisë së Bregdetit Vlorë:

“Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e qarkut", kërkohet nga ana juaj informacion në lidhje me situatën mjedisore në territorin nën juridiksionin tuaj, pas situatës së krijuar nga reshjet e shiut të datës 04.10.2024, problematikat e evidentuara si dhe nevojat e mundshme për bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitucional, me qëllim eliminimin e tyre dhe mbarëvajtjen e punëve në vijimësi.”

Me shkresën nr. 940 prot; datë 17.10. 2024, me lëndë *“Kërkohet informacion për situatën mjedisore ndaj Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Vlorë”*, citohet:

“Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e qarkut", kërkohet nga ana juaj informacion për situatën mjedisore në territorin nën juridiksionin tuaj, ku të përmenden problematikat e mundshme, krijuar nga reshjet e dendura të datës 04.10.2024 dhe nevojën për bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitucional, me qëllim mbarëvajtjen e punëve në vijimësi”.

Me shkresën nr. 942 prot; datë 17.10. 2024, kërkohet informacion ndaj Bashkisë Vlorë:

“Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin e qarkut", kërkohet nga ana juaj informacion për pastrimin dhe problematikat e funksionimit të kaseve rrugore, për heqjen e baltës dhe mbetjeve në rrugët e qytetit, heqjen e ujit nga banesat dhe garazhet si dhe situata aktuale në shkollat për shkak të përmbytjes.”

Me shkresën nr. 944 prot; datë 17.10. 2024, kërkohet informacion ndaj OSSHE, Drejtorisë Rajonale Vlorë, si vijon: *“Bazuar në Ligjin 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, Neni 8, pikat "b", "d", "f", "gj", Ligji nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 1, pika 1, Neni 4, Neni 5 pika 1.1 "c" Prefekti i Qarkut Vlorë kërkon nga ana juaj informacion me shkrim në lidhje me problematikat e hasura gjatë përmbytjes, për problematikat që po reflektoni pas përmbytjes, dëmtime transformatorësh, linja tensioni apo, dhe nëse ka zona që nuk furnizohen me energji elektrike ose kanë ndërprerje të energjisë elektrike, për Bashkinë Vlorë.”*

Me shkresën nr. 943/1 prot; datë 18.10. 2024, kërkohet informacion ndaj Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizimeve Vlorë, si vijon: *“Bazuar në Ligjin 107/2016 "Për prefektin e qarkut", Neni 8, pikat "b", "d", "f", "gj", Ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territori", i ndryshuar, Neni 4, 5 pika 1.1 "c" dhe 1.3 "b", Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" Kreu IV, Neni 11, Prefekti i Qarkut Vlorë kërkon nga ana juaj informacion me shkrim në lidhje me gjendjen aktuale të kanalizimeve, furnizimin me ujë të pijshëm të qytetit, si dhe planin e masave për menaxhimin e situatës pas përmbytjes.”*

Me shkresën nr. 943 prot; datë 17.10. 2024, kërkohet informacion ndaj Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizimeve Vlorë, si vijon: *“Bazuar në Ligjin 107/2016 "Për prefektin e qarkut", Neni 8, pikat "b", "d", "f", "gj", Ligji nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territori", i ndryshuar, Neni 4, 5 pika 1.1 "c" dhe 1.3 "b", Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" Kreu IV, Neni 11, Prefekti i Qarkut Vlorë kërkon nga ana juaj informacion me shkresë zyrtare në lidhje me gjendjen aktuale të kanalizimeve, furnizimit me ujë të pijshëm të qytetit si dhe planin e masave për menaxhimin e situatës pas përmbytjes.”*

Nga auditimi i detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në ligj, Prefekti i Qarkut Vlorë ka kompetenca ligjore për të vepruar gjatë përmbytjeve masive të ndodhura në qytetin e Vlorës.

Nga auditimi i veprimeve të kryera nga Prefekti i Qarkut, në zbatim të Planit i Emergjencave Civile, në pikën 2.1 të tij, citohet se: *“Prefekti, në rolin e kryetarit të komisionit të emergjencave civile, është përgjegjës për planizimin e emergjencave në shkallë qarku, duke koordinuar veprimet e të gjitha strukturat të cilat janë përfshirë në planin e emergjencave në nivel qarkut. Prefekti kërkon shpalljen e gjendjes së Emergjencave Civile në një pjesë ose në të gjithë territorin e Qarkut Vlorë”*, si dhe referuar VKM-së nr. 329, datë 16.5.2012 *“Për*

kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, rezultoi se:

Për përmbytjet masive në qytetin e Vlorës, nga ana e prefektit të qarkut Vlorë është gjykuar e arsyeshme të mos shpallej gjendja e emergjencës civile.

4.3 Këshilli i Qarkut Vlorë

Këshilli i Qarkut është ngritur dhe funksionon në zbatim të kreut III “Përbërja, krijimi, mënyra e funksionimit dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut”, neni 72 deri neni 85, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në këtë ligj janë të përcaktuara përbërja, funksionimi, detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut, si dhe kompetencat e Kryetarit të Këshillit të Qarkut.

Nga auditimi i detyrave dhe kompetencave të përcaktuar në ligj, Kryetari dhe Këshilli i Qarkut Vlorë, nuk ka kompetenca ligjore për të vepruar gjatë përmbytjeve masive të ndodhura në qytetin e Vlorës.

Nga auditimi i veprimeve të kryera nga Këshilli i Qarkut, në zbatim të VKM-së nr. 329, datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, rezultoi se:

Për përmbytjet masive në qytetin e Vlorës, nuk u shpall gjendja e emergjencës civile, e cila është sanksionuar në kreun III të VKM-së së mësipërme.

Sipas këtij kreu, në pikën 1 “Procedurat e vlerësimit të dëmeve”, gërma ç), citohet se: “Sipas rastit, me kërkesë të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse, këshilli i qarkut përkatës krijon komisionin e ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet e banimit, i cili pas vlerësimit të dëmeve sipas përcaktimeve të bëra në shkronjën “ç” të pikës 2 të kreut II të këtij vendimi, përcakton masën e dëmshpërblimit për familjet e dëmtuara”.

Nga auditimi u konstatua se nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, nuk ka ardhur asnjë kërkesë për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objektet e banimit. Ky vlerësim është në proces nga strukturat e Bashkisë Vlorë, vetëm në lidhje me dëmet e pësuar në orenditë shtëpiake të banorëve të qytetit të Vlorës.

Gjithashtu, në lidhje me pikën 1 “Procedurat e vlerësimit të dëmeve”, gërma gj), të këtij kreu, sipas të cilit citohet se: “Në rastet e dëmtimeve në objektet sociale e publike, fondet e akorduara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Brendshme u kalojnë njësisë të qeverisjes vendore, bashki, komuna dhe këshillit të qarkut”, rezultoi se në drejtim të Këshillit të Qarkut Vlorë, nuk është akorduar asnjë fond nga Këshilli i Ministrave për këtë qëllim.

4.4 Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me auditimin tematik të ushtruar në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike në Bashkinë Vlorë, në bazë të Programit të Auditimit nr. 1191/8 prot; datë 10.10.2024, i ndryshuar me nr. 1191/10 prot; datë 13.11.2024 me temë: “Verifikim i shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës”, si dhe në zbatim të nënpikës nr. 3 të programit të auditimit, nga audituesit e KLSH-së u auditua procesi i transferimit të objekteve nga Bordi i Kullimit Fier tek Bashkia Vlorë, si dhe aktiviteti i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në Bashkinë Vlorë, ku rezultoi se:

1. Në zbatim të VKM-së nr. 1108, datë 30.12.2015, me urdhrin e Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, dhe Ministrit të Pushtetit për Çështjet Vendore, me nr. 594 prot; datë 24.11.2016 “Për transferimin kapital të asetëve” është kryer transferimi i infrastrukturës së ujitje / kullimit nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave tek Bashkitë. Në përmbajtjen e tabelës nr. 1/1 “Transferimi i skemave kulluese” të urdhrin të mësipërm, konstatohet që janë transferuar disa kanale të cilat janë jashtë

territorit të qytetit Vlorë. Sipas tabelës nr. 1/1 është transferuar vetëm godina e hidrovorit, si ndërtesë, ndërsa kanali që dërgon ujin tek hidrovorit nuk është transferuar. Kjo gjë ka sjellë “keqkuptim institucional”, se cili nga institucionet, UKV apo Bordi i Ujitjes dhe Kullimit, e ka për detyrë pastrimin dhe mirëmbajtjen e këtij kanali.

2. Në procesverbalin e mbajtur në datë 21.01.2016 me objekt: *“Për transferimin nga Bordi Rajonal i Kullimit Fier në Bashkinë Vlorë, infrastruktura e ujitjes e kullimit dhe asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme”* u konstatua se, referuar VKM-së nr. 1108, datë 30.12.2015, ka disa pasaktësi në lidhje me fuqinë e instaluar në pompa, pasi fuqia reale nuk është 1400 KË, por 1200 KË. Një tjetër pasaktësi ka të bëjë me kapacitetin total të hidrovorit pasi në VKM është përcaktuar 21 m³/sek, ndërsa sipas procesverbalit të mësipërm është shkruar shprehimisht: *“...nga gjendja fizike e hidrovorit, godina është në gjendje të mirë, në të gjenden 4 pompa, 2 të mëdha 5.5m³ dhe 2 të vogla 2.5m³”*, pra në total kapaciteti real i instaluar është 16 m³/sek dhe jo 21 m³/sek. Këto pasaktësi janë mbajtur shënim në procesverbalin e mësipërm më datë 21.01.2016.

3. Procesi i transferimit nuk është kryer në mënyrë të rregullt pasi, kur ka ndodhur transferimi, kemi mungesë të dokumentacionit teknik shoqërues në lidhje me kanalet, planvendosjen, profilet gjatësore / tërthore të tyre, parametrat e digave, dampave dhe tobinove ekzistuese që janë pjesë e infrastrukturës së ujitjes / kullimit. Aktualisht Sektori i Bordit të Ujitjes dhe Kullimit pranë NSHP Vlorë nuk disponon informacione teknike në lidhje me kanalet që ka në ngarkim; mungojnë hartat e azhornuara me informacione si planvendosje, profilet gjatësore / tërthore, etj., në lidhje me kanalet, argjinaturat, veprat e marrjes që ka në ngarkim sipas skemave të transferuara me VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 *“Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të asetëve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”*.

4. Nga kontrolli i procedurave të prokurimit të kryera nga NSHP Vlorë u konstatua se më datë 12.09.2023, me anë të urdhrin të prokurimi me nr. 26, është realizuar procedura e prokurimit publik me objekt *“Mirëmbajtjen e hidrovorit”*, me fond limit 2,916,667 lekë pa TVSH. Punimet u fituan nga OE “S” ShPK, me vlerë 2,766,214 lekë pa TVSH. Punimet kryesore referuar preventivit të punimeve përfshinin: riparime elektrike, ndërrim pjesësh të sistemit elektrik, mirëmbajtjen e pompave nr. 1, 3 dhe 4, riparimin e pompës Ganz 500 nr. 1, si dhe riparimin e kapakëve të pompave nr. 3 dhe 4. Megjithatë, pompa nr. 2, e cila ka pasur defekte që para vitit 2020, nuk ishte përfshirë në preventiv për riparim ose zëvendësim. Sipas raport-analizës së 2020-2021 të bordit të kullimit, kjo pompë ka një defekt të rëndë që ndikon në gatishmërinë e saj, dhe ende nuk është riparuar. Ajo ka probleme me aksin (i shtrembëruar), që shkakton nxehje dhe ndërprerje të vazhdueshme gjatë operimit. Procedura e mirëmbajtjes së hidrovorit nuk ka adresuar një nga problemet kryesore, defektin e rëndë të pompës nr. 2, e cila ka qenë jashtë funksionit që prej vitit 2020. Mos-riparimi i saj vazhdon të ndikojë negativisht në efikasitetin e përgjithshëm të sistemit, duke ulur gatishmërinë dhe duke shkaktuar ndërprerje gjatë operimit. Kjo tregon nevojën për planifikim më të mirë dhe përfshirjen e të gjitha defekteve kritike në investimet e mirëmbajtjes së hidrovorit.

5. Nga kontrolli i kryer në hidrovorin e qytetit të Vlorës, rezultoi se dokumentacioni i kërkuar sipas Udhëzimit nr. 12, datë 30.12.2019 *“Për rregullat e kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”*, nuk mbahej rregullisht. Mungonin dokumentet referuar udhëzimit të sipërcituar, referuar nenit 12.7 për pikat e) dhe f), siç janë skemat elektrike dhe mekanike, si dhe skema e furnizimit me energji elektrike, që janë të nevojshme për një shfrytëzim të sigurt dhe efikas të hidrovorit. Po ashtu, shënuesi i niveli kritik të ujit nuk ishte i vendosur në hidrovor, duke e bërë të vështirë reagimin në kohë ndaj përmbytjeve.

Mosmbajtja e rregullt e dokumentacionit si dhe ndryshimet gjatë vitit 2024 në strukturën organizative të Bashkisë Vlorë, (me vendimet e Kryetarit të Bashkisë me nr. 42, datë 18.04.2024 dhe me nr. 126, datë 01.10.2024) e bëjnë të pamundur kryerjen e kontrolleve rutinë,

pasi specialistët që ishin të ngarkuar për këtë detyrë janë hequr nga struktura e re. Sipas strukturës së re organizative përgjegjësi i Sektorit Bordi i Ujitjes / Kullimit në NSHP, z. A.S., nuk ka më staf varësie pasi në strukturën e re janë hequr specialistët që kishte në varësi. Ky ndryshim në strukturën e re të Bashkisë Vlorë ka krijuar mangësi në mbajtjen e procesverbaleve të kontrollit dhe në zbatimin e udhëzimeve për mirëmbajtjen dhe funksionimin e hidrovorit.

6. Nga kontrolli i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se ka problematika në mënyrën se si dalin mjetet në terren nga Sektori i Ujitjes dhe Kullimit në NSHP Vlorë. Makineritë e rënda, që nga viti 2023 deri në qershor të 2024, dilnin në terren me urdhër shërbimi të nënshkruara nga drejtori i NSHP Vlorë. Pas qershorit 2024 nuk ka gjurmë dokumentare që të justifikojnë daljen e tyre në terren, kjo në kundërshtim me Udhëzimin nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat e kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”. Ky veprim është në shkelje të pikës 13.3 të udhëzimit, e cila kërkon miratim të ministrit për lëvizjen e makinerisë, si për punime brenda drejtorive, ashtu edhe për punime për llogari të subjekteve private ose shtetërore.

7. Nga auditimi në hidrovorin e qytetit të Vlorës u konstatuan mangësi thelbësore:

- Hidrovori punon pa pompa rezervë, në shkelje të kushteve teknike;
- Linja elektrike 6Kv që furnizon hidrovorin shpesh nuk e përballon ngarkesën, duke shkaktuar ndërprerje të energjisë, dhe kërkohet një linjë me tension më të lartë;
- Mungon një gjenerator i dedikuar për emergjencat, si në rast të mungesës së energjisë ose përmbytjeve.

8. Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë deri në shkurt 2024, janë pastruar rreth 58.42 km kanale, janë identifikuar si kanale emergjente për pastrim ato të kullimit në Myzeqe, Llakatund, Dukat - Tragjas dhe Babicë, si dhe disa skema ujitëse. Pavarësisht kësaj, kanalet në zonat e Novoselës dhe Nartës janë në gjendje të rënduar për shkak të bllokimeve dhe mbetjeve të grumbulluara, duke krijuar rrezik për përmbytje. Dy shkresa janë dërguar nga përgjegjësi i Sektorit të Bordit të Ujitjes dhe Kullimit në NSHP, z. A.S., për informacion Prefektit të Qarkut Vlorë dhe titullarit të NSHP, ku shpreh kërkesën e pastrimit urgjent të këtyre kanaleve. Sipas planit vjetor të punimeve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për 2024 parashikohet me mjetet që ka në dispozicion kjo ndërmarrje të pastrohen 155 km kanale që ka në ngarkim. Për vitin 2024 deri në nëntor kemi rreth 32.49 km kanale të pastruar, pra kemi mosrealizim të planit vjetor në masën rreth 80% të sasisë së parashikuar për t’u pastruar për 2024.

9. Puna për ndërtimin e rrjetit të ri të furnizimit me ujë në qytetin e Vlorës, me objekt “*Rehabilitation works for the water supply system of Vlora, Albania*”, e financuar nga KfË Gjermane po realizohet nga OE “A. A” ShPK, dhe po zhvillohet me vonesa të konsiderueshme. Operatori ekonomik kontraktues nuk është në afatet e parashikuara për realizimin e punimeve, dhe grafiku i punimeve është rishikuar deri tani pesë herë. Në grafikun fillestar, ishte planifikuar që punimet të kryheshin në fillim në një zonë (DMA) dhe vetëm pasi ato të kompletoheshin në këtë zonë do të vazhdohej me zonat e tjera sipas kronologjisë së parashikuar, por grafiku i ri parashikon realizimin e punimeve njëkohësisht në disa zona të qytetit, duke sjellë pasoja të mëdha në infrastrukturën rrugore të qytetit. Kjo gjë sjell pasoja negative në lidhje me përmbytjen, ndotje nga pluhuri dhe balta, si dhe ka vështirësuar menaxhimin e trafikut në qytet. Bashkia e Vlorës ka miratuar një leje infrastrukturore për punimet me nr. 157, datë 23.11.2023, pa përcaktuar kufizime për zonat ku do të realizoheshin punimet dhe pa marrë parasysh ndikimet negative të punimeve të njëkohshme në të gjithë qytetin. Ky mos-koordinim midis institucioneve si Bashkia Vlorë, UKV dhe AKUK, ka sjellë pasoja të mëdha, duke përfshirë përmbytje dhe dëmtime të infrastrukturës. Po ashtu, pas përfundimit të instalimit të linjave të reja të ujësjellësit, rrugët nuk janë rikthyer ende në gjendjen e mëparshme, por janë lënë të pa asfaltuara dhe të mbuluara me çakëll, duke e bërë të vështirë kalimin e mjeteve dhe duke shkaktuar ndotje të mjedisit. Aktualisht, mbi 37 km rrugë janë prekur nga punimet dhe ende nuk janë rikthyer në gjendjen e tyre fillestare.

Konkluzionet e auditimit tematik lidhur me transferimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nga Bordi Rajonal i Kullimit Fier në Bashkinë Vlorë dhe përmbytjen e ndodhur në 4 - 6 tetor 2024 janë si më poshtë:

1. Skemat e kullimit të transferuara nga Bordi Fier tek Sektori i Bordit të Ujitjes dhe Kullimit në NSHP Vlorë, nuk kalon në territorin e qytetit të Vlorës, por shtrihen në Njësitë Administrative Novoselë, Qendër, Shushicë dhe Orikum.
2. Kanalet e dyta dhe të treta, të cilat janë në administrim të Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit Vlorë, ndodhen jashtë qytetit dhe nuk kanë ndikuar në përmbytjen e qytetit gjatë periudhës 4 - 6 tetor 2024.
3. Punimet për ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjellësit kanë ndikuar negativisht në përmbytjen e qytetit. Gjatë reshjeve prurjet kanë marrë me vete dhe inerte nga trasetë e hapura të kalimit të linjave të furnizimit; prurjet e ngurta të krijuara me llumra kanë bllokuar në shumë raste kunetat anësore të rrugëve duke përkeqësuar situatën në kohën e reshjeve me intesitet të lartë.

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Vlorë, e përfaqësuar nga drejtori z. D.Xh., më datë 13.03.2025, të protokolluara në KLSH me nr. 1191/20 prot; datë 17.03.2024; shprehen në lidhje me Projektraportin e Auditimit.

Pretendimi i subjektit: “Në lidhje me gjetjet e grupit të auditimit të KLSH nga ana e Drejtorit të NSHP Vlorë janë marrë një sërë masash të cilat po i rendisim:

Më datë 16.01.2025 me nr. 90 prot, është lëshuar një urdhër me nr. 6, datë 16.01.2025 mbi plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm që duhet mbajtur në hidrovor. Sipas urdhërit të mësipërm Sektori i Bordit të Ujitjes dhe Kullimit duhet të marrë masa për plotësimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, referuar listës së dokumentacionit që duhet mbajtur në hidrovor, në zbatim të udhëzimit Nr. 12 datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”. Më datë 23.10.2024 me nr.1350 prot, është lëshuar një urdhër tjetër me nr. 121, datë 23.10.2024 “Mbi inventarizimin faktik të skemave ujitëse dhe kulluese në administrim të sektorit të bordit të ujitjes dhe kullimit” ku sipas këtij udhëri urdhërohet krijimi i një grupi pune për inventarizimin faktik të skemave ujitëse dhe kulluese në administrim të sektorit të Bordit të Ujitjes dhe Kullimit.

Më datë 16.01.2025 me nr.1350 prot, është lëshuar një urdhër tjetër me nr. 5, datë 16.01.2025 “Mbi sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë për punonjësit në Hidrovorin e Sektorit të Bordit të Kullimit” ku sipas tij urdhërohet se: Punonjësit e hidrovorit duhet të instruktohen çdo muaj për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, sipas udhëzimit Nr. 12, datë 30.12.2019. Për këtë, përgjegjësi i sektorit ka detyrimin të kryejë instruktimin teknik dhe zbatimin e rregullave për sigurimin dhe mbrojtjen. Dokumentacioni i lidhur me këtë proces duhet të pasqyrohet në regjistrin përkatës (sipas aneksit 2 të udhëzimit), të protokollohet dhe të ruhet një kopje në hidrovor. Përgjegjësi i Bordit të Ujitjes dhe Kullimit, Z. Alpin Skendaj, është i ngarkuar me zbatimin e urdhrat dhe marrjen e masave për përmbytjen e detyrimeve.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar komenteve të bëra nga drejtori i NSHP Vlorë z. D. Xh. në observacione të dërguara në KLSH sqarojmë se: Në observacionet e sjella tregohet se ka reagimin institucional nga ana e titullarit të NSHP Vlorë, nuk ka kundërshtime ndaj PRA, dhe në observacionet e sjella konfirmohen gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga GA.

4.5 Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier

Planet e investimit të parashikuara për përmirësimin e sistemit të kullimit. Investimet në ujitje, kullim dhe mbrojtjen nga përmbytjet, që janë realizuar për periudhën 2023-2024, në funksion të sigurimit të menaxhimit të qëndrueshëm dhe produktiv, të sistemeve ujitëse, kulluese, krahas reduktimit të rrezikut të përmbytjeve.

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit (DUK) Fier është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ushtron aktivitetin e saj bazuar në ligjin nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit”, si dhe VKM-në nr. 437, datë 17.05.20217 “Për krijimin,

organizimin dhe funksionimin e drejtorive te ujitjes dhe kullimit Lezhë, Durrës Fier dhe Korçë”.

Struktura e DUK Fier është miratuar me Urdhrin e KM nr. 78, datë 07.05.2024 dhe ka në përbërje 3 sektorë kryesorë: Sektori i Financës, Sektori Teknik, Sektori Hidrovore-Makineri, si dhe ka në varësi 4 sektorë rajonalë: Sektori Fier, Sektori Lushnjë, Sektori Vlorë - Sarandë dhe Sektori Gjirokastër. Në total ky institucion ka 168 punonjës, të cilët kryejnë detyrat sipas pozicioneve të miratuara dhe bazuar në Rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e DUK”, e cila është miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dërguar me shkresën nr. 6706/2, datë 17.10.2019.

Drejtimet kryesore ku ushtron aktivitetin DUK Fier janë:

1. Rehabilitimi dhe mbajtja në gatishmëri e sistemit të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet. Rezulton se ky institucion administron 114,164 ha, të ndara sipas qarqeve: Qarku Fier – 85,380 ha, Qarku Vlorë – 19,334 ha dhe Qarku Gjirokastër – 9,450 ha;

2. Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i objekteve ujitëse që administron DUK Fier, ku rezulton se administron 412 km kanale kryesore që mbulojnë një sipërfaqe prej 55,923 ha, ku përfshihen Rezervuari i Thanës, kanali Vjosë – Levan - Fier, Kanali Llakatund, rezervuari i Doftisë Gjirokastër; Sistemi ujitës i Lumit Bistricë, Sistemi ujitës nga burimet e Ksamilit, sistemi ujitës nga Rezervuari i Janjarit;

3. Kullimi me ngritje mekanike, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hidrovoreve, me synim kullimin dhe mbajtjen në parametra teknikë të 41,570 ha tokë bujqësore. Rezulton se DUK Fier administron 13 hidrovorë me fuqi 14255 kË, si dhe 62 elektropompa me kapacitet 186.2 m³/s, të ndara sipas zonave ku shtrihen: Fieri ka 5 hidrovorë dhe 23 elektropompa, Lushnja ka 3 hidrovorë dhe 19 elektropompa, Vlora ka 3 hidrovorë dhe 11 elektropompa, Saranda ka 2 hidrovorë dhe 9 elektropompa.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DUK Fier, rezultoi se ky institucion ka planifikuar investime në sistemin ujitës dhe kullues për vitin 2023 dhe prioritetet për rehabilitimin e stacioneve të pompimit të kullimit, duhet të kenë parasysh edhe riskun e përmbytjeve.

Për realizimin e mirëmbajtjes së sistemit të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjen nga përmbytjet, DUK Fier, programon realizimin e shpenzimeve për Investime dhe shpenzimeve për Mirëmbajtje.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se DUK Fier për vitin 2023 ka hartuar:

- Plan Pune me nr. 14/2, prot; datë 28.01.2023;
- Program pune me nr. 14/2-1-2, prot; datë 28.01.2023;
- Program pune për Monitorim Performance me nr. 14/1-1, prot; datë 28.01.2023;
- Manuali i proceseve të Punës(Aneksi 3) nr. 14/2-1, datë 28.01.2023;
- Plan Veprimi nr. 14/2-1-4,(bashkëlidhur aneksi).

Gjithashtu ka të pasqyruar risqet që kërcënojnë realizimin e objektivave. Pjesë e dokumentacionit të administruar është Urdhri i Drejtorit të DUK Fier nr. 14/3 prot, datë 19.09.2023 “Për llogaritjen e volumeve që do realizohen për vitet 2024, 2025, si dhe fondin limit bazuar në këto volume”.

Me shkresën nr. 289, datë 16.01.2023, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka dërguar buxhetin e vitit 2023, për shpenzimet korente me vlerë totale 353,800,000 lekë, nga e cila vlera prej 333, 690,000 lekë i përket sistemit kullues.

Për vitin 2024 DUK Fier ka hartuar: Plan Pune viti 2024 me nr. 28/1, prot; datë 31.01.2024; Plan pune vjetor nga Sektori i Financës, Sektori i Hidrovor-makineri, Sektori Vlorë Sarandë; Program Pune vjetor Sektori Fier; Program pune për Monitorim Performance me nr. 28/1-2, prot; datë 30.01.2024. Gjithashtu ka plane mujore pune nga Sektori Lushnje, program pune

mujor Sektori Fier, Sektori Vlorë. Gjithashtu, pjesë e dokumentacionit është Urdhri i Drejtorit të DUK Fier nr. 28/1-1 prot, datë 31.01.2024 “Për detajimin e regjistrit të prokurimeve”.

Me shkresën nr. 484/4, datë 29.01.2024, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka dërguar buxhetin e vitit 2023, për detajimin shpenzimeve operative (shpenzime për mirëmbajtje) me vlerë totale 205,000,000 lekë, nga e cila vlera prej 75,000,000 lekë i përket sistemit kullues; vlera 105,000,000 lekë për hidrovore – makineri; vlera prej 25,000,000 lekë për sistemin ujitës. Ndërsa për **Sektorin Vlorë është miratuar fondi prej 12,688,700 lekë, për pastrimin e kanaleve kulluese** (KK3 Myzeqe, KKP Bunavi, Llakatund dhe KKP Përroi Otimës Selenicë). Me Urdhrin e Drejtorit të DUK Fier nr. 28/1-1 prot, datë 31.01.2024 është ngritur grupi i punës “Për detajimin e buxhetit të vitit 2024 dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e fondeve të buxhetit”. Më pas është bërë shpërndarja e shpenzimeve sipas sektorëve, ku për sektorin e Hidrovorëve është detajuar shpenzime për energjinë në vlerën 90,000,000 lekë, ndërsa për mirëmbajtje dhe remonte hidrovori shpenzime në vlerën 15,000,000 lekë. Ndërsa për **Sektorin Vlorë është miratuar fondi prej 5,891,870 lekë, për pastrimin e kanaleve kulluese** (KK3 Myzeqe, KKP Bunavi, Llakatund dhe KUL Orikum).

Shpenzime kapitale (Investime, zëri 231) për vitin 2024 për DUK Fier është miratuar fondi me vlerë 241,273,130 lekë, nga kjo për Sektorin Vlorë është miratuar fondi prej 99,000,000 lekë.

Me shkresën nr. 5977/1, datë 12.09.2024, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka miratuar shtesa e ndryshime në buxhetin e shpenzimeve kapitale për vitin 2024, ku për Sektorin Vlorë ka miratuar shtesën prej 34,242,000 lekë.

Për sa trajtuar, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, rezulton se nga **DUK Fier nuk ka plane mujore të miratuara për veprimtarinë mujore të institucionit, si dhe mungojnë planet mujore sipas sektorëve për vitin 2023**. Për vitin 2024 janë hartuar planet mujore sipas sektorëve, **por nuk janë paraqitur për miratim në DUK, pasi nuk janë të protokolluara në DUK, si dhe nuk janë të miratuara nga Titullari i Institucionit**, por vetëm nga përgjegjësi i sektorit përkatës, duke mos respektuar përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit nr. 12, datë 30.12.2019 dhe në Rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e DUK Fier”, neni 9 dhe neni 10.

Për sa trajtuar, rezulton se nga DUK Fier janë kryer investime për pastrimin e kanaleve kulluese, **ku për Sektorin Vlorë për vitin 2023 janë planifikuar dhe kryer investime për pastrimin e kanaleve kulluese për objektet: KK3 Myzeqe, KKP Bunavi, Llakatund dhe KKP Përroi Otimës Selenicë**. Gjithashtu janë planifikuar dhe janë kryer investime për mbrojtjen nga përmbytjet për objektet: dy argjinatura në Selenicë, argjinatura Selevec, argjinatura Vallto, argjinatura Panaja, argjinatura krahu i majtë i Lumit Shushicë, argjinatura krahu djathtë i Lumit Shushicë.

Sektorin Vlorë për vitin 2024 ka planifikuar dhe kryer investime për pastrimin e kanaleve kulluese për objektet: KK3 Myzeqe, KK2 Myzeqe, KKP Bunavi, KKP i dërgimit Hidrovori Akerni dhe KKP Përroi Otimës Armen. Gjithashtu janë planifikuar dhe janë kryer investime për mbrojtjen nga përmbytjet për objektet: dy argjinatura në Selenicë, argjinatura Selevec, argjinatura Vallto, argjinatura Panaja, argjinatura krahu i majtë i Lumit Shushicë, argjinatura krahu i djathtë i Lumit Shushicë.

- Dokumentimi i gjendjes së sistemit të kullimit dhe masat e marra nga DUK për rritjen e gatishmërisë në prag të fillimit të stinës së rreshjeve.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se DUK Fier, me shkresën nr. 411/1 prot; datë 27.01.2022, “Mbi dëmtimet në infrastrukturën e kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja”, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në përgjigje të shkresës nr. 8256 prot; datë 20.12.2021, ka informuar lidhur me problematikat e konstatuara në sistemin e kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet. Nga problematikat e paraqitura sipas objekteve dhe vendeve përkatëse, për të cilat është kërkuar ndërhyrje për të

investuar me qëllim përmirësimin e situatës, rezulton se disa nga këto problematika vazhdojnë të pa zgjidhura, konkretisht: Krahu i majtë i Urës së vjetër të Mifolit; Gërryerja në fushën e Çorushit; vendi i quajtur “Kodra e Goricës”; skema F.RK.-1 FuSHA e Cakranit; krahu i majtë i Lumit Shushicë; poshtë kanalit kullues Babicë; argjinatura dhe panele në Lumin Shushicë; vendi i quajtur “Dheu i Bardhë”; Zona e Fitores dhe Novoselës, për shkak të punimeve të autostradës në fshatin Bishqan.

Në zbatim të Urdhri i Ministrit të MBZHR nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”, DUK-të detyrohen që të bëjnë proceset e mëposhtme:

1. Mirëmbajtja vjetore

Mirëmbajtja vjetore, ***përfshin punime të planifikuara si rezultat i inspektimeve / kontrolleve të kryera më parë, të cilat janë të konsiderueshme (punime të mëdha dhe që kërkojnë kohë për t’u realizuar), që nuk mund të kryhen si punime të mirëmbajtjes periodike.***

Këto punime duhet të kryen në periudhat e përshtatshme, kur infrastruktura e ujitjes, kullimit, digat dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja nuk janë në përdorim / shfrytëzim. Në këto punime përfshihen kryesisht:

- a) largimi i sasive të mëdha të mbushjeve në kanalet ujitës, kullues, kanale të ujërave të larta;
- b) riparime të veshjeve me beton në kanalet ujitës, kullues dhe kanale të ujërave të larta;
- c) riparime të strukturave prej betoni dhe metalike të veprave të artit në rrjetin e kanaleve ujitës e kullues;

2. Cikli i mirëmbajtjes përbëhet nga:

a) inspektimi i infrastrukturës/objekteve; **b)** matje e volumit të punimeve; **c)** preventivimi / kostimi i punimeve; **ç)** përcaktimi i buxhetit; **d)** prioritetizimi i ndërhyrjeve të mirëmbajtjes; **dh)** planifikimi i ndërhyrjeve prioritare për buxhetin disponibël; **e)** kontraktimi; **ë)** kryerja e punimeve; **f)** mbikëqyrja e realizimit të punimeve; **g)** kolaudimi dhe marrja në dorëzim; **gj)** pagimi i punimeve të kryera.

3. Organizimi i inspektimeve / kontrolleve të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja

3.1 Përveç kontrolleve të përditshme dhe në raste të emergjencave, gjatë një viti duhet të kryhen së paku dy kontrolle të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja.

i. Një kontroll kryhet në periudhën mars–prill, pas sezonit me reshje dhe para fillimit të sezonit të ujitjes.

ii. Ndërsa kontrolli tjetër kryhet në periudhën shtator–tetor, para fillimit të sezonit me reshje dhe pas përfundimit të sezonit të ujitjes

3.2 Në kontrollin e periudhës mars – prill

3.2.2 Në kullim dhe mbrojtje nga përmbytja:

- a)** kontrollohen kanalet kulluese, kanalet e ujërave të larta dhe argjinaturat e mbrojtjes nga përmbytja, duke vlerësuar ndërhyrjet riparuese të parashikuara për t’u realizuar, si dhe vlerësimin e punimeve të tjera të parashikuara por, që janë të domosdoshme në momentin e mbikëqyrjes dhe që duhen kryer para fillimit të sezonit me reshje (para muajit tetor);
- b)** vlerësohen paraprakisht nevojat për remontin vjetor të hidrovoreve, që kryhet në periudhën pa reshje (zakonisht korrik – gusht);
- c)** bëhet kontrolli i portbarazheve për pozicionimin e duhur të portave.

3.3 Në kontrollin e periudhës shtator - tetor

3.3.2 Në kullim dhe mbrojtje nga përmbytja:

- a)** kontrollohen punimet e kryera në mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, kanaleve të ujërave të larta, argjinaturave të mbrojtjes nga përmbytja;

- b) kontrollonhet kryerja e remonteve të hidrovoreve dhe bëhet testimi me ngarkesë i tyre (mbahet aktkolaudimi përkatës për çdo elektropompë dhe pajisje elektrike);
- c) vlerësohet mundësia e realizimit të ndonjë ndërhyrje për periudhën në vijim, që nuk ka qenë e parashikuar, por që ka dalë gjatë kontrollit.
- ç) kontrolli duhet të garantojë qëndrueshmërinë e plotë të argjinaturave mbrojtëse të lumenjve dhe funksionalitetin e infrastrukturës së kullimit sipas projekteve teknike, për periudhën e pritshme me reshje.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga DUK Fier, Sektori Vlorë, u konstatua se:

- Është mbajtur aktkonstatimi i datës 14.03.2023 nga grupi i punës, i përbërë nga teknik K.K dhe ing. M.H., në bashkëpunim me specialistë të njësisë vendore Novoselë, për pastrimin e kanalit kullues KK3 Akëri, sipas të cilit **ky kanal ka më shumë se 15 vjet i papastruar** dhe është domosdoshmëri pastrimi i tij.
- Është mbajtur aktkonstatimi i datës 24.11.2023 nga grupi i punës, i përbërë nga teknik K.K. dhe ing. M.M, në bashkëpunim me specialistë të njësisë vendore orikum, për pastrimin e kanalit kullues KUL Orikum, sipas të cilit **ky kanal ka më shumë se 15 vjet i papastruar** dhe është domosdoshmëri pastrimi i tij.
- Është mbajtur aktkonstatimi i datës 28.03.2024 nga grupi i punës, i përbërë nga teknik K.K. dhe ing. M.H., në bashkëpunim me specialistë të njësisë vendore Novoselë, për pastrimin e kanalit kullues KK2 Akëri, sipas të cilit **ky kanal ka më shumë se 15 vjet i papastruar** dhe është domosdoshmëri pastrimi i tij.

Nuk administrohet aktverifikimi për periudhën pas sezonit të ujitjes dhe para fillimit të sezonit të shirave të vitit 2024 (Shtator – Tetor).

Sa sipër, rezulton se nuk është zbatuar pika 2.3.3 për inspektimin në periudhën Shtator - Tetor 2024, për kontrollet e punimeve të kryera në mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, remonteve të hidrovoreve, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së plotë të argjinaturave mbrojtëse të lumenjve dhe funksionaliteti i infrastrukturës së kullimit sipas projekteve teknike, për periudhën e pritshme me reshje.

- Me shkresën pa nr. prot, datë 23.02.2023 “Mbi gjendjen e objekteve të mbrojtjes dhe kullimit dhe masat që duhen marrë për përballimin e sezonit të dimrit”, drejtuar DUK Fier, nga Sektori Vlorë, citohet se janë konstatuar problematika që kërkojnë ndërhyrje, duke realizuar mbrojtjen në argjinatura dhe rehabilitim në kanalet kullues si më poshtë:

1. Argjinatura e krahut të majtë të lumit Shushicë, me një gjatësi 2.5 km, në disa segmente ka dëmtime të argjinaturës në Xhuherinë, ku duhet ndërhyrje emergjente për realizimin e mbrojtjes më ndërtimin e paneleve dhe argjinaturës mbrojtëse;
2. Argjinatura krahu i djathtë i lumit Shushicë me gjatësi 6.4 km, është në gjendje jo të mirë, pasi në zonën e Picarit kjo argjinaturë është dëmtuar.
3. Argjinatura Panaja ka probleme dhe ka nevojë për rehabilitim;
4. Kanalet kullues

- Në NjA Novoselë, janë për t’u rehabilituar kanalet kullues, **të cilët janë mbi 15 vjet të papastruar**, si më poshtë, projektet janë hartuar nga studio projektimi për KK3 me gjatësi 4,776 ml dhe $V = 35,000 \text{ m}^3$.

- Në NjA Shushicë, KK Llakatund - Përroi i Bunavisë $L = 3,500 \text{ ml}$, $V = 33,250 \text{ m}^3$;

- Në NjA Armen me $L=1,417 \text{ ml}$ dhe $V = 63,419 \text{ m}^3$.

- Me shkresën pa nr. prot, datë 28.10.2023 “Mbi gjendjen e objekteve të mbrojtjes dhe kullimit dhe masat që duhen marrë për përballimin e sezonit të dimrit”, drejtuar DUK Fier, nga Sektori

Vlorë, citohet se janë konstatuar problematika që kërkojnë ndërhyrje, duke realizuar mbrojtjen në argjinatura dhe rehabilitim në kanalet kullues si më poshtë:

1. Argjinatura e krahut të majtë të lumit Shushicë, me një gjatësi 2.5 km, në disa segmente ka dëmtime të argjinaturës në Xhuherinë, ku duhet ndërhyrje emergjente për realizimin e mbrojtjes më ndërtimin e paneleve dhe argjinaturës mbrojtëse;

2. Argjinatura krahu i djathtë i lumit Shushicë me gjatësi 6.4 km, është në gjendje jo të mirë, pasi në zonën e Picarit kjo argjinaturë është dëmtuar;

3. Argjinatura Panaja ka probleme dhe ka nevojë për rehabilitim;

4. Kanalet kullues

- Në NjA Novoselë, janë për t'u rehabilituar kanalet kullues, të cilët janë mbi 15 vjet të papastruar, si më poshtë, projektet janë hartuar nga studio projektimi. KK3 duhet të përfundojë që të kryejë funksionin e tij, shkarkon në KK2 dhe funksionon 90%. KK2 duhet të përfundojë sepse janë afërsisht 3 km që nuk janë pastruar fare që para 20 vitesh, funksionon në masën 70%, sepse ky kanal kryesor kullues, furnizon hidrovorin e Akërnisë dhe pjesa fundore është pastruar para 13 vitesh. KK4 duhet pastruar, projekti është gati, ka rreth 20 vite pa u pastruar. KK1 që ka rreth 10 vite pa u pastruar, ka nevojë të rehabilitohet.

- Në NjA Shushicë, KK Llakatund - Përroi i Bunavisë, $L = 3,500$ ml, $V = 33,250$ m³, duhet të rehabilitohet për vitin 2024, ka 15 vite pa u pastruar, funksionon në masën 30%;

- Në NjA Armen me $L = 1,417$ ml dhe $V = 63,419$ m³. Si KUL, që ka gjithmonë shumë aluvione duke shtuar më shumë mbushjen e tij dhe bllokimin edhe banorët me mbeturina, për momentin është në funksion.

- Në NjA Qendër, kanali kullues KM & KD Panaja kanë rreth 15 vite pa u pastruar, funksionojnë në masën 40%. KUL Panaja ka rreth 5 vite pa u pastruar, funksionon në masën 70%;

- Në NjA Orikum gjithë skema e kullimit është jashtë funksionit sepse ka ndërtime të paligjshme që nuk na lejojnë të punojmë.

- Me shkresën pa nr. prot, datë 14.02.2024 “Mbi gjendjen e objekteve të mbrojtjes dhe kullimit dhe masat që duhen marrë për përbalimin e sezonit të dimrit”, drejtuar DUK Fier, nga Sektori Vlorë, citohet se janë konstatuar problematika që kërkojnë ndërhyrje, duke realizuar mbrojtjen në argjinatura dhe rehabilitim në kanalet kullues si më poshtë:

1. Argjinatura e krahut të majtë të lumit Shushicë, me një gjatësi 2.5 km, në disa segmente ka dëmtime të argjinaturës në Xhuherinë, ku duhet ndërhyrje emergjente për realizimin e mbrojtjes më ndërtimin e paneleve dhe argjinaturës mbrojtëse;

2. Argjinatura krahu i djathtë i lumit Shushicë me gjatësi 6.4 km, është në gjendje jo të mirë, pasi në zonën e Picarit kjo argjinaturë është dëmtuar;

3. Argjinatura Panaja me gjatësi 5.5 km ka probleme dhe ka nevojë për rehabilitim;

4. Kanalet kullues.

- Në NjA Novoselë, janë për t'u rehabilituar kanalet kullues, të cilët janë mbi 15 vjet të papastruar, si më poshtë, projektet janë hartuar nga studio projektimi për KK3 me gjatësi 4776 ml dhe $V = 35,000$ m³. KK2 me gjatësi 2,975 ml dhe $V = 21,000$ m³;

- Në NjA Orikum është për t'u rehabilituar KUL me $L = 2,500$ ml dhe $V = 7,500$ m³.

- Në NjA Shushicë, KK Llakatund - Përroi i Bunavisë $L = 3,500$ ml, $V = 33,250$ m³;

- Në NjA Armen, KKP Otimes - Armen me $L=1,417$ ml dhe $V=6,3419$ m³.

- Me shkresën pa nr. prot, datë 25.08.2024 “Mbi gjendjen e objekteve të mbrojtjes dhe kullimit dhe masat që duhen marrë për përbalimin e sezonit të dimrit”, drejtuar DUK Fier, nga Sektori Vlorë, citohet se janë konstatuar problematika që kërkojnë ndërhyrje, duke realizuar mbrojtjen në argjinatura dhe rehabilitim në kanalet kullues si më poshtë:

1. Argjinatura e krahut të majtë të lumit Shushicë, me një gjatësi 2.5 km, në disa segmente ka dëmtime të argjinaturës në Xhuherinë, ku duhet ndërhyrje emergjente për realizimin e mbrojtjes më ndërtimin e paneleve dhe argjinaturës mbrojtëse;

2. Argjinatura krahu i djathtë i lumit Shushicë me gjatësi 6.4 km, është në gjendje jo të mirë, pasi në zonën e Picarit kjo argjinaturë është dëmtuar;

3. Argjinatura Panaja me gjatësi 5.5 km ka probleme dhe ka nevojë për rehabilitim;

4. Kanalet kullues.

- Në NjA Novoselë, janë për t'u rehabilituar kanalet kullues, të cilët janë mbi 15 vjet të papastuar, si më poshtë: KK3 duhet të përfundojë që të kryejë funksionin e tij, shkarkon në KK2 dhe funksionon 100%; KK2 funksionon në masën 80%, sepse ky kanal kryesor kullues, furnizon hidrovorin e Akërnisë dhe pjesa fundore është pastruar para 13 vitesh. KK4 duhet pastruar, projekti është gati, ka rreth 20 vite pa u pastruar; KK1 që ka rreth 10 vite pa u pastruar, ka nevojë të rehabilitohet. Projektet janë hartuar nga studio projektimi.

- Në NjA Shushicë, KK Llakatund - Përroi i Bunavisë $L = 3,500$ ml, $V = 33,250$ m³, duhet të rehabilitohet për vitin 2024, ka 15 vite pa u pastruar, funksionon në masën 30%;

- Në NjA Armen me $L = 1,417$ ml dhe $V = 63,419$ m³. Si KUL, që ka gjithmonë shumë aluvione duke shtuar më shumë mbushjen e tij dhe bllokimin edhe banorët me mbeturina, për momentin është në funksion.

- Në NjA Qendër, kanali kullues KM & KD Panaja kanë rreth 15 vite pa u pastruar, funksionojnë në masën 40%. KUL Panaja ka rreth 5 vite pa u pastruar, funksionon në masën 70%;

- Në NjA Orikum gjithë skema e kullimit është jashtë funksionit sepse ka ndërtime të paligjshme që nuk na lejojnë të punojmë.

- Nga dokumentacioni i siguruar nga Sektori Vlorë - Sarandë, Inventari i detajuar i kanaleve në administrim të Sektorit Vlorë, është sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur.

Referuar të dhënave pasqyruar në tabelë, rezulton se Sektori Vlorë (Rrethi Vlorë), ka në administrim 6 skema kullimi, konkretisht:

1. Skema e kullimit Myzeqe, e cila ka 12 kanale kryesore kulluese, me gjatësi totale 26 km dhe mbulon një sipërfaqe prej 1100 hektar, nga ku **rezulton se kanalet nuk janë pastruar për një periudhë mbi 10 vjeçare;**

2. Skema e kullimit Myzeqe Hidrovor Akërnë, e cila ka 9 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 45 km dhe mbulon një sipërfaqe prej 4,500 ha, nga ku rezulton se ka përfunduar pastrimi në 2 kanale KK2 dhe KK3, me gjatësi totale 22.6 km, **ndërsa 7 kanale me gjatësi totale 22.4 km, rezultojnë të pa pastruar për një periudhë mbi 10 vjeçare;**

3. Skema e kullimit Hidrovor Goricë, e cila ka 7 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 22 km dhe mbulon një sipërfaqe prej 1050 hektar, nga ku rezulton se ka përfunduar pastrimi në kanalin KUL Panaja, me gjatësi totale 5 km, **ndërsa 6 kanale me gjatësi totale 16 km, rezultojnë të pa pastruar për një periudhë mbi 10 vjeçare;**

4. Skema e kullimit Llakatund VLK4, e cila ka 6 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 18 km dhe mbulon një sipërfaqe prej 1600 hektar nga ku **rezulton se kanalet nuk janë pastruar për një periudhë mbi 10 vjeçare;**

5. Skema e kullimit Llakatund VLK5, e cila ka 11 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 23 km dhe mbulon një sipërfaqe prej 1200, nga ku rezulton se ka përfunduar pastrimi në kanalin "peroi I Otimës Armen", me gjatësi totale 6 km, **ndërsa 10 kanale me gjatësi totale 17 km, rezultojnë të pa pastruar për një periudhë mbi 10 vjeçare;**

6. Skema e kullimit Dukat - Tragjas, e cila ka 25 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 34.3 km dhe mbulon një sipërfaqe prej 1800 hektar nga ku rezulton se është pastruar kanali "Right Br Orikum", me gjatësi totale 0.8 km, **ndërsa 25 kanale me gjatësi totale 33.5 km, rezultojnë të pa pastruar për një periudhë mbi 10 vjeçare;**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për vitet 2023, 2024 janë planifikuar dhe realizuar pastrimet për disa kanale sipas Aneksit nr. 2 bashkëlidhur këtij raporti.

Nga kanalet e planifikuara për t'u pastruar referuar planeve për vitin 2023 dhe 2024, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se ka përfunduar pastrimi i kanaleve KK-3 dhe

KK-2, ndërsa nuk janë realizuar përfundimisht kanalet KKP Bunavi, KKP Otimes Armen, KKP Otimes Selenicë (informacion më i detajuar në Aneksin nr. 2 bashkëlidhur raportit).

Nisur nga këto informacione, nga Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të DUK (e miratuar nga MBZHR), si dhe nga planet vjetore 2023, 2024, grupi i auditimit konstaton:

- Mos-kryerja e mirëmbajtës vjetore e të gjithë sistemit të kullimit, ka si shkak edhe mungesën e kapaciteteve teknike, pasi në Rajonin e Vlorës, disponohet vetëm një mjet eskavator që përdoret për pastrimin e kanaleve. Mos-kryerja e mirëmbajtës vjetore në të gjithë sistemin e kullimit, nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në UM të MBZHR dhe Rregulloren e Brendshme të DUK Fier, neni, pika 1 “*Mirëmbajtja*”.

- Kanalet e kullimit dhe të ujitjes rezultojnë të papastruara për një kohë shumë të gjatë;

- Në zbatim të nenit 5 të Rregullores, gërma e), nuk është bërë në mënyrë të vazhdueshme hartimi dhe plotësimi i regjistrave të shfrytëzimit për mbikëqyrjet, vrojtimit, matjet, duke shënuar mbushjet, zbrazjet, shkarkimet, manovrimet e portave, matjet, kontrollet, incidentet që konstatohen (filtrime, rrjedhje uji, plasaritje, etj.), ngjarjet hidro-meteorologjike të veçanta, lëkundje sizmike dhe pasojat e tyre, punimet e mirëmbajtjes, përmirësimet dhe riparimet e kryera në objekt, etj.

- Në aktkonstatimet e periudhës Mars – Prill, nuk ka vlerësime për ndërhyrjet riparuese të parashikuara për t’u realizuar;

- Në aktkonstatimet e periudhës Shtator - Tetor, nuk ka procesverbale pas kontrolleve për punimet e kryera në mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, kanaleve të ujërave të larta, argjinaturave të mbrojtjes nga përmytja;

- Nuk administrohen procesverbale për kontrollet e përditshme të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit;

- Nuk ka asnjë procesverbal kontrolli për pjesën e poshtme të rrjedhës, detyrë që sipas pikës 6.5.1.11 të UKM nr. 12, datë 30.12.2019 “*Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit*”, duhet bërë tre herë në vit, me qëllim konstatimin e pengesave të shkarkimeve dhe marrjen e masave për shkarkim normal të ujërave;

- Nuk janë respektuar prioritetet lidhur me planifikimin edhe kryerjen e investimeve në objektet e identifikuar dhe konstatuara me dëmtime (argjinaturave), mos-marrja e masave për eliminimin e problematikave të konstatuara në këto zona, përbën risk të lartë për përmytje, kur ka reshje me intensitet të lartë;

- Nuk administrohet procesverbale formalë në lidhje me kontrollet në hidrovore dhe për nevojat për remonte vjetore të tyre;

- Të gjithë hidrovorët duhet të furnizohen me dy linja elektrike paralele, sipas informacionit të DUK Fier;

- Hidrovori Akërnë nuk punon me kapacitet të plotë, sepse niveli i tensionit në hidrovorin Akërnë nga ora 07:00 deri në orën 23:00 është 360V, kjo pasi në linjën e furnizimit të hidrovorit marrin energji subjekte private. Hidrovori Akërnë nuk ka punuar me kapacitet të plotë ($Q=18.35 \text{ m}^3/\text{sek}$. $P_n=11 \text{ KW}$), por me 45% të kapacitetit.

Gjithashtu rezulton se DUK Fier, nuk ka kryer regjistrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të aseteve, mbi të cilët është vendosur sistemi kullues dhe i mbrojtjes nga përmytjet, së bashku me strukturat përkatëse. Kjo kërkesë është e përcaktuar në ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020 dhe ligjin nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “*Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit*”.

4.6 Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë Në lidhje me Ujësjiellës - Kanalizime Vlorë SHA:

I. Ujësjiellës - Kanalizime Vlorë SHA, ka funksionuar në bazë të Vendimit nr. 26332, datë 10.07.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, Statutit të shoqërisë miratuar me Vendimin

nr. 35, datë 21.07.2016 të Asamblesë së Aksionerëve dhe Rregullores së Brendshme të funksionimit. UKV SHA, ka mbuluar me shërbim Vlorën, Novoselën, Orikumin dhe Shushicën.

II. Me Vendimin e Këshillit Bashkiak Vlorë nr. 30, datë 21.06.2012 “Për transferimin e Sektorit të Kanalizimeve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike pranë Ujësjetllësit Vlorë SHA”, ka vendosur:

1. Të transferojë Sektorit e Kanalizimeve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publik të Bashkisë Vlorë në Shoqërinë Ujësjetllës - Kanalizime Vlorë SHA, së bashku me të punësuarit, mjetet mekanike dhe fondet financiare të parashikuara për këtë sektorë për vitin 2012;
2. Të punësuarit dhe mjetet mekanike të Ndërmarrjes së Shërbimit Publik, të cilët nuk përfshihen në sektorët e përcaktuar në pikën 1, por që janë në funksion të kanalizimeve dhe hidrovorëve, së bashku me mjetet financiare të planifikuara, të transferohen në Ujësjetllës - Kanalizime Vlorë SHA;
3. Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 2012 Ndërmarrja e Shërbimeve Publik të Bashkisë Vlorë dhe Ujësjetllës - Kanalizime Vlorë SHA të përgatisin strukturën organizative, të planifikojë fondet financiare dhe të bëjnë inventarizimin e mjeteve, në përshtatje me ndryshimet që rrjedhin nga transferimi i sektorëve, sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi;
4. Të miratojë tarifën e ujërave të zeza 11 lekë/m³ pa TVSh;
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Shoqëria Ujësjetllës - Kanalizime Vlorë SHA;
6. Ky Vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 8562, datë 31.07.2000, neni 33, pika 6.

- Në Urdhër nr. 114, nr. 4247 prot; datë 08.10.2015 “Për transferimin e Sektorit të Kanalizimeve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike pranë SHA Ujësjetllësit Vlorë” të z. D. L., Kryetar i Bashkisë Vlorë, citohet:

1. Të fillojë procedurat për transferimin e Sektorit të Kanalizimeve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike pranë SHA Ujësjetllësit Vlorë sipas përcaktimeve të VKB nr. 30, datë 21.06.2012;
2. Procedurat e përcaktuar në pikën 1 të kryhen brenda muajit Nëntor 2015;
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime, të cilët janë të detyruar të japin informacion çdo dy javë pranë Kryetarit të Bashkisë.

Dorëzimi i aseteve është realizuar sipas akteve:

Akti i dorëzimit nr. 1, datë 10.03.2016, midis z. E.H., drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe znj. V. Gj., drejtor i UK SHA, për vlerën kontabël të kanalizimeve me shumën sipas inventarit në shumën 143,447,849 lekë (21,002,835 lekë amortizimi);

Akti i dorëzimit nr. 2, datë 12.04.2016, midis z. E.H., drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe znj. V. Gj., drejtore e UK SHA, për vlerën kontabël të pajisjeve dhe makinerive sipas inventarit në shumën 29,704,750 lekë (28,224,824 lekë amortizimi);

Akti i dorëzimit nr. 3, datë 12.04.2016, midis z. E.H., drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe znj. V. Gj., drejtore i UK SHA, për vlerën kontabël të stacioneve të pompimit me shumën sipas inventarit në shumën 6,142,208 lekë (5,301,043 lekë amortizimi), dhe ndërtesat e stacioneve të pompimit me shumën sipas inventarit në shumën 4,241,360 lekë (1,233,377 lekë amortizim). Gjatë vitit 2023, sektori ujësjetllës kanalizimeve ka patur ndryshime thelbësore sa i përket riorganizimit dhe operimit të tij, në zbatim të VKM-së nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura”, i cili në përfundim e rregullon sektorin UK në 15 shoqëri UK Rajonale si subjekte me kompetenca të përbashkëta, nga 58 shoqëri UK që ofronin më parë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimin e ujërave të ndotura.

Në zbatim të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022 “Për politikat kombëtare për organizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, që konsiston në krijimin e shoqërive të reja të agreguara aksionare, sipas sistemit me dy nivele administrimi, në përputhje me përcaktimet në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, është lidhur marrëveshja për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta midis bashkive Vlorë, Selenicë dhe Himarë dhe MIE, në datë 13.07.2023.

Me shkresën nr. 2533 prot; datë 31.07.2024 “Kërkesë për transferimin e Aktiveve Afat Gjata në shërbimin e largimit të ujërave të bardha” të z. S.K, administrator i SHRUKV SHA, drejtuar Këshillit të Administrimit (z. J. Gj. - Kryetar; z. S.K., z. O.D., znj. E.T., znj. N.A., znj. A.M., znj. I.D. – Anëtarë).

Me Vendimin nr. 09, nr.23 prot; datë 31.07.2024, Këshilli Mbikëqyrës, ka vendosur:

1. Miratimin e propozimit të shoqërisë për transferimin e asetëve të ujërave të bardha tek Bashkia Vlorë, referuar kërkesës me nr. 2533 prot; datë 31.07.2024, bashkangjitur inventarin e objekteve për transferim.

Bazuar ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, shoqëruar më pas me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik të Ministrisë së Bujqësisë”, VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”, Bashkia Vlorë nuk e ka përfunduar procesin e transferimit të asetëve të skemave ujitëse, kulluese, pajisjeve, stacioneve dhe digave të rezervuarëve.

Sistemi i grumbullimit të ujërave në varësi të SHRUKV SHA përbëhet nga kanalet e ujërave të larta (sekondar dhe tercial), KUB, KUZ dhe Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN), stacionet e pompimit dhe hidrovorët e qyteti, paraqitur e detajuar në Aneksin nr. 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

a. Planet e investimit të parashikuara për përmirësimin e sistemit të kullimit

Investimet në ujitje, kullim dhe mbrojtjen nga përmbytjet, që janë realizuar për periudhën 2023-2024, në funksion të sigurimit të menaxhimit të qëndrueshëm dhe produktiv, të sistemeve ujitëse, kulluese, krahas reduktimit të rrezikut të përmbytjeve.

Nga informacioni i vënë në dispozicion, rezulton se **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë** nuk ka hartuar plane investimi, si dhe nuk ka kryer investime për periudhën 2023 - 2024, lidhur me përmirësimin e sistemit kullues dhe mbrojtjen nga përmbytjet në Qytetin e Vlorës dhe në zonat urbane në juridiksion të saj. Këto veprime nuk janë në përputhje me përcaktimet ligjore në nenin 15, të ligjit nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”.

2. Dokumentimi i gjendjes së sistemit të kullimit dhe masat e marra nga institucionet e përfshira në këtë program auditimi, për rritjen e gatishmërisë në prag të fillimit të stinës së reshjeve

Nga sa përshkruhet më sipër, kanalet e sipërcituara kanë kaluar nga Bashkia Vlorë tek Ujësjiellësi Vlorë SHA (sot, SHRUKV SHA).

Nga auditimi konstatohet që nga UKV SHA dhe SHRUKV SHA nuk është planifikuar apo realizuar asnjë investim në sistemin e kullimit në vitet e fundit.

Janë pastruar për herë të fundit nga Bashkia Vlorë në vitin **2018**: Kanali i ujërave të larta i hapur, nga hidrovori deri te Ish - Parku i Mallrave dhe vazhdimi; kanal i mbuluar i ujërave të larta me panele b/arme HD = 4.5 m; soletina, Parku - Taverna; Lirim –Taverna.

Sa më sipër në opinionin e grupit të auditimit, mangësitë në mirëmbajtjen e KUB, kolektorëve dhe kanaleve kryesore kullues, është arsyeja kryesore e përmbytjes së qytetit.

Pastrimi i kanaleve dhe rehabilitimi i sistemit kullues është një detyrë urgjente, sepse pa një funksionim të mirë të kullimit qyteti është i rrezikuar gjithmonë nga përmbytjet.

b. Kanalizimet e Ujërave të Ndotura

Rrjeti i KUN në qytetin e Vlorës, referuar inventarit të vitit 2023 përbëhet nga:

Nr.	Diametri i tubit të jashtëm	Njësia	Sasia
	Tub KUZ D=250 HDPE	ml	8,421
	Tub KUZ D=300 HDPE	ml	797
	Tub KUZ D=400 HDPE	ml	2,859
	Tub KUZ D=500 HDPE	ml	1,910
	Tub KUZ D=600 HDPE	ml	2,242
	Tub KUZ D=630 HDPE	ml	2,124
	Tub KUZ D=250 HDPE	ml	1,453
	Tub KUZ D=250 HDPE	ml	1,971
	Shuma		21,777
	Kamatakis	km	21.777
	Puseta B/A h=1.5m – 6m	copë	536
	IPA	km	43
	ANK	km	22
	TOTAL	km	86.77

Komisioni i inventarizimit me përbërje: z. A.Gj., Z. M.N. e z. S.N, është ngritur në zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr. 2454 prot; datë 19.10.2023, e nr. 2688 prot; datë 14.11.2023, është realizuar inventari për rrjetin e kanalizimeve.

Problematika të konstatuara nga auditimi në terren:

Në territorin e Bashkisë Vlorë, nuk funksionojnë të ndara KUN dhe KUB.

Në kanalet e ujërave të ndotura në Qytetin e Vlorës nuk qarkullojnë vetëm ujërat e ndotura kur ka rreshje të dendura, pasi për të shmangur përmbytjet, punonjësit e UK hapin pusetat për depërtimin e ujërave sipërfaqësor të cilat përzihen me ujëra të ndotura, duke shumëfishuar volumin e fluidit që duhet të largohet nga pompat në stacionet KUN.

KUB në territorin e Bashkisë Vlorë:

Kanale e ujërave të bardha në Qytetin e Vlorës (që derdhen në gjirin e Vlorës) nuk derdhen në det vetëm ujërat sipërfaqësor, por edhe ujëra të ndotura që shkarkohen në këto kanale nga familje / subjekte që i shkarkojnë ujërat e ndotura në kanalet e hapura. Nga SHRUKV SHA, nuk është identifikuar gjendja faktike dhe nuk është realizuar asnjë pastrim i tyre.

Në opinionin e grupit të auditimit, mospastrimi i kanaleve të hapura është shkaku kryesor për përmbytjen e datës 04.10.2024, pasi janë arteriet kryesore të kullimit të reshjeve për relievin e qytetit. Disa nga këta kanale janë të papastruar mbi 30 vite dhe janë të bllokuar nga aluvionet dhe mbeturinat e ndryshme.

Nga auditimi në terren konstatohet që pjesa dërmuese e pusetave të KUB janë jashtë funksionit pasi janë të papastruara nga mbeturina dhe inerte, e kanë dimensione që nuk përballojnë rreshjet.

Në territorin e Bashkisë Vlorë nga SHRUKV SHA, nuk janë inventarizuar dhe nuk është planifikuar ndërhyrje për pastrimin e kanalizimeve të ujërave të bardha.

c. Stacionet e Pompimit të Ujërave të Bardha (Hidrovorët e Qytetit)

1. Stacioni i KUB 4 katet (Kume 1) në përbërje të tij ka 2 pompa. Fillimisht u testua paneli i komandimit, si dhe sistemi i emergjencës së energjisë të cilat rezultuan në rregull;

2. Stacioni i KUB 4 katet (Kume 2) në përbërje të tij ka 1 pompë. Ky stacion nuk ka pompë rezerve, sipas konstruksionit të tij që nga ndërtimi;

3. Stacioni nr. 115 KUB (Transballkanike) në përbërje të tij ka 2 pompa. Stacioni, për shkak të prurjeve tepër të mëdha, nuk arriti t'i përballoste prurjet e ardhura nga rreshjet e datës 04.10.2024.

d. Stacionet e Pompimit të Ujërave të Ndotura.

1. Stacioni nr. 102/1 (ish Makaronat) në përbërje të tij ka 4 pompa, plus dhe 3 pompa rezervë. Stacioni gjatë testimit nuk pati probleme dhe ngarkesa gjatë testimit ishte e plotë (220A);

2. Stacioni nr. 195 (ish Parku i Tregtisë) në përbërje të tij ka 3 pompa. Fillimisht është testuar sistemi i emergjencës së energjisë, paneli i komandimit dhe stacioni ka rezultuar i rregullt. Në këtë stacion në situata të reshjeve të dendura dhe prurjeve të mëdha, punohet me derdhje emergjente në det, pasi puna e pompave në rrjetin e KUZ rëndon situatën në pjesën më të madhe të qytetit;

3. Stacioni nr. 204 (ish Rrobaqepësia) në përbërje të tij ka 3 pompa. Është kryer testimi i stacionit, i cili ka rezultuar i rregullt. Ky stacion punon me 2 pompa dhe me dalje emergjente në det në rastet që ka reshje të dendura, për shkak të mos rëndimit të rrjetit KUZ dhe rrjetin vijues që presin ujërat e këtij stacioni;

4. Stacioni nr. 208 (Delfini) në përbërje të tij ka 3 pompa. Fillimisht është testuar paneli i komandimit si dhe sistemi i emergjencës së energjisë, të cilat kanë rezultuar në rregull;

5. Stacioni nr. 209 (Plazhi i Ri) në përbërje të tij ka 3 pompa. Fillimisht është testuar paneli i komandimit, si dhe sistemi i emergjencës së energjisë të cilat rezultuan në rregull. Ky stacion në raste të reshjeve të dendura të shirave, shkarkon në det për të mos rënduar linjat në situata të natyrës emergjente;

6. Stacioni nr. 210 (pranë Tunelit) në përbërje të tij ka 2 pompa;

7. Stacion tek Albano Romina në përbërje të tij ka 1 pompë.

Nga auditimi në terren konstatohet që tre nga gjashtë Stacionet e Pompimit të Ujërave të Ndotura, kanë dalje emergjente në det në rastet që ka reshje të dendura, fenomen i ndodhur edhe më datë 04.10.2021.

Është vendosur një pompë tek “Albano Romina”, e cila ujërat e ndotura të përziëra me të bardhat i pompon në tubacionin e ujërave të bardha të rrugës “Transballkanike”.

Në momentin e fillimit të reshjeve të shiut, stacionet e KUZ të cilat përballojnë dhe fluksin më të madh të prurjeve, pasi në momentin e mbingarkesës në qytet hapen të gjitha kapakët e rrjetit KUZ, duke bërë që niveli në stacione të kalojë pikën maksimale. Në këtë situatë emergjente në stacione janë vendosur në punë edhe pompat rezervë të tyre të cilat kanë punuar të sforcuara deri në normalizimin e situatës.

Nuk janë konstatuar problematika teknike të tyre, gjë e cila pasqyrohet edhe nga raportet e shpeshta në grupin e raportimit të situatës me përjashtim të stacionit nr. 115 KUB, i cili u përmyt, dhe me ndihmën e ushtrisë u rivendos sërish në punë.

Në të gjithë stacionet prej datës 04.10.2024 në mëngjes dhe deri në normalizimin e situatës në datën 08.10.2024, pompat e këtyre stacioneve kanë punuar pa ndalesë, pa marrë parasysh kushtin teknik i cili nuk e lejon. **Gjatë kësaj kohe është konstatuar prania e madhe e inerteve të ndryshme në rrjetin e kanalizimeve, të shkaktuara edhe nga ndërtimi i ujësjellësit të ri në të gjitha rrugët e qytetit të Vlorës.**

Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN)

KLSH ka zhvilluar auditim të projektit të impiantit të Vlorës (ITUN). Nga këto audime u konstatua që nga zbatuesit e projekteve ka pasur shkelje e mangësi të theksuara, të shoqëruara edhe me moskoordinim të punëve ndërmjet strukturave të ndryshme përgjegjëse. Për rastet në fjalë, Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve në fjalë, ka barrën kryesore të përgjegjësisë pasi nuk bashkëvepron me strukturat që janë përfituesit fundor të investimit. Sipas raportit që përmendëm, në shumë raste këto të fundit janë të përfshira më tepër në aspektin formal dhe vetëm në momentin kur duhet

të marrin në dorëzim investimin përkatës, moment në të cilin janë bërë të qarta problemet administrative apo ato teknike. Në rastin e impiantit të Vlorës, problemet shkojnë edhe më thellë, pasi kemi edhe ndërprerje të financimeve të huaja, pa të cilat kjo vepër me shumë rëndësi për zhvillimin e zonës, nuk do ta ketë të lehtë funksionimin.

Projekti me objekt: *“Ndërtimit i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”*, ka probleme të dukshme në tërësinë e tij dhe nuk ka realizuar objektivat e kontratës së nënshkruar.

Në projektin fillestar, të financuar nga fondet IPA të BE-së, parashihej ndërtimi i një impianti për trajtimin e ujërave të ndenjura. Ky impiant u ndërtua, por fatkeqësisht nuk e kryen funksionin për të cilin ishte dhënë financimi nga BE. Ai funksionon vetëm për largimin e mbetjeve mekanike dhe yndyrat / vajrat nga ujërat e ndotura, por jo nga elementët kimikë dhe bakteriologjikë, që janë problemi kryesor i ndotjes së ujërave që derdhen në det. Ky handicap i rëndë ka ardhur për shkak të mungesës së komunikimit ndërmjet zbatuesit dhe përfituesit final të projektit, Ujësjellës - Kanalizime Vlorë SHA. Palët kanë nisur të zbulojnë problemet, vetëm në fazën e fundit të punimeve, pra kur kishte përfunduar ndërtimi i impiantit. **Koordinatorët e IPA, me të mësuar problemet e krijuara, kanë ndërprerë financimet dhe fondi i nevojshëm prej 3.4 mln euro tashmë nuk mund të përfitohet. Si rezultat, pavarësisht punës së bërë, fondeve të shpenzuara, qëllimi kryesor i projektit nuk u arrit.**

Në zanafillë, projekti synonte uljen e ndotjes së ujit, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të shëndetit për popullsinë e Bashkisë Vlorë dhe zhvillimin e rajonit përmes zgjerimit të rrjetit të kanalizimit. Parashikohej që në fund të projektit, pjesa dërrmuese e popullsisë së Bashkisë Vlorë të ishte e lidhur me rrjetin e kanalizimit në masën e projektuar, 90 % të popullatës. Por ky projekt nuk është realizuar veçse në masën 80% të perimetrit në kufijtë administrativë të Bashkisë Vlorë. Vlora është një ndër qarqet me një industri turizmi mjaft të fuqishme për kushtet e vendit tonë, e cila është e lidhur fort me detin.

Nëse nuk arrihet të frenohet ndotja e ujërave që derdhen në det, atëherë kjo industri dhe për pasojë, të ardhurat në kasat e shtetit dhe të operatorëve privatë, marrin një goditje mjaft të rëndë. Kjo situatë është shkaktuar së pari nga paaftësia e autorëve të projektit të cilët kanë parashikuar një impiant vetëm për ujërat e zeza, ndërsa duhet të bëhej një projekt i llogaritur “për një rrjet të kombinuar të ujërave të bardha me atë të ujërave të zeza, siç edhe është faktikisht rrjeti i kanalizimeve të Qytetit të Vlorës”. Ndërkaq, moskomunikimi mes palëve, në asnjë prej fazave të para të projektit, solli këtë pasojë të pariparueshme ku financimet e huaja erdhën, por nuk e realizuan qëllimin për të cilin ishin paracaktuar. Ndërkaq, bllokimi i financimeve shtesë prej 3.4 mln euro nga fondet IPA është një fakt mjaft i rëndë për realizimin e qëllimit final të këtij projekti.

Nga auditimi në terren u konstatua që:

I. Në ITUN janë të instaluar 4 elektropompa FLYGHT, nga të cilat vetëm 2 copë janë në gjendje pune:

1. Elektropompa nr. 1, është jashtë pune, paneli elektrik në gjendje fizike i rregullt, elektromotori në bazë të matjes rezulton 0 omega;
2. Elektropompa nr. 2, është jashtë pune, paneli elektrik në gjendje fizike i rregullt, elektromotori në masë fazë-fazë, dhe fazë në trup;
3. Elektropompa nr. 3, është në punë me parametra N = 58 KË; rrymat 82A; U 3 fazor = 420 Volt; Frekuenca 50 Hz; Q = 450 l/sek, në varësi të prirjes, në çertifikatë kemi këto të dhëna 58 KË; 112 A; 3 faza; 50 Hz; Nr. 985 rot/min;
4. Elektropompa nr. 4, është në punë me parametra N = 58 KË; rrymat 82A; U 3 fazor = 420 Volt; Frekuenca 50 Hz; Q = 450 l/sek, në varësi të prirjes, në çertifikatë kemi këto të dhëna N = 58 KË; Q = 450l/sek, 112 A; 3 faza; 50 Hz; Nr. 985 rot/min.

II. Elektrokompresorët e ajërimit:

Një është në gjendje pune, një jashtë pune dhe një ka nevojë për remont. (Të dhënat janë: Rryma = 20 A; Frekuenca 50 Hz; Tension 4200 VN = 11 KW.

III. Pompat e riciklimit të llumit: fizikisht në punë 15 A; 5 Hz; 420 V, në gjendje 2 pompa të përzjerjes së llumit. Pompa e shkarkimit të llumit në gjendje pune.

Sqarojmë që: Gjatë rreshjeve, mosfunktionim normal i KUB, detyron punonjësit e KUZ të hapin pusetat e ujërave të ndotura në mënyrë që të ul nivelin e ujit në zonat e qytetit.

ITUN funksionon me gjysmën e kapaciteti, dhe në kohën kur nuk përballon prurjet në stacion (që nuk janë vetëm të ndotura, por edhe të bardha) derdhen në vaskën e thithjes së hidrovorit.

3. Dokumentimi i procesit të transferimit të objekteve nga Bordi i Kullimit Fier tek Bashkia Vlorë dhe procedura e ndjekur për kontabilizimin e aseteve të transferuara

Referuar VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”. Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier: Zona e shërbimit përfshin qarqet Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë;

a) **Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, sipas tabelave 1 dhe 1/1,** (Bashkia Vlorë – 15 pasuri) paraqitet e detajuar në Aneksin nr. 4 bashkëlidhur këtij raporti.

b) Aseteve të paluajtshme, nga bordet e kullimit të bashkitë në territorin e të cilave është vendndodhja e tyre, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi. Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave i vihen në dispozicion për përdorim falas nga 2 zyra të çdo ndërtese, si dhe një pjesë e truallit për parkimin e mjeteve motorike.

Tabela 2 - Tabela e aseteve të qëndrueshme

Bordi Kullimit	Bashkia ku ndodhet	Përshkrimi i objekti	Sip. truall m2	Sip. Ndërtese/m2
Bordi i kullimit Vlorë	Bashkia Vlorë	1. Zyra	1,199	347
		2. Ambiente të tjera N/1		288
		3. Ambiente të tjera N/2		16
	Bashkia Sarandë	1. Zyra		206

c) Makinerive të rënda (ekskavatorë), sipas tabelës 3, bashkëlidhur këtij vendimi:

Tabela nr. 3

Nr.	Bashkia	Makineritë	Mjeti 1		Mjeti 2	
			Emërtimi i mjetit	Nr. ID	Emërtimi i mjetit	Nr. ID
	Vlorë					
		1	Ekskavator Fiat Hitachi EX255, me Zinxhir, krahgjatë, (prodhim i vitit 2000)	MFG 225ML0223 Nr 04966		

ç) Hidrovorit të qytetit, Bashkia Vlorë, së bashku me skemën përkatëse të kullimit, sipas tabelës 4, bashkëlidhur këtij vendimi:

Tabela nr. 4

Kapaciteti total i hidrovorit hidrovori i projektuar në m3/sek	21 m ³ /sek
Fuqia elektrike e instaluar në KË	1400
Sipërfaqja që kullon në ha	4000

4. Masat e marra dhe administrimi i situatës gjatë dhe pas përmbytjeve. Bashkëpunimi ndërinstytucional për përballimin e kësaj situatë, në funksion të ndihmës së dhënë për qytetarët e dëmtuar nga përmbytjet

Konstatohet që ka bashkëpunim të dobët ndërmjet institucioneve. Skema e kullimit është një skemë që nuk është 100% në vartësi të bashkisë dhe institucioneve të saj. Kanalet e dyta e të treta janë objekt pune i bashkisë dhe ato të para në vartësi të bordit të kullimit, që për Vlorën ndodhet në autoritetin e DPUK Fier. Një skemë e tillë kërkon koordinim institucional dhe vullnet të mirë në mënyrë që të harmonizohen ndërhyrjet në skemë për rritjen e efikasitetit të kullimit. Deri tani ky bashkëpunim është minimal dhe ka nevojë për rritje të komunikimit dhe planifikimit të përbashkët dhe të koordinuar. Nuk ka kuptim funksionimi i kanaleve të dyta e

të treta dhe jo funksionimi i të parave, po kështu dhe anasjelltas. Kjo mënyre organizimi e vë në pikëpyetje realizimin e objektivave.

Mungesa e trajnimeve dhe specializimeve

Si funksion i ri i ardhur në Bashki, SHRUKV është e nevojshme që stafet e këtyre strukturave si në nivel bashkie, bordi, por edhe në nivel njësie administrative, të trajnohen në mënyrë që të ofrojnë këtë shërbim në kushtet dhe në linjë të plotë me kompetencat dhe organizimin në nivel vendor. Një pjesë stafi është trashëguar nga bordet e kullimit dhe ato akoma nuk e mendojnë këtë shërbim si pjesë e vendimmarrjes. Arsyet e mësipërme rrezikojnë deri në një farë mase realizimin e objektivave të Planit të Veprimit të përmirësimit të shërbimit në SHRUKV dhe Bashkinë e Vlorës sa i përket Sistemit të Kullimit.

5. Investimeve infrastrukturore të realizuara në territorin e Bashkisë së Vlorës dhe ndikimi i tyre në situatën e përmbytjeve

Nga konstatimet në terren dhe gjatë situatës emergjente të përmbytjes, është konstatuar prania e madhe e inerteve të ndryshme në rrjetin e kanalizimeve të shkaktuara edhe nga ndërtimi i ujësjellësit të ri në të gjitha rrugët e qytetit të Vlorës.

Studimet e fizibilitetit dhe inventarizimi i detajuar të rrjetit të kanaleve ujitëse, kullues dhe veprave të artit janë të nevojshëm për klasifikimin e ndërhyrjeve sipas prioriteteve, hartimin e planit të administrimit të aseteve dhe gjetjen dhe mobilizimin e burimeve për investime kapitale. Kjo gjithashtu do të kërkonte dhe përmirësimin e efikasitetit të procedurave të administrimit dhe prokurimit të kontratave. Gjithashtu, dhe për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin i stacioneve të pompimit është e nevojshme të përmirësohen nëpërmjet rehabilitimit dhe trajnimit të stafeve të tyre.

Nuk evidentohet pastrimi i kunetave dhe pusetave të shiut, mos-kryerja e këtij procesi në mënyrë periodike, krijon premisë për bllokimin e kanaleve të kullimit, për shkak të grumbullimit të materialeve dhe mbetjeve në pika të ndryshme të tubacionit të kullimit.

Nga verifikimi i bërë në terren, në të gjithë sistemin e kullimit në Qytetin e Vlorës, rezulton se kanalet dytësore që përbëjnë skemën e kullimit të këtij qyteti, rezultojnë të pa pastruara për një periudhë kohore të gjatë. Ky rezultat jetë një nga shkaqet kryesore të vërshimit të ujrave të shiut, jashtë shtratit të kanaleve dhe në mënyrë të pakontrolluar, kanë vërshyer duke krijuar përmbytje.

6. Vlerësimi i riskut në rastet e sjelljes ekstreme të natyrës, në kuptimin e menaxhimit të qëndrueshëm mjedisor.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk ka plan të hartuar në përputhje me përcaktimet e VKM nr.1015, datë 16.12.2020 “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet” dhe Direktivën e Bashkimit Evropian mbi Përmbytjet (Directive 2007/60/EC), duke përcaktuar objektivat për rajonin duke mbajtur parasysh dokumentet e Vlerësimit Paraprak, hartat e Rrezikut dhe ato të Riskut, karakteristikat hidrologjike, si edhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Ky dokumenti i shërben institucioneve, enteve publike e private për të menaxhuar në mënyrë të harmonizuar rrezikun nga përmbytjet dhe marrjen e masave efektive, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, në zonat respektive.

Përgjegjësia për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane shtrihet në të dyja dimensionet e qeverisjes, asaj qendrore dhe asaj vendore.

Qeverisja qendrore është përgjegjëse për përcaktimin e vizionit strategjik të sektorit dhe hartimin dhe monitorimin e kuadrit rregullator mbi të cilin mbështetet gjithë sektori, ndërsa qeverisja vendore është përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision të saj:

- hartimin, zbatimin dhe ndjekjen e politikave të zhvillimit infrastrukturor;
- drejtimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe vendosjen e standardeve teknike të infrastrukturës;
- monitorimin e realizimit të standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës, si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave për kontrollin e disiplinimin e tyre në aspektin financiar e teknik.

MIE, në bashkëpunim dhe me ministritë e tjera të linjës, ka rolin parësor të kanalizimit të fondeve të donatorëve dhe të buxhetit qendror për investime kapitale, bazuar në vlerësimin e nevojave sipas masterplanit kombëtar dhe nevojave që vijnë nga qeverisja vendore.

Gjithashtu rezulton se SHRUK Vlorë, nuk ka kryer regjistrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të aseteve mbi të cilët është vendosur sistemi kullues, së bashku me strukturat përkatëse. Kërkese kjo e përcaktuar në ligjin nr. 20/20, datë 05.03.2020 dhe ligjin nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”.

Sa më sipër nga SHRUKV SHA nuk janë zbatuar:

- Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, neni 5, 6, 7, 8, 11, 12;
- Ligji nr. 111, datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, 3, 6;
- Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për shoqëritë tregtare”;
- Ligji nr. 8102, datë 03.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar me ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018;
- VKM nr. 177, datë 31.3.2005, “Për normat e shkarkimeve të lejuara të ujit dhe kriteret e tyre të zonimit në mjedisin ujor të pranuar”;
- Vendim nr. 448, datë 26.7.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2023–2030”;
- Pika 2: “Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, digave dhe veprave të mbrojtjes nga përmbytja”; pika 2.3.2.2 “Në kullim dhe mbrojtje nga përmbytja Udhëzim nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”.

4.7 Autoriteti Rrugor Shqiptar

Investimet infrastrukturorë të realizuara në territorin e Bashkisë së Vlorës dhe ndikimi i tyre në situatën e përmbytjeve

1. Projekti “Punime rehabilituese për sistemin e shpërndarjes së ujit në Vlorë, Albania”

Në qytetin e Vlorës po zbatohet projekti “Punime rehabilituese për sistemin e shpërndarjes së ujit në Vlorë, Albania”, datë 14.09.2023, kontratë e lidhur midis operatorit ekonomik (i huaj) “A. G. LLC” dhe Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Vlorë me vlerë 16,794,130.30 Euro pa TVSH.

Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga OE “S. E.”, sipas kontratës të lidhur me Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve (AKUM) nr. 1164 prot; datë 15.04.2019. Projekti realizohet në kuadër të Bashkëpunimit Financiar Gjerman me Shqipërinë nëpërmjet KfË, si pjesë e Programit të Performancës dhe Investimeve në Sektorin e Ujit (WPIP) Programi V për Infrastrukturën Bashkiake (MIP V).

Për zbatimin e projektit Bashkia Vlorë ka miratuar leje infrastrukture nr.157 datë 23.11.2023, ku në të përcaktohet se afati i fillimit të punimeve është 1 vit nga data e lëshimit të kësaj leje dhe vlefshmëria e saj sipas grafikut të punimeve.

Nga vizita në terren konstatohet se në akset ku janë kryer punimet për shtrimin e tubave nuk është realizuar kthimi i tyre në gjendjen fillestare, por janë të mbushura me çakëll dhe në shumë vende ka një disnivel të theksuar midis kanalit dhe asfaltit ekzistues të cilat krijojnë vështirësi

në qarkullimin e mjeteve. Në të gjitha rrugë e hapura gjatë përmbytjes disniveleli i kanaleve ka shërbyer si depozita uji dhe nuk e ka lejuar atë të largohet në rrjedhje normale. Gjithashtu rrjedha mund të ketë marrë me vete edhe sasi çakulli, duke kaluar në sistemin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të ndotura e kështu duke krijuar probleme në funksionimin e tyre. Grafiku dhe preventivi i punimeve janë ndarë me zona dhe jo me linja të përcaktuara, ku ky grafik është ndryshuar pesë herë dhe sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion përkatësisht:

- Grafiku i punimeve nr. 1, datë 18.01.2024
- Grafiku i punimeve nr. 2, Shkurt 2024
- Grafiku i punimeve nr. 3, Prill 2024
- Grafiku i punimeve nr. 4, Qershor 2024
- Grafiku i punimeve nr. 5, 19.07.2024

Referuar planvendosjes së tubave që do të realizohen në këtë projekt, zonat e prekura më së shumti nga përmbytja janë; DMA 01, DMA 02, DMA 03 dhe DMA 04.

Për zonat DMA 02 dhe DMA 04 u analizua grafiku i punimeve.



Në grafikun e punimeve fillestar, datë 18.01.2024, konstatohet se zonat DMA 02 dhe DMA 04 janë zonat ku kthimi i rrugëve në gjendjen fillestare duhet të kryhej para përmbytjes. Në zonën DMA 02 punimet fillojnë më datë 15.01.2024 dhe do të përfundojnë më datën 27.05.2024, rehabilitimi i rrugëve (road reinstatement) do të zgjatë 70 ditë duke filluar nga data 19.03.2024 – 27.05.2024. Në zonën DMA 04 punimet fillojnë me datë 22.01.2024 dhe do të përfundojnë më datë 15.06.2024, rehabilitimi i rrugëve do të zgjatë 84 ditë duke filluar nga data 24.03.2024 – 15.06.2024.

44	DMA 02	134 days	Mon 1/15/24	Mon 5/27/24	
45	Setting out of the pipeline axis	7 days	Mon 1/15/24	Sun 1/21/24	7
46	Preparation of Workshop Drawings	7 days	Mon 1/22/24	Sun 1/28/24	45
55	Backfill of the trench	55 days	Wed 2/28/24	Mon 4/22/24	54SS
56	Testing Works	65 days	Mon 3/4/24	Tue 5/7/24	55SS+5 days
57	Road reinstatement	70 days	Tue 3/19/24	Mon 5/27/24	55SS+20 days
58	Installation of House Connections	75 days	Mon 3/4/24	Fri 5/17/24	
86	DMA 04	146 days	Mon 1/22/24	Sat 6/15/24	
87	Setting out of the pipeline axis	7 days	Mon 1/22/24	Sun 1/28/24	45
88	Preparation of Workshop Drawings	10 days	Mon 1/29/24	Wed 2/7/24	87

97		Backfill of the trench	60 days	Mon 3/4/24	Thu 5/2/24
98		Testing Works	88 days	Sat 3/9/24	Tue 6/4/24
99		Road reinstatement	84 days	Sun 3/24/24	Sat 6/15/24
100		Installation of House Connections	88 days	Thu 3/14/24	Sun 6/9/24

Në zonat DMA 02 dhe DMA 04 sipas grafikut të punimeve të fillim vitit 2024 janë parashikuar që kthimi i rrugëve në gjendjen fillestare të ishte kryer para ndodhjes së përmbytjes.

Në grafikun e punimeve datë 19.07.2024 (ndryshimi i fundit) konstatohet se kemi një ndryshim në kthimin e rrugëve në gjendjen fillestare, duke kryer mbushjen e kanaleve dhe rregullimi i rrugëve provizorisht dhe më pas ai përfundimtar, informacion më i detajuar paraqitet në Aneksin nr. 5 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- Në zonën DMA 01 në grafikun fillestar të punimeve mbushja e kanaleve (mbulimi i tubave) si dhe rikthimi në gjendjen fillestare janë parashikuar të kryhen për 390 ditë, kurse në grafikun e rishikuar për 512 ditë.

- Në zonën DMA 02, në grafikun fillestar të punimeve, mbushja e kanaleve (mbulimi i tubave), si dhe rikthimi në gjendjen fillestare, janë parashikuar të kryhen për 125 ditë, kurse në grafikun e rishikuar për 185 ditë.

- Në zonën DMA 03, në grafikun fillestar të punimeve, mbushja e kanaleve (mbulimi i tubave), si dhe rikthimi në gjendjen fillestare, janë parashikuar të kryhen për 180 ditë, kurse në grafikun e rishikuar për 120 ditë.

- Në zonën DMA 04, në grafikun fillestar të punimeve, mbushja e kanaleve (mbulimi i tubave), si dhe rikthimi në gjendjen fillestare, janë parashikuar të kryhen për 144 ditë, kurse në grafikun e rishikuar për 355 ditë.

- Në zonën DMA 05, në grafikun fillestar të punimeve, mbushja e kanaleve (mbulimi i tubave), si dhe rikthimi në gjendjen fillestare, janë parashikuar të kryhen për 132 ditë, kurse në grafikun e rishikuar për 270 ditë.

- Në zonën DMA 06, në grafikun fillestar të punimeve, mbushja e kanaleve (mbulimi i tubave), si dhe rikthimi në gjendjen fillestare, janë parashikuar të kryhen për 315 ditë, kurse në grafikun e rishikuar për 387 ditë.

Në takim mujor të mbajtur më 12.09.2024 konstatohet se në zonat DMA 02 dhe DMA 03 nuk janë kryer punime për shtrimin e tubave. Në progresin e minutave të takimit paraqitet volum punimesh deri në mbushjen e kanalit, por jo kthimin e rrugëve në gjendjen fillestare provizorisht ose përfundimtare. Gjithashtu kjo konfirmohet edhe nga korrespondenca e bashkisë me aktorët përkatës, të përfshirë në projekt, për rregullimin e rrugëve.

Work Progress:

- Installing of main distribution pipelines (Trench excavation, filling with sand, pipe installation and backfilling of trench): $L = 32,850.4$ m (35.6 %).

➤ DMA 1 – $9,013.8 + 565 = 9,578.8$ m pipelines. (35.99 % done).

➤ DMA 3 – $132 + 0$ m pipelines. (0.9 % done).

➤ DMA 4 – $5,285 + 0 = 5,285$ m pipelines. (57.10 % done).

➤ DMA 5 – $5,833.6 + 955.5 = 6,789.1$ m pipelines. (80.64 % done).

➤ DMA 6 – $9,667 + 1,398.5 = 11,065.5$ m pipelines. (47.32 % done).

- Me Bashkinë nuk ka një plan veprimi dhe grafik se si do te operohet për realizimin e punimeve, cilat rrugë do të hapen si do të menaxhohet trafiku, kjo e detajuar mujore, për realizimin e punimeve sipas kushteve të kontratës. Gjithashtu konstatohet se nga ana e Bashkisë Vlorë nuk është ngritur një grup pune për monitorimin e projektit;

- Për ndjekjen e zbatimit të punimeve të projektit nga ana e SHRUK Vlorë, personi përgjegjës është Drejtori Teknik i shoqërisë, ing. K.M, kjo e konfirmuar edhe në minutat e takimeve mujore midis palëve.

Referuar Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) të marrë nga sistemi e-leje gjatë realizimit të punimeve duhet të kihet parasysh:

Masat mbrojtëse dhe parandaluese që rekomandohen gjatë fazës së ndërtimit.

- Të bëhet rrethimi i zonës së ndërtimit në të gjithë perimetrin e saj për të shmangur daljen e gjithfarë mbeturinash inerte, për të bërë një plan organizimi sa me të mirë të objektit dhe për të shmangur gjithashtu impaktin negativ që krijojnë punimet.
- Largimi i dherave që do të dalin gjatë hapjes së themeleve, do të kryhet brenda një kohe shumë të shkurtër nga krijimi i tyre duke mos krijuar ndotje në ambientin përreth. Largimi i tyre të bëhet natën duke marrë masa për të mos ndotur rrugët. Kjo realizohet duke mbuluar me mushama mbeturinat që transportohen dhe duke i larë gomat e makinave para se të dalin nga sheshi i ndërtimit. Mbetjet urbane do të grumbullohen në përfundim të objektit në vende të caktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore.
- Vendosija e rjetave mbrojtëse për minimizimin e pluhurave dhe mbrojtjen e kalimtareve.
- Realizimi i infrastrukturës së brendshme rrugore do të realizohet në përputhje me studimin urbanistik të zonës përkatëse duke i lenë vend edhe sipërfaqes së gjelbërt sipas projektit.
- Mbeturinat në përfundim të ndërtimit do të grumbullohen, transportohen dhe depozitohen në oraret e caktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore.
- Ndërhyrjet në rretin e infrastrukturës do të kryhen me lejet e institucioneve përkatëse sipas ligjeve në fuqi.
- Ndërtimi do të kryhet nën kontrollin e inspektoreve të mjedisit, për të matur ndotjet në mjedis të cilat nuk do ti kalojnë parametrat e lejuar.

Masat kryesore për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

Me qëllim që shkarkimet në ajër që emeton veprimtaria ndërtuese të jenë vazhdimisht brenda normave të lejuara, subjektet ndërtuese marrin këto masa:

- Të përdoren mbulesa të përkohshme dhe të lagen sipas nevojës, një deri në dy herë në ditë për të reduktuar çlirimet e pluhurave;
- Për lëvizjen e materialeve të përdoren konvejerë të mbyllur;
- Të bëhet mirëmbajtja e sheshit gjatë kryerjes së aktivitetit;
- Të gjitha materialet e transportuara jashtë sheshit të ndërtimit të jenë të lagura në mënyrë të mjaftueshme ose të mbuluara mirë;
- Të gjitha aktivitetet e pastrimit, nivelimit, hapjes së kanalit, ndërtimit dhe transportit të ndërpriten gjatë periudhave me erë të fortë;
- Të kufizohet shpejtësia e lëvizjes së automjeteve deri në 30 km/orë;
- Të ndalohet përgatitja dhe përpunimi i bitumeve në temperatura të larta në vendin ku do të ushtrohet aktiviteti, dhe të përdoren bitume që kanë shkallë të vogël çlirimesh të ndotësve në ajër.

Moskthimi i rrugëve në gjendje fillestare sipas programit të parashikuar ka ndikuar në mjedis dhe nuk janë plotësuar kërkesat sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar kthimit të rrugëve në gjendjen fillestare pas përfundimit të punimeve Bashkia Vlorë e ka adresuar me shkresat përkatëse si më poshtë:

- Bashkia Vlorë, me shkresën nr. 4520 prot; datë 26.03.2024, i është drejtuar UK Vlorë dhe mbikëqyrësit të punimeve “S.E & AP”, ku referuar lejes infrastrukurore nr. 157, datë 23.11.2023, për objektin “Programi i infrastrukturës bashkiake V (MIP V)”, në cilësinë e zhvilluesit dhe mbikëqyrësit të punimeve të merren masa në rrugën Transballkanike dhe çdo rrugë e përfshirë në projekt ku janë kryer punimet të kthehen në gjendjen fillestare;

- Me shkresën nr. 6720 prot; datë 03.05.2024 Bashkia Vlorë i është drejtuar UK Vlorë në cilësinë e zhvilluesit, të marrin masa që për çdo rrugë e cila është e përfshirë në projekt dhe punimet kanë mbaruar, kthimi në gjendjen fillestare të realizohet brenda datë 25.05.2024;

- Me shkresën nr. 6721 prot; datë 03.05.2024 Bashkia Vlorë i është drejtuar UK Vlorë, referuar projektit “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash, dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër Vlorë” pas

ankesave të qytetarëve për moskthimin në gjendjen fillestare të rrugëve dhe verifikimit të tyre, në cilësinë e zhvilluesit të marri masa të menjëhershme që për çdo rrugë e cila është e përfshirë në projekt dhe punimet kanë mbaruar, kthimi në gjendjen fillestare të realizohet brenda datës 25.05.2024. Zbatimi i punimeve për objektin e mësipërm është realizuar sipas kontratës nr. 812 prot; datë 29.03.2021, e lidhur midis UK SHA Vlorë dhe BOE “A.C” SHPK dhe “L” ShPK, me afat të përfundimit të punimeve 12 muaj nga data e fillimit të tyre. Mbikëqyrja e punimeve është realizuar nga OE “C.G” ShPK, sipas kontratës nr. 861 prot; datë 01.04.2021, me objekt: *“Mbikëqyrje punimesh për objektin: “Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash, dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër Vlorë”*.

- Referuar shkresës së mësipërme, me shkresën nr. 6721/1 prot; datë 20.06.2024, Bashkia Vlorë ka ri-kërkuar edhe një herë kthimin e rrugëve të dëmtuara në gjendjen e mëparshme. Gjithashtu me shkresën nr. 10924/1 prot; datë 22.07.2024, Bashkia Vlorë ka vendosur në dijeni edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve, Policinë Bashkiake, Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Vlorë dhe mbikëqyrësin e punimeve OE “C.G.” ShPK për kthimin e rrugëve në gjendjen fillestare për projektin *“Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash, dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të vogël, njësia administrative Qendër Vlorë”*.

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë i është drejtuar SHRUK Vlorë me shkresën nr. 421 prot; datë 03.05.2024, për marrje marrjen e masave, për riparimin e rrugëve të dëmtuara gjatë rregullimit të avarive në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Referuar shkresës dëmtimi nga riparimet ka ndodhur në 28 rrugë ku kërkohet ndërhyrje emergjente për riparimin e tyre;

- Me shkresën nr. 6837/1 prot; datë 15.05.2024, Bashkia Vlorë, drejtuar SHRUK Vlorë dhe OSHEE Vlorë, ju kërkon riparimin e rrugëve të dëmtuara nga ana e tyre duke vendosur dhe një afat 5 ditor nga përfundimi i ndërhyrjes;

- Referuar shkresave të mësipërme nga bashkia për kthimin e rrugëve në gjendjen fillestare pas kryerjes së punimeve, SHRUK Vlorë me shkresën nr. 2034/1 prot; datë 08.07.2024, ka kthyer përgjigje duke informuar se do të merren masa për kthimin e rrugëve në gjendjen fillestare, por pa vendosur afate të përcaktuara. Pavarësisht afateve të përcaktuara nga bashkia për riparimin e rrugëve të dëmtuara nga projekt e zhvilluara, deri në këtë fazë të auditimit nuk është marrë asnjë masa për kthimin e tyre në gjendjen fillestare.

Pas përmbytjeve, Bashkia Vlorë me shkresën nr. 17436 prot; datë 31.10.2024, i ka kërkuar UK Vlorë për zbatimin e standardeve teknike për KUZ e KUB dhe pastrimin e kunetave, mbulimin e pusëve aty ku mungojnë, si dhe kthimin e rrugëve në gjendjen fillestare, duke shmangur kështu incidentet që mund të ndodhin për përdoruesit e rrugës.

Pavarësisht kërkesave të Bashkisë Vlorë nga ana e SHRUK Vlorë nuk dokumentohet që të jenë marrë masa për kthimin e rrugëve, ku janë kryer punime, në gjendjen fillestare.

Konkluzion.

- Në asnjë dokument shkresor dhe në procesverbalet e takimeve mujore (minutat e takimit) nuk dokumentohet arsyeja e vonesave në kthimin e rrugëve në gjendjen e mëparshme si dhe ndryshimet e grafikut të punimeve. Ky ndryshim grafiku i punimeve nuk është konsultuar dhe miratuar nga Bashkia Vlorë si enti pronar i rrugëve.

- Bashkia Vlorë nuk ka ngritur një grup pune për monitorimin e punimeve të projektit dhe nuk ka një plan veprimi dhe grafik se si do të operohet për realizimin e punimeve, cilat rrugë do të hapen si do të menaxhohet trafiku, kjo e detajuar mujore, për realizimin e punimeve sipas kushteve të kontratës. Pra, bashkia Vlorë nuk ka ushtruar kontrollin e duhur mbi territorin që administron në bazë të ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 *“Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”*, i ndryshuar; si dhe VKM nr. 894, datë 04.11.2015 *“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”*.

- SHRUK Vlorë në bashkëpunim me Bashkinë , kontraktorin dhe mbikëqyrësin nuk ka marrë masa për kthimin e rrugëve në gjendjen fillestare pas përfundimit punimeve në një kohë sa më optimale për shmangien e problematikave në qarkullim dhe mjedis.
- Moskthimi i rrugëve në gjendjen fillestare, gjatë përmbytjes disnivele të kanaleve ka shërbyer si depozita uji dhe nuk e ka lejuar atë të largohet në rrjedhje normale. Gjithashtu rrjedha mund të ketë marrë me vete edhe sasi çakulli duke kaluar në sistemin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të ndotura e kështu duke krijuar probleme në funksionimin e tyre.
- Vonesat në kthimin e rrugëve në gjendjen fillestare kanë sjell ndikim në mjedis duke mos plotësuar kërkesat e parashikuara në VNM të cilat janë në kundërshtim me ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 ‘Për mbrojtjen e mjedisit’, te ndryshuar; kreu III “Mbrojtja e përbërësve të mjedisit”.

Për sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet e tyre mbajnë përgjegjësi: Bashkia Vlorë; Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë dhe Mbikëqyrësi i punimeve “S.E.”.

2. Projekti “By-Pass i Vlorës”

Në qytetin e Vlorës po zbatohet projekti Bypass-i i Vlorës. Për zbatimin e punimeve është lidhur si fillim kontrata me kompaninë “S.C.” S.P.A, e cila ka falimentuar dhe autoriteti kontraktor ka ndërprerë kontratën më 15.05.2017. Për përfundimin e këtij projekti, zbatimin e punimeve, ARRSH ka lidhur kontratën nr. 9946 datë 08.11.2018 me J.V. “G. 2” ShPK & “I. di C. E. M” me afat përfundimtar të punimeve 823 ditë (22 Shkurt 2021 dhe afat të shtyrë deri më 30 Qershor 2022). Afati i përfundimit të punimeve është ndryshuar dhe afati i fundit i miratuar është Dhjetor 2024.

Supervizionimi dhe konsulenca e këtij projekti kryhet nga kompania BOE “E. OD S.A & P. S.A”, sipas kontratës fillestare të lidhur më 22.11.2013. Pas pezullimit të punimeve me arsyen e ndërprerjes së kontratës me kontraktorin “S. C.” S.P.A për shkak falimentimi, kësaj kontrate supervizionimi i janë bërë ndryshime duke zgjatur afatin e saj.

Gjatë reshjeve të dendura, të cilat krijuan probleme dhe përmbytje në zonën e Vlorës më datë 04.10.2024, u krijuan një rrëshqitje skarpate në km 15+000 në rrugën kryesore të Bypass-it të Vlorës duke shkaktuar një bllokim të përkohshëm të qarkullimit të mjeteve. Punimet në këtë segment të Bypass-it nuk kanë përfunduar ende dhe janë në proces.



Gjatë punimeve të gërmimit për stabilizimin e rrëshqitjes në fillim të muajit Majit 2022, janë vërejtur çarje për të cilat kontraktori ka informuar supervizionin me e-mailin e datës 03.06.2022, duke kërkuar një inspektim të përbashkët. Një inspektim i përbashkët u zhvillua në datë 07.06.2022, me përfaqësues të kontraktorit duke përfshirë projektuesin e tij gjeoteknik dhe supervizionin, me qëllim vëzhgimin e kushteve të raportuara.

Për shkak të kushteve të veçanta të vëzhguara në kantier, supervizori kërkoi një propozim shtesë për t'u paraqitur nga kontraktori, duke përfshirë një raport të ri gjeoteknik, me volumet e punimeve dhe vlerësimin e kostos, në mënyrë që të sigurohen masa të përshtatshme për stabilizimin e skarpatave në zonën km 14+945 – km 15+072.

Kontraktori me anë të letrës nr. 353, datë 08.08.2022 dorëzoi projekt-propozimin e rishikuar për mbrojtjen e skarpatave në progresivin km 14+945 në 15+072.

Referuar propozimit përfundimtar të kontraktorit, zona për zbatimin e masave për mbrojtjen e skarpateve / punimeve stabilizuese parashikohet të shtrihet në një gjatësi prej 117 m, pra nga km 14+955 në km 15+072, konsulenti/mbikëqyrësi vlerësoi tërësisht projekt propozimin e kontraktorit (përfshirë rishikimet), duke arritur në përfundimet e mëposhtme:

- Supervizori është dakort në parim vetëm për sa i përket masave të propozuara që kanë të bëjnë me pjerrësitë e gjurmimeve, si dhe me gjurmimet shtesë në pjesën e sipërme të skarpateve me pjerrësi edhe më të buta pas rrëshqitjeve të fundit.

- Supervizori konsideron se, sipas rezultateve të materialit të shpimeve gjeologjike të paraqitura në raportin gjeoteknik bashkëngjitur dhe karakteristikave gjeoteknike të formacioneve shkëmbore, ankerat nuk ofrojnë asnjë funksion. Theksohet se edhe gjatë punimeve të gjurmimit kjo situatë nuk ka ndryshuar.

- Duke qenë se disa gjurmime nuk kanë përfunduar ende, nëse gjatë kohës së përfundimit të tyre të dhënat ekzistuese mund të ndryshojnë, atëherë sasia e saktë e ankerave duhet të rishikohet, megjithatë një sasi indicative ankerash është përfshirë në preventiv (BoQ) e supervizorit dhe në vlerësimin e kostos në këtë rekomandim.

- Mbrojtja me rrjetë teli e skarpatave duhet të përjashtohet pasi nuk konsiderohet e nevojshme.



- Gjithashtu mund të aplikohen edhe masa që përfshijnë përdorimin e sistemit TRM gjeokompozit dhe hidrombjellje, pasi këto lloj punimesh ofrojnë mbrojtje kundër erozionit. Sasitë relative të këtij procesi janë përfshirë në preventiv (BoQ) dhe kontraktori është udhëzuar t'i zbatojë ato në mënyrë të duhur (shih komentet më poshtë).


- Në lidhje me ndërtimin e një muri me gabiona 6 m të lartë të propozuar në fund të skarpatës, supervizori përsërit opinionin e tij dhe udhëzon uljen e lartësisë së murit nga 6 m në 3 m.

- Paraqitja e sistemit të drenazhimit të zonës sipas të dhënave të përfshira në propozimin e kontraktorit, për mendimin e supervizorit është e panevojshme, për këtë arsye duhet të reduktohet. Për këtë qëllim kontraktori udhëzohet të përshtasë shtrirjen e tubave të drenazhit të parashikuara në propozim nga çdo 3 m në çdo 6 metra dhe nga 40 m në 25 m gjatësi. Supervizori gjithashtu është dakort me masat për drenazhim shtesë në krye të skarpatës, megjithatë të bëhet në mënyrë të kufizuar.

Propozim është miratuar në Urdhër Ndryshimin nr. 30 “*Propozim për mbrojtjen e skarpatave nga km 10+400 deri në km 11+900 dhe nga km 11+280-11+900*”; – “*Propozim për Mbrojtjen e skarpatave nga km 11+175 deri në km 11+180*”; “**Mbrojtja e skarpatës në km 14+945 deri në km 15+062**”; “*Saktësime volumesh për shkak të përgatitjes së vizatimeve përfundimtare të punimeve të përfunduara*”, me Vendimin e Këshillit Teknik të ARRSH nr. 41, datë 19.12.2022.

Në km 0+000 është realizuar rreth-rrotullim që lidh aksin Fier - Vlorë me Bypass-in e Vlorës, rrugët hyrëse të qytetit (hyrja e vjetër dhe zgjatimi i rrugës Transballkanike) dhe rruga e Nartës. Në këtë rreth - rrotullim në projektin fillestar ishte parashikuar të ndërtohej një nënkalim me gjatësi 100 ml për shkarkimin e reshjeve me tre tombino me diametër 1000 mm, me hapësirë drite 2,355 m². Faktikisht, në terren nga kompani “S.C” S.P.A ka ndërtuar një tombino box me përmasa 2.5 * 1 m me hapësirë drite 2.5 m². Ky ndryshim është kryer si rezultat i kërkesës së Bashkisë Vlorë për të mundësuar pastrimin dhe duke krijuar akses me puseta gjatë gjithë gjatësisë së saj. Dalja e kësaj tombino box është në kanalën e kullimit të ujërave të larta që kalon paralel me aksin e autostradës Vlorë – Fier, në anën perëndimore të saj, i cili është i pa pastruar dhe krijon vështirësi në shkarkimi e tij.





Konkluzion.

- Zbatimi i projektit për ndërtimin e “Bypass-it të Vlorës” nuk ka ndikuar në situatën e përmytjeve në rrugët e brendshme të qytetit, pasi ato realizohen në një distancë të konsiderueshme. Rrëshqitja e skarpitit të rrugës e ndodhur në progresivin km 14+945-15+062, në të cilin po kryheshin punimet për stabilizimin e tij, aksi rrugor është bllokuar provizorisht dhe nga ana e kontraktorit janë marrë masa për pastrimin e bërjen e tij të hapur për qarkullim.
- Nënkalimi për ujërat e reshjeve i ndërtuar në progresivin km 0+000 në rreth - rrotullim, i parashikuar në projektin fillestar me tre tombino rrethore me diametër 1000 mm dhe e realizuar me tombino box 2.5 * 1 m ka ruajtur një hapësirë drite më të madhe në funksionimin e saj. Mospastrimi i kanalit kryesor të kullimit në dalje të tombinos e bën këtë tombino jo funksionale në rast të reshjeve të dendura.

4.8 Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Masat e marra dhe administrimi i situatës gjatë dhe pas përmytjeve. Bashkëpunimi ndërinstitucional për përballimin e kësaj situatë, në funksion të ndihmës së dhënë për qytetarët e dëmtuar nga përmytjet. (AKMC)

Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile (AKMC), është krijuar dhe funksionon në bazë të ligji nr. 45, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM-së nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, si strukturë përgjegjëse për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në nenin 3, pikat 24, 25, 26 përcakton respektivisht që:

24. “Menaxhimi i fatkeqësive” është organizimi, planifikimi dhe zbatimi i masave të përgatitjes, përgjigjes ndaj fatkeqësive dhe të rimëkëmbjes prej tyre.
25. “Menaxhimi i emergjencave” është organizimi dhe menaxhimi i burimeve dhe përgjegjësive për trajtimin e të gjitha aspekteve të emergjencave, në veçanti të gatishmërisë, të përgjigjes dhe të hapave fillestarë të rimëkëmbjes.

26. *“Menaxhim i riskut nga fatkeqësitë” është zbatimi i politikave dhe i strategjive për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, për të parandaluar riskun e ri nga fatkeqësitë, për të zvogëluar riskun ekzistues të fatkeqësive dhe për të menaxhuar riskun e mbetur, duke kontribuar në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe zvogëlimin e humbjeve të fatkeqësive.»*

Ndërsa në pikat 46, 47, 48 përcaktohet respektivisht që:

46. *“Vlerësim i riskut” është një qasje cilësore ose sasiore për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e riskut nëpërmjet analizës së rreziqeve të mundshme dhe vlerësimit të kushteve ekzistuese të ekspozimit dhe cenueshmërisë, që së bashku do të mund të dëmtonin njerëzit, pronën, shërbimet, jetesën dhe mjedisin e ekspozuar nga i cili ato varen.*

47. *“Vërtetimi mbi riskun” është dokumenti që lëshohet nga autoriteti përkatës, sipas nenit 13, të këtij ligji, i cili certifikon mundësinë reale të realizimit të ndërtimit, bazuar mbi analizën e rrezikut, cenueshmërinë dhe ekspozimin e tij.*

48. *“Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë” ka për qëllim parandalimin e risqeve të reja të fatkeqësive, zvogëlimin e atyre ekzistuese dhe menaxhimin e riskut të mbetur, që të gjitha së bashku ndihmojnë në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe si rezultat në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.*

Në kreun II *“Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë”*, nenet 8 – 14 trajtojnë temat e zvogëlimit të riskut, vlerësimit të riskut, Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, harmonizimit të planeve të zhvillimit urban me strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, vërtetimit të riskut dhe planeve për emergjencat civile. Në nenin 8 dhe 9 përcaktohet se:

Neni 8: *Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë përfshin tërësinë e masave të përcaktuara nga ky ligj, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, planet, programet e dokumentet e tjera që kanë për qëllim: Në pikat a), b),e) , janë të përcaktuara qartë që duhen të merren që nga identifikimi, vlerësimi, ulja e efekteve, zbutja e pasojave, investimi në parandalim deri tek kultura e sigurisë dhe bashkëpunimi institucional dhe komunitare.*

Neni 9: *Vlerësimi i riskut identifikon llojin, karakteristikën dhe prejardhjen e risqeve nga fatkeqësitë, nivelin e ekspozimit dhe të cenueshme risë, faktorët që e shkaktojnë apo që e rrisin nivelin e mundësisë së rrezikut, si dhe pasojat e mundshme për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin.*

Në pikat 2, 3, 4, 5 të këtij neni përcaktohen qartë afatet kohore dhe rëndësia e vlerësimit të riskut në të gjitha nivelet, në nivel qendror miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit, (Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë rishikohet, jo më pak se një herë në çdo pesë vjet, nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit); në nivel qarku dhe në nivel vendor, jo më pak se një herë në çdo tre vjet. Vlerësimi i riskut në nivel qarku miratohet me urdhër të prefektit, në nivel vendor miratohet me vendim të këshillit bashkiak.

Në nenin 10 *“Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë”*, dhe në nenin 11 *“Strategjia vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë”*, përcaktohet qartë detyrimi që kanë institucionet qendrore dhe vendore për miratimin në kohë dhe brenda afateve të strategjive respektive.

Konkluzion.

- AKMC ka miratuar Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Vlerësimi i riskut kryhet në nivel qarku dhe atë vendor, konkretisht për Qarkun dhe Bashkinë Vlorë nuk gjenden gjurmë të jenë përgatitur dhe miratuar.
- Referuar të dhënave nga AKMC, për transfertat e kushtëzuara për periudhën 2022, 2023 dhe 8-mujori 2024, me kod 91707AG *“Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve”*, dhe 91707AB *“Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”*, konstatohet se fondi i përdorur në vitet e fundit nuk e kalon masën 25% në nivel qarku dhe Bashkia Vlorë në masën 70%. Ky fakt tregon se nga ana Bashkisë Vlorë

nuk janë marrë masat e duhur parandaluese, ku investimet kanë rol kyç në parandalimin përmbytjeve.

Gjatë viti 2024, AKMC ka kryer programe trajnimi me fokus stafin profesional. Programet në vazhdim duhet të jenë të integruara për ngritjen e kapaciteteve dhe informim e hershëm të popullatës në rastet e përmbytjes, si dhe aftësimin e tyre për të vepruar në kohë, gjë e cila është jetike për shmangien e pasojave, apo minimizimin e tyre.

Planet për emergjencat civile

Planet për emergjencat civile, të cilat janë detyrim ligjor dhe akteve nënligjore parashikuar nga neni 14 i nignit nr. 45, datë 18.7.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ku përcaktohet se:

- 1. Planet për emergjencat civile përcaktojnë masat e aktivitetet për parandalimin dhe përballimin e fatkeqësive, sikurse kapacitetet, angazhimin dhe veprimin e organizuar në emergjenca për mbrojtjen e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.*
- 2. Planet për emergjencat civile miratohen në nivel qendror, në nivel qarku dhe në nivel vendor dhe rishikohen jo më pak se një herë në çdo tre vjet.*
- 3. Planet për emergjencat civile marrin në konsideratë trajtimin me prioritet të fëmijëve, të të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuara, të shtresave në nevojë dhe grave.*
- 4. Plani Kombëtar për Emergjencat Civile miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.*
- 5. Plani i qarkut për emergjencat civile miratohet me urdhër të prefektit dhe duhet të jetë i harmonizuar me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile dhe planet për emergjencat civile të qarqeve fqinje.*
- 6. Plani vendor për emergjencat civile miratohet me vendim të këshillit bashkiak dhe duhet të jetë i harmonizuar me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, planin e qarkut për emergjencat civile dhe planet vendore për emergjencat civile të bashkive fqinje.*
- 7. Planet për emergjencat civile hartohen bazuar në strategjitë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, dokumentet e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, kapacitetet e mbrojtjes civile, gjetjet e reja të ekspertëve, si edhe përvojat e fituara në menaxhimin e fatkeqësive.*
- 8. Institucionet shtetërore dhe subjektet private në sektorët e shëndetësisë, të arsimit, mirëqenies sociale, kulturës, mjedisit dhe turizmit miratojnë planin për emergjencat civile. Plani duhet të jetë i harmonizuar me planin vendor për emergjencat civile dhe me dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë të bashkive në territorin e së cilës ndodhen.*

Në ligj janë përcaktuar afatet kohore brenda të cilëve bëhet përditësimi i dokumenteve strategjike që rregullojnë menaxhimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë.

Ngritja kapaciteteve dhe masa parandaluese

Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit (DETTI) në zbatim të Programit të Trajnimit për Mbrojtjen Civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 446, datë 29.03.2023, të Planit të trajnimeve dhe stërvitjeve të mbrojtjes civile për vitin 2024, nr. 26/2 prot; datë 05.01.2024, të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, me nr. 2133/3 prot; datë 10.01.2024, të Programit “Mbi zhvillimin e trajnimit bazë të mbrojtjes civile për strukturat të mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie”, nr. 26/12, datë 18.03.2024, si dhe Urdhrit nr. 26/11, datë 18.3.2024 “Për dërgim me shërbim brenda vendit”, në një periudhë kohore tre mujore, përkatësisht në datat 4 mars deri më 5 qershor 2024, në mjediset e bashkive qendër qarku dhe prefekturave të vendit, u zhvilluan për sesionin e parë, trajnimet bazë të mbrojtjes civile për strukturat të mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie.

Trajnimet u realizuan nga trupa e trajnerëve të AKMC, e cila u miratua me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC, nr. 41, datë 07.02.2024 “Për miratimin e trupës së trajnerëve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për vitin 2024”.

Në rolin e drejtuesve, pjesëmarrësve dhe mbështetësve morrën pjesë: drejtorët e drejtorive në AKMC; personeli i Qendrave Rajonale të Mbrojtjes Civile; përfaqësues të UNDP, përkatësisht Koordinatori Kombëtar i Projektit RESEAL të UNDP dhe konsulenti i këtij programi; Strukturat pjesëmarrëse në trajnim ishin: personeli i sektorit të planifikimit të mbrojtjes civile në prefekturë; personeli i strukturave të emergjencave civile në bashki, përkatësisht nga sektori i planifikimit të mbrojtjes civile në bashki, nga struktura të MZSH-së dhe strukturat përgjegjëse të menaxhimit të pyjeve; personeli nga institucionet, degët rajonale të strukturave qendrore që kryejnë aktivitetin e tyre në nivel vendor, përkatësisht nga drejtoritë vendore të policisë, administrata e zonave të mbrojtura, si dhe personel nga drejtoritë rajonale të operatorit të shërbimit të kujdesit shëndetësor.

Qëllimi kryesor i trajnimit ishte përgatitja dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore të strukturave vendore të mbrojtjes civile me anë të përcjelljes së njohurive, përmirësimit të aftësive dhe rritjes së kompetencave profesionale të tyre për realizimin me efektivitet dhe efikasitet të detyrave dhe marrjes së përgjegjësive të nevojshme për menaxhimin e fatkeqësive dhe situatave të emergjencave civile.

Objektivat e aktivitetit synonin marrjen e njohurive në fushën e mbrojtjes civile, zhvillimin e kompetencave profesionale të personelit të institucioneve dhe forcave operacionale në nivel vendor, për zbatimin e politikave në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel lokal. Aktivitetet trajnuese, mbështetur në Programin e Trajnimit, janë realizuar sipas moduleve të mëposhtme:

1. Organizimi dhe funksionimi i sistemit të mbrojtjes civile;
2. Fatkeqësitë që prekin territorin e Shqipërisë dhe vlerësimi i riskut;
3. Planifikimi i menaxhimit të emergjencave civile;
4. Sistemi i paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit në Republikën e Shqipërisë;
5. Mbrojtja civile në kontekstin rajonal dhe evropian;

Në përmbajtjen e vet, modulet përbëhet nga disa tema që lidhen dhe plotësojnë njëra-tjetrën, duke krijuar në këtë mënyrë një paketë të përmbledhur të njohurive, të cilat ndikojnë në zgjerimin e këtyre njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale të pjesëmarrësve, aq të domosdoshme në procesin e punës së tyre për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile në nivel vendor.

Në qarkun Vlorë, trajnimi u zhvillua në datat 23-24 prill 2024 me pjesëmarrës nga prefektura Vlorë dhe bashkitë Vlorë, Selenicë, Konispol, Delvinë, Finiq, Sarandë, Himarë; Administrata e Zonave të Mbrojtura dhe përfaqësues të UNDP.

Zhvillimi i trajnimeve në qarkun Vlorë është fokusuar te lidhja e punës së pjesëmarrësve me problemet e emergjencave civile; mbi organizimin e sistemit të mbrojtjes civile; eksperiencat personale lidhur me situatat e menaxhimit të emergjencave në ditët e sotme, etj. Rëndësi i është kushtua funksionimit të komisionit të mbrojtjes civile dhe ngritjes së qendrave operacioneve në nivel bashkie dhe prefekturë për përballimin e emergjencave, pasi nëpërmjet këtyre strukturave realizohet edhe menaxhimi sa më eficient i tyre, duke kanalizuar menaxhimin e informacionit të marrë nga forcat operacioneve në terren me strukturat qendrore.

Në trajtimi janë shpjeguar konceptet përkatëse lidhur me fatkeqësitë që prekin territorin e vendit tonë, si dhe metodologjia e vlerësimit të riskut. Lektorët, përfaqësuesit e UNDP dhe pjesëmarrësit, kanë zhvilluar diskutime, ballafaquan dhe u ndanë ide rreth praktikave të mira, lidhur me hartimin e dokumenteve strategjik në nivel prefekturë dhe bashkie.

Pjesëmarrësit, lidhur me çështjet e menaxhimit të ciklit të plotë të emergjencave, shprehën shqetësimin lidhur me fazën e fundit të ciklit të emergjencave, konkretisht atë të kompensimit, pasi nëpërmjet akteve nënligjore në fuqi, ka pengesa në ekzekutimin e dëmshpërblimeve të shkaktuara nga ngjarjet natyrore e për këtë u diskutua dhe nevoja e rishikimit të këtyre akteve. Interes të veçantë pati pjesa e modulit “Sistemi i paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit në Republikën e Shqipërisë” në pjesën e prezantimit për sinjalet dhe roli i tyre në sistemin e lajmërimit të fatkeqësive.

Programet e trajnimit janë realizuar sipas urdhrave dhe planeve, programeve dhe marrëveshjeve të mëposhtme:

1. Urdhri e Ministrit të Mbrojtjes nr. 466, datë 29.03.2023 “Për miratimin e Programit të Trajnimit për Mbrojtjen Civile për strukturat shtetërore, subjektet private dhe vullnetarët”, si dhe Programi i Trajnimit;
2. Plani i trajnimeve dhe stërvitjeve të mbrojtjes civile për vitin 2024, nr. 26/2 prot; datë 05.01.2024;
3. Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Ministrisë së Mbrojtjes, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, me nr. 2133/3 prot; datë 10.01.2024;
4. Program “Mbi zhvillimin e trajnimit bazë të mbrojtjes civile për strukturat të mbrojtjes civile në nivel qarku dhe bashkie”, nr. 26/12, datë 18.03.2024;
5. Urdhri i shërbimit nr. 26/11, datë 18.03.2024 “Për dërgim me shërbim brenda vendit”;
6. Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC, Nr. 41, datë 07.02.2024 “Për miratimin e trupës së trajnerëve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për vitin 2024”;
7. Informacion mbi zhvillimin e trajnimeve në nivel vendor, 2024 nr. 26/22 prot; datë 15.07.2024;
8. Listë prezencë e skanuar e personave pjesëmarrës në trajnimin në Vlorë (1);
9. Listë prezencë e skanuar e personave pjesëmarrës në trajnimin në Vlorë (2).

Një komponent shumë i rëndësishëm në zbatimin e ligjit dhe monitorimin e përmbushjes së standardëve është kryerja e detyrave inspektuese. Në informacionin dhe dokumentet e vendosura në dispozicion të grupit auditues nga Sektori i Monitorimit, konstatohet se:

Në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ligjit nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, si dhe në zbatim programit vjetor të inspektimit 2023, të miratuar, Sektori i Inspektimit zhvilloi në muajin Shkurt 2023, midis institucioneve të tjera, edhe pranë Bashkisë Vlorë, konkretisht në datën 01.02.2023, për inspektimin e planeve të emergjencave të strukturave vendore, sipas nenit 30, pika ç) ligjit 45/2019. Plani u gjet i pa përditësuar. Duke qenë se ky nen nuk ka mase administrative gjobë, u procedua me vendim administrativ “Paralajmërim”. Gjithë praktika e mbajtur gjatë inspektimit që përfshin procesverbalin e inspektimit nr. AKMC-DQ-2023-000001-2, si dhe vendimin përfundimtar të inspektimit me nr. AKMC-DQ-2023-000001-5, të përcjella këto me shkresën nr. 205/2 prot; datë 06.02.2023, si dhe nr. 205/3 prot; datë 23.02.2023.

Investime Infrastrukturore

Për vitin 2022

Referuar nenit 15 të ligjit 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, aneksi 6 “Fondi për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore”, është shpallur njoftimi në faqen zyrtare ëeb të Ministrisë së Mbrojtjes, më 11.04.2022 “Hapja e thirrjeve për aplikim për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, për programin “Fondi për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore”, pas së cilit asnjë aplikim nuk rezultoi të jetë përcjellë nga Bashkia Vlorë, ndërsa referuar bashkive në nivel qarku është përcjellë vetëm projekti i Bashkisë Konispol, i cili është shpallur fitues dhe financuar në 2022.

Për vitin 2023

Bazuar në ligjin 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, nenit 15 të ligjit 84/ 2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, aneksi 6, “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore”, është shpallur njoftimi në faqen zyrtare ëeb të Ministrisë së Mbrojtjes, më 10.01.2023 “Hapja e thirrjeve për aplikim për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, për programin “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore”, njoftimi elektronik më datë 12.01.2023, si dhe shkresore nr. 88/1 prot; datë 13.01.2023, pas së cilit asnjë aplikim nuk rezultoi të jetë përcjellë nga Bashkia Vlorë, ndërsa referuar bashkive në nivel qarku, janë përcjellë projekte nga Bashkia Selenicë, Finiq dhe Konispol, nga të cilët projekti i përcjellë nga

Bashkia Selenicë është shpallur fitues me VKM-në nr. 260, datë 27.04.2023 dhe është financuar për vitin 2023.

Për vitin 2024

Bazuar nenit 15 të ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Aneksin 6 “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore”, është shpallur njoftimi në faqen zyrtare ëeb të Ministrisë së Mbrojtjes, më 29.12.2023 “Hapja e thirrjeve për aplikim për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, për programin “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore”, njoftimi elektronik më datë 12.01.2023, si dhe shkresore nr. 2179/3 prot; datë 29.12.2023, pas së cilit dy projekte rezultojnë të jenë përcjellë nga Bashkia Vlorë, përkatësisht, “Ndërtim i murit mbajtës në lagjen Lirim” me vlerë totale 2,579,740 lekë dhe “Rikonstruktion i kanalit kullues në fshatin Cerkovinë” me vlerë 2,531,816 lekë, të cilat nuk janë shpallur fitues (referuar shpërndarjes së fondit të kushtëzuar dhe ndarjes së tyre mund të finanoheshin sipas fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, kod produktit AG), ndërsa referuar bashkive në nivel qarku, janë përcjellë projekte nga Bashkia Selenicë, Delvinë, Finiq dhe Konispol, nga të cilët projektet e përcjella nga Bashkia Finiq, Konispol, Delvinë dhe Selenicë janë shpallur fitues me VKM-në nr. 307, datë 22.05.2024 dhe janë financuar për vitin 2024.

Gjithashtu, fondet për investimin e digave, bazuar nenit 15 të ligjit 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, Aneksi 7 “Fondi Digat”, është shpallur njoftimi në faqen zyrtare ëeb të Ministrisë së Mbrojtjes, më 26.01.2024 “Hapja e thirrjeve për aplikim për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, për programin “Fondi për Digat”, njoftimi elektronik më datë 29.01.2024, si dhe shkresore nr. 233/1 prot; datë 30.01.2024, pas së cilit asnjë aplikim nuk rezulton të jetë përcjellë nga Bashkia Vlorë, ndërsa referuar bashkive në nivel qarku, janë përcjellë projekte nga Bashkia Finiq dhe Konispol, nga të cilët, projekti i përcjellë nga Bashkia Finiq është financuar me VKM-në nr. 306, datë 22.05.2024 dhe shpallur fitues për vitin 2024.

Fondi i kushtëzuar për Mbrojtjen Civile

Bazuar në ligjin 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, nenit 15 të ligjit 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, nenit 15 të ligjit 84/ 2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, dhe nenit 15 të ligjit 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, është akorduar fondi në zërin shpenzime kapitale në programin, “Emergjencat Civile”, i cili përdoret sipas VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, dhe VKM-së nr. 290, datë 17.05.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr.414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, e ndarë për Bashkinë Vlorë sipas tabelës së mëposhtme.

Fondi për emergjencat civile, i akorduar në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Mbrojtjes, shpërndahet në formën e transfertës së kushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me një formulë, e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive.

Pas përcaktimit të vlerës që i korrespondon çdo bashkie, i jemi drejtuar secilës bashki të na informojë se sipas nevojave të tyre, si duan ta ndajnë këtë vlerë midis dy kodeve të mëposhtme:

- **Kodi i produktit 91707AG** - Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve.
- **Kodi i produktit 91707AB** - Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme.

Referuar bashkive të qarkut Vlorë, në bashkëpunim me Sektorin e Buxhetit dhe Financës, është realizuar shpërndarja dhe realizimi i fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile dhe investimeve infrastrukturore, sipas Aneksit nr. 6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Referuar informacionit dhe të dhënave në Aneksin nr. 6 bashkëlidhur, rezulton se Bashkia Vlorë, ka një performance shumë të dobët në realizimin dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile. Sipas tabelës, fondi i përdorur në vitet fundit nuk e kalon masën 25% në nivel qarku dhe Bashkia Vlorë në masën 70%. Tregon se nga ana Bashkisë Vlorë nuk janë marrë masat e duhur parandaluese, ku investimet kanë rol kyç në parandalimin e përmbytjeve .

Theksojmë se Bashkia Vlorë nuk ka marrë asnjë masë në thithjen e investimeve, edhe pse ka pasur përmbytje në vitet e kaluara. Thithja e investimeve në këtë drejtim është në kufijtë minimal. Kjo tregon mungesë profesionale të stafit të bashkisë për të gjeneruar fonde dhe thithur investime, për rrjedhojë mungesa e investimeve ka ndikuar drejt për drejt në rritjen e pasojave social - ekonomike dhe ekologjike nga përmbytja e fundit.

Hartimi i dokumenteve strategjike në nivel kombëtar

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, hartimi dhe miratimin i 3 (tre) dokumenteve të rëndësishëm në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile është bërë në nivel kombëtar dhe qendror:

- Strategjia Kombëtare e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë;
- Vlerësimi i Riskut në nivel qendror;
- Plani Kombëtar për Emergjencat Civile.

Në rolin e institucionit bashkërendues, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (mbështetur nga donatorë si: UNDP me anë të projektit RESEAL) për hartimin e dokumenteve në nivel kombëtar ka ndjekur koordinimin e zhvillimit të procesit, duke siguruar kontributin dhe pjesëmarrjen e institucioneve të përfshira në nivel qendror: Ministrinë e linjës dhe institucionet e tyre respektive në varësi.

Për përgatitjen e dokumenteve të sipërpërmendur, nga ana e Kryeministrit janë miratuar urdhrat përkatës si më poshtë:

1. Urdhër nr. 57, datë 29.06.2021 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë”;
2. Urdhër nr. 58, datë 29.06.2021 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik të Punës për përgatitjen e projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”;
3. Urdhër nr. 59, datë 29.06.2021 “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës për kryerjen e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror”.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) në rolin e sekretariatit teknik, pas miratimit të këtyre urdhrave ka komunikuar me institucionet dhe strukturat e përcaktuara në urdhrat e Kryeministrit për të siguruar emrat e përfaqësuesve të tyre për në grupet përkatëse ndërinstitucionale të punës, në mënyrë që të fillojë funksionimi i këtyre grupeve.

Gjithashtu në zbatim të rolit të sekretariatit teknik, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, janë përcaktuar punonjësit e AKMC -së që do të jenë pjesë e sekretariateve teknike, sipas grupeve të punës dhe për këtë qëllim ka miratuar urdhrat përkatës:

1. Urdhër nr. 96, datë 08.07.2021 “Për ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për hartimin e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë”;
2. Urdhri nr. 98, datë 08.07.2021 “Për ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Vlerësimin e Riskut nga Fatkeqësitë në nivel Qendror”;
3. Urdhri nr. 97, datë 08.07.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC “Për ngritjen dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik të Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Projektit të Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”.

Sekretariatet teknike të ngritura sipas urdhrave të sipërcituar kane përmbushur detyrat e përcaktuara në urdhrat përkatës duke ndihmuar dhe kontribuar në mbarëvajtjen e procesit të punës së grupeve ndërinstitucionale të punës.

Sensibilizimi, ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut.

Në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, të VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për Funksonimin e Organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional të Institucioneve dhe të Strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile”, si dhe në kuadër të 14 Tetorit, Ditës Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Riskut ndaj Fatkeqësive, në vitin 2022, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në bashkëpunim me UNDP, institucione qendrore dhe me pushtetin vendor kanë zhvilluar aktivitetet sensibilizuese dhe ndërgjegjësuëse në qarqet Fier, Shkodër, Durrës, Korçë, Tiranë, Lezhë e Vlorë.

Tematika e aktiviteteve ka qenë “Rritja e konsiderueshme e aksesit në sistemet e paralajmërimit të hershëm me shumë rreziqe dhe në informacionin dhe vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë për njerëzit deri në vitin 2030”.

Aktivitetet javore ndërgjegjësuëse u zhvilluan në shkollat 9-vjeçare të shtatë qarqeve (Shkodër, Lezhë, Tiranë, Fier, Durrës, Korçë, Vlorë) dhe kishin si qëllim zhvillimin e kulturës së zvogëlimit të rreziqeve të fatkeqësive duke rritur njohuritë mbi funksionimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm në moton: “Paralajmëro, Vepro, Parandallo” për nxënësit e shkollave por edhe komunitetin e gjerë.

Ndër aktivitetet ndërgjegjësuëse një javore që u zhvilluan, veçojmë:

1. Publikimi i videomesazheve të shkurtra në rrjete sociale me tematikë “Paralajmërimi i Hershëm”, nga përfaqësues të lartë të institucioneve përkatësisht, Instituti i Gjeoshkencës, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Prefekti i qarkut Vlorë, Shërbimi zjarrfikës, Bashkia Tiranë.

2. Finalizimi i konkursit të pikturave zhvilluar mes shkollave 9-vjeçare të Qarkut Fier, ku rreth 100 fëmijë nga bashkitë Fier, Patos, Roskovec, Mallakastër, Lushnjë, Divjakë dizajnuan posterin e Ditës Ndërkombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë më temë “Paralajmëro, Vepro, Parandallo”.

3. Zhvillimi i sesioneve informuese në shkollat 9-vjeçare në qytetet si Shkodër, Lezhë, Tiranë, Fier, Durrës, Vlorë dhe Korçë në të cilën u shpërndanë materiale informuese (broshura, fletëpalosje).

Në këtë komponent vërehet se ka një përpjekje në nivel kombëtar dhe rajonale Funksonimin e Organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional të Institucioneve dhe të Strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile duke ndërmarrë aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuëse. Por në nivel lokal mungojnë “Hartimi Planeve Lokale të Veprimt” dhe nuk ka një program të qartë të adresimit drejt grupeve të synuara dhe të ekspozuara ndaj rrezikut të përmbytjeve. Rastet e përmbytjeve të fundit tregojnë, se ka një përfshirje shumë të vogël qytetare, dhe të vullnetarizmit në paralajmërim, ndalim dhe veprim.

Masat e marra dhe administrimi i situatës gjatë dhe pas përmbytjeve.

Nga dokumentacioni vendosur në dispozicion rezulton se AKMC me shkresën nr. 1789/1 prot; datë 03.10.2024, i është drejtuar prefektëve të 12 qarqet, ku u është kërkuar marrja e masave parandaluese dhe përgatitjen për përballimin e emergjencave civile gjatë periudhës së dimrit 2024 - 2025.

Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile, me e-mail datë 03.10.2024, u është drejtuar prefekturave dhe bashkive të vendit duke i informuar për situatën meteorologjike në të gjithë vendin, bashkëlidhur Buletinin mbi Rreziqet Natyrore dhe të dhënat e EGJUM.

Në rajonin e Bashkisë Vlorë u krijua situatë emergjente nga përmbytjet si rezultat i reshjeve e shumta më datë 04.10.2024. Sipas AKMC, njoftimi i tyre është kryer nga strukturat vendore me linje telefonike. AKMC, me marrjen e këtij njoftimi me e-mail, datë 04.10.2024, i ka kërkuar Qendër së Bashkuar Operacionale pranë Forcave të Armatosura mbështetje me 2 moto

varka, 2 ekipe të pajisura me dy 2 motopompa, 8 mjete të kalueshmërisë së lartë dhe 30 forca ushtarake, si dhe duke vendosur në dispozicion nr. e kontaktit të personit përgjegjës për Emergjencat Civile pranë Prefekturës Vlorë. Situata e krijuar nga përmbytja është raportuar në Kryeministri dhe Ministrinë e Mbrojtjes, sipas informacioneve të mëposhtme:

1. Më datë 05.10.2024, me e-mail, është raportuar situata emergjente gjatë 24 orëve në të gjithë vendin. Konkretisht, për Qarkun Vlorë, citohet: *“Rreth orës 16:45, situata brenda qytetit të Vlorës doli jashtë kontrollit, si pasojë e reshjeve të shiut me intensitet shumë të lartë (në 3 orë 180 mm), janë shkaktuar përmbytje në rrugët e qytetit dhe prezencë uji në banesa. Janë evakuuar 33 familje (55 persona), të cilët janë sistemuar në ambientet e konvikteve nga Bashkia Vlorë. Në mbështetje të komunitetit janë dërguar mjetet e pajisjet, si dhe forcat e ushtarake sipas kërkesës së bërë pranë Qendrës së Bashkuar Operacionale. Në segmentin rrugor Oriku – Radhimë, pranë lokal “Ramosaco” është bllokuar rruga për shkak të rrëshqitjes së dherave”.*

2. Më datë 06.10.2024, me e-mail, është raportuar situata emergjente gjatë 24 orëve në të gjithë vendin. Konkretisht, për Qarkun Vlorë, citohet: *“Situata ka shkuar drejt normalizimit, duke mundësuar kalimin normalisht në katër akset rrugore që ishin të pa kalueshme si: Universiteti, Albano e Romina, dyqanet e reja, si dhe Kisha Ortodokse. Hidrovori i qytetit ka punuar me kapacitet të plotë deri në orën 13:15, i cili pësoi defekt në njërin nga katër pompat e tij. Veç kapaciteteve të bashkisë u angazhuan 5 mjete transporti, 3 mjete të kalueshmërisë së lartë, 24 efektivë dhe 2 pompa thithëse nga Forcat e Armatosura”.*

3. Më datë 07.10.2024, me e-mail, është raportuar situata emergjente gjatë 24 orëve për Qarkun Vlorë: *“Ka vijuar puna për eliminimin e pasojave të shkaktuara nga përmbytja e datës 04.10.2024, në qytetin e Vlorës. Situata gjatë ditës ka patur përmirësim duke shkuar drejt normalizimit. Si rezultat i punës së pandërprerë të stacioneve të pompimit, hidrovorit dhe pompave thithëse është larguar totalisht uji duke lehtësuar kalueshmërinë për mjetet dhe këmbësorët në të gjitha rrugët e qytetit. Puna e Forcave Operacionale u përqendrua në pastrimin e akseve rrugore brenda blloqeve të banimit, largimin e ujit nga parkingjet e pallateve, banesave, ambienteve të ndryshme të bizneseve dhe objekteve publike. Në terren u angazhuan 7 autobote me 2 sonda nga Drejtoria e Ujësjellës - Kanalizimeve Vlorë, 31 trupa ushtarake, 8 pompa dhe 8 agregate thithëse nga forcat e armatosura. Në mbështetje të forcave në terren me kërkesën e kryetarit të bashkisë shkuan edhe 2 kamionë vetëshkarkues nga MM. Grupet e punës të ngritura nga Bashkia punuan në terren për identifikimin e dëmeve të shkaktuara ku u evidentuan: 215 banesa dhe 135 biznese, 2 shkolla dhe 1 çerdhe, Muzeu Etnografik dhe Biblioteka e qytetit.*

Nga puna e forcave në terren është arritur të mundësohet kalueshmëria në të gjitha rrugët e qytetit, shkollat dhe çerdhja janë pastruar dhe janë të gatshme për fillim e mësimi. Ka vijuar puna për pastrimin dhe tharjen e garazheve nëpërmjet pompave thithëse. Ditën e sotme situata është e qetë, vazhdon puna nga forcat në terren për normalizimin e gjendjes dhe nga grupet e punës të ngritura për evidentimin e dëmeve të shkaktuara”.

4. Më datë 08.10.2024, me e-mail, është raportuar situata emergjente gjatë 24 orëve për Qarkun Vlorë: *“Nga ana e forcave operacionale është punuar për kthimin e situatës në normalitet. Ka vazhduar gjatë ditës puna për pastrimin e inerteve dhe llumit brenda lagjeve të qytetit. Vazhdon puna për tharjen e garazheve poshtë pallateve. Grupet e vlerësimit kanë dalë në terren dhe po bëjnë vlerësimin e dëmeve në banesa. Janë vlerësuar 167 banesa. Firma që kryen punimet në qytet ka qenë në terren duke punuar për pastrimin e rrugëve. Stacionet e pompimit dhe hidroforët janë në gjendje pune. Janë angazhuar kapacitet e bashkisë dhe të UK Rajoni Jugut si dhe 5 autobote uji dhe 2 sondat që kanë ardhur ndihmë nga AKUK. Ka vazhduar puna për pastrimin e institucioneve që kishin probleme dhe kthimin e tyre në normalitet. Nga BMEC punuan 29 forca operacionale, 1 automjet, 8 agregate si dhe 6 pompa. Krahas tyre vazhduan të punojnë dhe 2 mjete vetëshkarkuese. Reparti ushtarak Poshnjë 2 mjete 8 efektivë dhe 2 pompa. Në territorin e bashkisë Vlorë është punuar gjatë gjithë natës për pastrimin e qytetit dhe garazheve. Edhe sot po vazhdon puna për pastrimin e inerteve dhe llumit brenda lagjeve, tharjen e garazheve poshtë pallateve, pastrimin e rrugëve etj. Nga grupi i vlerësimit në terren*

vazhdon puna për vlerësimin e dëmeve në banesa. Gjatë ditës sotme po vazhdon puna në terren me të njëjtat forca dhe mjete. Në bashkinë Vlorë deri tani janë dërguar 300 pako ushqimore, 900 shishe uji 1.5 litra dhe 200 litra shampo”.

Konkluzion.

- AKMC, me marrjen e njoftimit për situatën e krijuar, ka njoftuar Qendrën e Bashkuar Operacionale pranë Forcave të Armatosura për asistimin me mjete, si dhe ka ndjekur dhe koordinuar situatën në ditët në vazhdim duke raportuar në institucionet përkatëse.

Mbi sa trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nëpërmjet shkresës të ardhura nga ana AKMC, me shkresën nr. 399/2 prot; datë 10.03.2025, (me nr. 1191 prot; datë 10.03.2025 në KLSH) në lidhje me rekomandimin 11.1 auditimin tematik me objekt: “Për verifikimin e shkaqeve, pasojave dhe reagimit të institucioneve, lidhur me situatën e krijuar nga përmbytjet masive në qytetin e Vlorës” nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC, z. H.Ç, ka paraqitur observacionin, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Pasi u njohëm me gjetjen III të trajtuar në Projektraportin e Auditimit dhe Rekomandimin 11.1. Më poshtë gjeni komentet dhe shpjegimet Tona:*

Hartimi i Planit të Menaxhimit nga Përmbytjet nuk bën pjesë në fushën e përgjegjësisë të AKMC-së por në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, me të cilën AKMC ka bashkëpunuar dhe mbështetur teknikisht procesin e hartimit të PMPBU për lumejtë Erzen, Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjosë, në zbatim të VKM nr 168/2023 “Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: AKMC nuk është mbajtëse e hartimit PMPBU, po ajo përfshihet në të gjitha etapat e hartimit, realizmit, miratimit dhe zbatimit të rekomandimeve dhe standarteve që burjojnë prej tijë. (Rekomandimi citon “AKMC në koordinim me institucionet e tjera përgjegjëse”)

Gjatë procesit të zhillimit të auditimit dhe dokumnatave që janë administruar për këtë qëllim, ka rezultuar se nuk ka Vlerësimin e Riskut nga Përmbytjet (VRP), për Qytetin e Vlorës, edhe pse zona ka një shkallë të lartë rrisht. Edhe pse është miratuar Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Vlerësimi i riskut në nivel qarku dhe atë vendor, në rastin e Qarkut dhe Bashkisë Vlorë, nuk janë përgatitur dhe nuk janë miratuar sipas ligjit. Plani vendor për emergjencat civile, i cili miratohet me VKB dhe duhet të jetë i harmonizuar me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, tregon se marrja masave në kuadrin e hartimit politikave dhe planeve në nivel vendor, mungon thuajse plotësisht. Kjo tregon se institucionet në nivel qarku dhe atë vendore nuk kanë përmbushur detyrimet për parandalimin e riskut të përmbytjes, që në vetvete përbën një mungesë standarti dhe përmbushjes të detyrimit ligjor.

Pretendimi i subjektit: “AKMC në zbatim të nenit 23 pika 6/c e ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” kordinon dhe bashkërendon punën për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planit Kombëtar për Emergjencat Civile nivel qendror, specifikisht për rreziqet e përbytyjeve të digave, zjarreve në pyje, tërmete, rrëshqitjet e tokës, aksidentet teknologjike dhe sëmundjet infektive. Këto dokumenta janë miratuar tashme me VKM-të përkatëse dhe metodologjia e hartimit të tyre është përcjellë zyrtarisht me shkresën nr. 810, datë 20.04.2023 “Për njohje dhe zbatim” tek të gjitha NJVV, përfshirë dhe Qarkun/BashkinëVlorë.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Mungesa e strategjive dhe planeve në nivel qarku dhe atë vendore, nxjerr në pah mungesën e koordinimit ndërinstitutional dhe bashkërendimin e veprimeve në këto nivele, gjë e cila ndikon direkt, në parandalimin e rrisht, dhe minimizimin e pasojave. Edhe pse ka mos përmbushje të detyrime ligjore dhe të standarteve

në menaxhimin e riskut në nivel qarku dhe vendore. Gjatë auditimit ka rezultuar se gjatë viteve 2023 - 2024 është zhvilluar vetëm një inspektim.

Nga audtimi ka rezultuar që mungon dokumentacioni dhe ka mangësi teknike ligjore si:

- Mungesa e strategjisë së rrezikut në nivel vendore;
- Mungesa e planeve në nivel qarku dhe vendore;
- Mungesa e “Action plane” , për zona me shkallë të lartë rreziku
- Mangësi të tjera ligjore që kanë të bëjnë me infrastrukturën, mjetet dhe kapacitetet vepruese.

Fakti që për një periudhë dy vjeçare është kryer vetëm një inspektim dhe është marr vetëm një mase, (paralajmërim), tregon nevojën e rritjes së kontrollit dhe inspektimve pasi zona në fjalë (Bashkia Vlorë) është zonë me shkallë të lartë risku.

Pretendimi i subjektit: “Në zbatim të nenit 30, pika (a-c) brenda 2 vitesh nga hyrja në fuqi e Ligjit “Për Mbrojtjen Civile”, bashkitë kanë detyrim të kryejnë Vlerësimin e rrishtit në nivel lokal, të cilin ia dërgojnë Prefektit të Qarkut dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, për qëllime analizimi dhe planifikimi. Përzgjedhja dhe pilotimi i një qarku/bashkie nuk kryhet nga AKMC, por nga analiza e një sërë faktorësh administrativë, financiarë, teknikë dhe operacional, të cilët pas marrjes së miratimit nga Ministeri përgjegjës për Mbrojtjen Civile, AKMC mund të ushtrojë detyrën e mbështetjes të unike. Në këtë referencë është kryer tashmë pilotimii Qarkut Fier, konkretisht Prefektura Fier dhe 6 bashkitë e saj, të cilët kanë hartuar dhe miratuar dokumentat strategjike vendore, që burojnë nga detyrimi ligjor. Këto dokumenta dhe metodologjia përkatëse është përcjellë zyrtarisht për njohje dhe zbatim tek të gjitha NJVV, nëpërmjet një programi pune nr.1605,date12.09.2023"Prezantimii dokumentave strategjike në fushën e mbrojtjes civile në 11 prefektura dhe përgjegjësive përkatëse të qeverisjes lokale", përfshire dhe Qarkun/Bashkinë Vlorë, evidentuar në Raportin përmbledhës nr.1605/1prot; datë18.12.2023.”

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në zbatim të nenit 30, pikat/“a-c” brenda 2 vitesh nga hyrja në fuqi e Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, bashkitë kanë detyrim të kryejnë e vlerësimin e rrishtit në nivel lokal, të cilin e dërgojnë te Prefektit i Qarkut dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Theksojmë që: Ligji nr. 45, datë 18.7.2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, si dhe Urdhri i Kryeministrit nr. 27, datë 3.2.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, si strukturë përgjegjëse për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pavarsisht faktorëve administrativ, financiar, teknik apo operacional, ky detyrim ligjor nuk është përmbushur në kohë, po ka një periudhë afër 4 vjeçare nga hyrja në fuqi e ligjit, që Bashkia Vlorë nuk ka përmbushur kryerjen e vlerësimit të rrishtit në nivel lokal.

Përveç asistencës teknike dhe detyrave të tjera të ngakruara me ligj, AKMC, në zbatim të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, si dhe në zbatim programit vjetore të inspektimit. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, kryen inspektime për plotësimin standarteve në nivel qarku dhe bashkie, dhe vendos masa në rastet e mos plotësimit tyre.

4.9 Të ndryshme

Ankesa

Në lidhje me ankesën e paraqitura në KLSH me nr. 1217 prot; datë 14.10.2024, me objekt “Thirje për ndihmë”, nga znj. A.D administratore e OE “Al” ShPK, pronare e “S.R H”, ku citohet si vijon:

“Në përmbytjen e fundit pranë subjektit tonë na rezulton një kanal që deri dje sillte ujëra e mbetje nga prurjet por jo me sasi sikurse këto vite që u përfundua edhe bypassi i jugut i cili ka krijuar degëzime të reja prurjesh dhe meqenëse kjo situatë na shkaktonte problematika në si biznes njëkohësisht i shkaktonte dëme dhe kaos edhe rrugës bregdetare Vlorë – Orikum, pasi në gjendemi buzë rrugës dhe disponojmë një strukturë hotelerie, me gjëmën e ndodhur mbrëmjen e përmbytjes së madhe të Vlorës na kthehet ky tip kanali në lum e merr përpara ç’ të mundej aq kaotike dhe e rëndë u bë situatë saqë bllokoj rrugën nacionale që përmendëm më sipër e veç tjerash na dëmtoi rrugën nacionale që përmendëm më sipër e veç tjerash na dëmtoi hyrje e çmundi edhe në biznesin tonë, nuk mjaftoi kjo dhe po atë mbrëmje nuk lamë institucion pa lajmëruar e kërkuar ndihmë pas shumë telefonatash që këmbuem ndër to edhe emergjencat civile të cilat më pas dërguan një skrep në orët e vona të natës sa për ti shtyrë sa në një rën anë të rrugës sa në tjetrën , hapën rrugën duke na bllokuar hyrjen për në objekt e duke lënë një kanal të mbushur me mbetje e një hyrje biznesi me gurë e dhera u larguan me fjalën se do të riktheheshin për të punuar të nesërme gjë që nuk ndodhi, po le të themi se kësaj here ja hodhëm e dolëm me pak siç thotë populli por herës tjetër s’do tja dalim dot as në sepse rrezikojmë objektin që e kemi bërë me mund emigracioni e as gjë sbesojmë se do mbetet si më parë, pasi situatë u qetësua të nesërmen telefonuam sërish Bashkinë Vlorë dhe përgjigjet që morëm nga humanët më djallëzorë të Bashkisë Vlorë, ishin aq të ulëta me shprehje e ofendime analfabetësh e prepotentësh se sipas tyre në qenkëshim qelbësira sepse demek duke kërkuar ndihmë paskemi shqetësuar kryetarin e bashkisë.”

Nga auditimi në terren u konstatua që në vendi ku ndodhet “S.R.H” paralel me rrugën Rradhimë – Orikum, në anën veriore të objekti kalon një përrua shkarkimet e të cili shpesh herë gjatë reshjeve kanë grumbulluar në gjatësinë e rrugës inerte që pengonin qarkullimin e mjeteve.

U konstatua që një mur betoni paralel me objektin dhe përroin, i cili, para se uji të kalojë në tombinon e rrugës, ka një thyerje këndore që zvogëlon hapësirën e kalimit të ujit dhe aluvioneve. Ky devijim ka shërbyer si tapë e cila nuk ka lejuar që materialet inerte të transportuar nga sasia e rreshjeve të kalojnë në tumbinon e rrugës, por mbi suprinën e rrugës Rradhimë - Orikum.

Pas kryerjes së verifikimeve në terren, grupi i auditimit përshkoi të gjithë gjatësinë e Bypass-it të Vlorës, që nga Kanina deri afër Tragjasit. Në opinionin e grupit të auditimit realizimi i Bypass-it të Vlorës nuk ka ndikim në lidhje me pasojat e ndodhura në objektin në fjalë.

4.10 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 8102, datë 3.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e ujit dhe të kullimit”;
- Ligji nr. 8518, datë 30.7.1999 “Për ujitjen dhe kullimin”, i ndryshuar me Ligjin nr. 9860, datë 21.1.2008;
- Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;

- Ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” ndryshuar me ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018;
- Ligji nr. 8681/2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”;
- Ligji nr. 53/2020 “Për disa ndryshime të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit,” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin e ujërave të ndotura”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin nga MB tek bashkitë të infrastrukturës së ujitjes, kullimit, të personelit dhe aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”;
- VKM nr.1107/2015 “Për krijimin e bordeve rajonale të Kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë”;
- VKM nr. 345, datë 22.5.2019 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të ujitjes dhe kullimit 2019–2031 dhe të planit të veprimit”;
- Vendim nr. 448, datë 26.7.2023 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2023–2030”;
- VKM nr. 302, datë 11.5.2022 “Për politikat kombëtare për organizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”;
- VKM nr. 807, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”;
- VKM nr. 437, datë 17.5.2017 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Durrës, Fier dhe Korçë”;
- VKM nr. 147/2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”;
- Urdhër i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”;
- Urdhër i MF nr.89, datë 28.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të performancës së njësive publike”;
- Urdhri nr.287/2006 “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit dhe administrimit të stacioneve të kullimit me elektropompa aksiale hidrovoret”.

4.11 Politikat detyruese dhe detyrimet ndërkombëtare

Direktiva Kuadër për Ujërat (BE): Që nga viti 2000, Direktiva Kuadër për Ujërat është ligji kryesor për mbrojtjen e ujërave në Europë që zbatohet për ujërat e brendshme, ujërat mes tokës dhe detit, ujërat bregdetare si dhe ujërat nëntokësore. Ajo fokusohet në sigurimin e shëndetit të mirë cilësor dhe sasior të trupave ujorë duke promovuar një qasje të integruar për menaxhimin e ujit. Bazohet në një qasje të gjerë të baseneve ujore. Zbatimi kombëtar është parashikuar me anë të planeve të menaxhimit

Konventa për Diversitetin Biologjik: Shqipëria ratifikoi Konventën në vitin 1994 dhe miratoi të gjitha Protokollat. Shqipëria gjithashtu paraqiti dhe zbatoi Planin e parë Kombëtar të Veprimit për Biodiversitetin dhe Speciet (2000-2015) PKBPV 2000-2015. Raporti i 5-të Kombëtar (2014) vendosi objektiva ambicioze deri në vitin 2020, për të cilat kontribuon PKLEV (nëse objektivat nuk janë arritur ende). Megjithatë, mbetet e paqartë nëse ka një plan monitorimi. Me shpalljen e PKLEV, Shqipëria bëri përparim të konsiderueshëm drejt objektivave të saj të biodiversitetit dhe duhet të përfshijë objektiva që lidhen me PKLEV në PKBPV-të e ardhshme. Natyra e PKLEV si zonë e mbrojtur në thelb e lidhur me rrethinat e saj dhe lidhja me disa zona të tjera të mbrojtura e bëjnë atë një kontribut potencialisht të rëndësishëm për objektivat e Kuadrit të CBD pas 2020.

Konventa e Bernës: Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Bernës për Ruajtjen e Kafshëve të Egra dhe Habitave Natyrore Europiane në vitin 1999. Ajo është një instrument ligjor ndërkombëtar detyrues në fushën e ruajtjes së natyrës kryesisht në Europë. Veçanërisht ka të

bëjë me mbrojtjen e habitateve natyrore dhe specieve të rrezikuara, sidomos speciet migratore me synim ruajtjen e florës dhe faunës së egër, habitateve të tyre natyrore, promovimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve dhe dhënien e vëmendjes të veçantë ndaj specieve të rrezikuara, të cënueshme, duke përfshirë speciet migratore vulnerabël. Ndërsa në Europë vendet përkatëse konsiderohen në zonat Natura 2000, në Shqipëri vendet përkatëse përmblihen në Rrjetin Emerald të Zonave me Interes të Veçantë të Konservimit (aktualisht 3 vende kandidatë në pellgun ujëmbledhës të lumit Vjosa: Peizazhi i Mbrojtur Vjosa-Nartë, Bredhi Hotovë -Parku Kombëtar Dangelli, Rezervati Natyror i Menaxhuar Germenj-Shelegure-Leskovik-Piskal). Në Shqipëri, të gjitha vendet janë aktualisht të listuara si zona kandidatë për miratim nga Konventa e Bernës. Vjosa nuk është nominuar ende, por do të luajë një rol kyç ose si Sit Emerald ose si sit Natura 2000.

Konventa për mbrojtjen dhe përdorimin e rrjedhave ujore ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare (Konventa e Ujit): Kjo konventë e UNECE është një marrëveshje ndërkombëtare për të përmirësuar përpjekjet dhe masat kombëtare për mbrojtjen dhe menaxhimin e ujërave ndërkufitare sipërfaqësore dhe nëntokësore. Për këtë, palët e Konventës janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe të krijojnë organe të përbashkëta. Ajo ka hyrë në fuqi në vitin 1996 dhe është ratifikuar nga Shqipëria dhe Greqia. Duke marrë parasysh aspektin ndërkufitar dhe aspiratën për të bashkërenduar përpjekjet mbrojtëse me palën greke të Vjosës (Aos), kjo Konventë mund të luajë një rol të rëndësishëm.

4.12 Kuadri institucional

Përgjegjësia për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane shtrihet në të dyja dimensionet e qeverisjes, asaj qendrore dhe asaj vendore.

Qeverisja qendrore është përgjegjëse për përcaktimin e vizionit strategjik të sektorit dhe hartimin dhe monitorimin e kuadrit rregullator mbi të cilin mbështetet gjithë sektori, ndërsa qeverisja vendore është përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi.

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e shkurtër e kuadrit kryesor institucional, përgjegjës për të organizuar dhe për të rregulluar shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision të saj:

- hartimin, zbatimin dhe ndjekjen e politikave të zhvillimit infrastrukturor;
- drejtimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe vendosjen e standardeve teknike të infrastrukturës;
- monitorimin e realizimit të standardeve të përcaktuara në funksion të zhvillimit të infrastrukturës, si dhe të punimeve të ndërtimit për zbatimin e rregullave për kontrollin e disiplinimin e tyre në aspektin financiar e teknik.

MIE, në bashkëpunim dhe me ministritë e tjera të linjës, ka rolin parësor të kanalizimit të fondeve të donatorëve dhe të buxhetit qendror për investime kapitale, bazuar në vlerësimin e nevojave sipas masterplanit kombëtar dhe nevojave që vijnë nga qeverisja vendore. **MIE nuk është objekt i auditimit.**

- Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK)

AKUK-ja, si strukturë në varësi të MIE-s, përfaqëson institucionin teknik të specializuar të qeverisjes qendrore në sektorin e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të agjencisë përfshijnë analizën, hartimin dhe ndjekjen e planeve të veprimit në zbatim të politikave dhe strategjive të miratuara. Në kuadër të nismës së qeverisë shqiptare për reformimin e sektorit, AKUK është aktori përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e reformës sektoriale. Procesi i rajonalizimit të shoqërive UK kërkon angazhim të konsiderueshëm të të gjithëstrukturave aktuale të AKUK-së, por edhe të strukturave të reja qeveritare.

Referuar zhvillimeve të fundit në sektor, AKUK-ja është pjesë integrale aktive e subjektit të kompetencave të përbashkëta dhe ka rolin kryesor për të planifikuar dhe për të zbatuar siç duhet procesin e agregimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët e tjerë kryesorë pjesëmarrës në këtë proces. **AKUK nuk është objekt i auditimit.**

- Njësitë e qeverisjes vendore

Qeveria shqiptare ka zhvilluar dhe ka zbatuar me sukses reformën administrative territoriale, duke riorganizuar njësitë e qeverisjes vendore në 61 bashki.

Në kontekstin e kësaj strategjie, në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike, bashkitë për territorin nën juridiksionin e tyre janë përgjegjëse, për:

- prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm;
- mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, përveç saktësimit të përgjegjesisë së mësipërme, parashikohet dhe mënyra se si dy apo më shumë njësi bashkëpunojnë, duke krijuar dhe një subjekt të përbashkët.

Në maj të vitit 2022, Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, ka miratuar vendimin nr. 302, i cili përcakton politika të reja për ristrukturimin e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, mbështetur pikërisht mbi përcaktimin e mësipërm.

- Operatorët e shërbimit

Nisur nga Vendimi i Këshillit të Ministrave, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane”, shumica e shoqërive aksionare (operatorëve) ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve po riorganizohen (disa tashmë të finalizuara) si subjekte me kompetenca të përbashkëta (në vijim “SKP”), sipas sistemit të administrimit me dy nivele. Procesi i rajonalizimit të shoqërive ekzistuese dhe krijimi i SKP-së, sipas hartës dhe miratuar me VKM-në nr. 302, datë 11.5.2022, kërkoi dhe po merr miratimin nga organet e vetëqeverisjes vendore. Qasja e re konsiston në krijimin e shoqërive të reja të agreguara aksionare, sipas sistemit me dy nivele administrimi, në përputhje me përcaktimet në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Njësitë e qeverisjes vendore që kanë dakordësuar, apo do të bien dakord për themelimin e SKP-UK-së, kanë nënshkruar, apo do të nënshkruajnë, marrëveshjen dhe statutin tip, të cilat shërbejnë si akte themelore për krijimin e SKP-UK-së, e cila do të kryejë veprimtarinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura në tërë territorin administrativ që më parë mbulohej nga shoqëritë e veçanta.

SKP-UK SHA. të krijuara deri më sot iu transferuan të gjitha të drejtat, detyrimet, si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për transferimin e aktivitetit të shoqërive ekzistuese të SHA.

- Enti Rregullator i Ujit (ERRU)

ERRU-ja është një institucion publik i pavarur, i cili ka rol kryesisht rregullator në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për të siguruar mbrojtjen e interesit publik dhe për të krijuar një kuadër transparent veprimtarie të aktorëve të përfshirë. Disa nga funksionet kryesore të ERRU-së janë:

- të licencojë të gjithë personat fizikë dhe juridikë që u japin shërbime të furnizimit me ujë dhe/ose ujërave të ndotura për publikun;
- të sigurojë që ofruesit e shërbimeve ofrojnë shërbime cilësore dhe efikase me një çmim të arsyeshëm;
- të rregullojë tarifën e shërbimeve, në një mënyrë që siguron qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve, si dhe përballueshmërinë për konsumatorët;

- të monitorojë performancën e operatorëve të shërbimit në përgjithësi, si dhe të hartojë dhe të paraqesë raporte vjetore përkatëse pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave. ERRU nuk është objekt i auditimit.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), bazuar në prioritetet e qeverisë, është përgjegjëse për alokimin e burimeve financiare për sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për plotësimin e nevojave të shoqërisë. MFE nuk është objekt i auditimit.

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) ka përgjegjësinë për të siguruar që të gjitha aspektet mjedisore kryesorë të ujit, si dhe direktivat e BE-së. MTE nuk është objekt i auditimit.

4.13 Situata në kontekstin kombëtar dhe rajonal

Burimet dokumentare mbi fenomenin e përmbytjeve në Shqipëri janë tashmë të faktuara. Ato flasin për periudha dhe vite të tilla nga të cilat mund të dallojmë: vitet 1854, 1860, 1865, 1867, 1868, 1869, 1870, 1871, 1937, 1952, 1962-1963, 1983, 2010, 2015, 2017, 2021. Nga të dhënat përmbytjet e vitit 1962-1963, kanë qenë më të mëdhatë e të gjitha përmbytjeve, që kanë ndodhur në Shqipëri përgjatë shekullit të XX-të e deri sot.

Sipërfaqja e përmbytur në gjithë vendin shkon mesatarisht nga 65 mijë ha deri 110 mijë ha; ndërkohë që prurjet maksimale shkojnë në 3,650 m³/s në lumin Vjosë, dhe 5,180 m³/s në lumin Drin, etj.

Sasia mesatare e rrëshjeve vjetore në Shqipëri shkon në 1,485 mm/vit. Ajo varion nga 1,000 mm/vit për zonat e ulëta deri në 3,000 mm/vit në zonat malore. Rreth 70% e sasisë totale vjetore të reshjeve bie në periudhën **Tetor – Mars**. Nëntori është muaji me nivelin më të lartë të reshjeve. Në Shqipëri rreth 130,000 ha janë të pajisur me infrastrukturë mbrojtëse për përmbytjet nga lumenjtë dhe deti. Përmbytjet në dimër dhe thatësira në verë sa vjen e bëhen më prezente në Shqipëri, sidomos gjatë dy dekadave të fundit.

Largimi i ujërave të përmbytjes është përkeqësuar për shkak të mbushjeve në kanalet kulluese dhe uljes së kapacitetit largues të hidrovorëve. Pritet që situata të përkeqësohet akoma më shumë për shkak të ndryshimeve klimatike, të cilat reflektohen me fenomene moti ekstreme. Një sërë masash vazhdojnë të meren përsa i takon sigurisë së digave dhe zvogëlimit të efektit të përmbytjeve. Mbas periudhës së ujitjes, merren masa për uljen e sasisë së ujit në rezervuarë për periudhën e dimrit, nga nëntori deri në mars.

Është vlerësuar se janë rreth 3285 ndërtime pa leje në infrastrukturën ujitëse, kulluese dhe të mbrojtjes nga përmbytja. Këto ndërhyrje ndikojnë negativisht në infrastrukturën e ujitje/kullimit apo mbrojtjes nga përmbytjet. Urbanizimi dhe ndërhyrjet njerëzore nga njëra anë, degradimi natyror i veprave nga ana tjetër, kanë bërë që shumë prej veprave mbrojtëse të jenë jashtë funksionit apo gjysmë funksionale, në një mjedis ku frekuenca, ashpërsia dhe vendodhjet e përmbytjeve po rriten. Për këtë arsye, është e pashmangshme nevoja për rritjen e investimeve dhe asistencë në këtë fushë, përndryshe situata do të përkeqësohej gjithnjë e më shumë.

Sipas VKM nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre”, territori i Shqipërisë, në funksion të menaxhimit të burimeve ujore, ndahet në shtatë basene ujore. Qyteti i Vlorës shtrihet në basenin ujqor Vjosë. Në çdo basen ujqor funksionon Këshilli i Basenit Ujqor (KBU), me kryetar prefektin e qarkut.

Vjosa, i vetmi lumë i egër në Evropë, vijon të jetë një rrezik, për mijëra hektarë tokë dhe me dhjetra famije që rrezikohen nga përmbytjet në rast të reshjeve të dendura. Plani i menaxhimit të basenit të lumit Vjosa 2024 – 2033, filloi në qershor 2023, tre muaj pas shpalljes së Parku Kombëtar i Lumit Vjosa (PKLEV). Ai bazohet drejtpërdrejt në rezultatet dhe raportet e

studimit të fizibilitetit (Greca and Sovinc, 2022) të cilat u përgatitën si bazë për shpalljen formale të PKLEV.

Disa nga përmbytyet më të mëdha që kanë ndodhur në vendin tonë janë të paraqitura në Aneksin nr. 7 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Kështu sipas “DesInventar”², një sistem ky për menaxhimin e informacionit rreth fatkeqësive, nga viti 1852 deri në çerekun e parë të shekullit XXI, në Shqipëri kanë ndodhur rreth 4000 raste fatkeqësish, ndërkohë që përmbytyet kapin përqindjen më të madhe të fatkeqësive në rreth 38%.

Vetëm në vitet e demokracisë në tre dekada humbjet ekonomike të shkaktuara nga përmbytyet përlloragiten në rreth 2,5 miliardë dollarë. Pra, kushtojnë më lirë masa paraprake investuese për parandalimin e përmbytyeve se sa pritje e ndodhjes së tyre dhe më tej marrja e masave riparuese dhe eliminimi i pasojave.

4.14 Përshkrimi i sistemit hidrik në zonën e përmbytur

Vjosa është lumi i dytë më i madh në Shqipëri dhe mbyll serinë e gjashtë lumenjve kryesorë që hyjnë në detin Adriatik, të cilët formojnë të gjithë fushën aluviale bregdetare, duke filluar në veri me sistemin e madh Drin – Moraçë – Bojanë - Bunë dhe më poshtë, me lumenjtë Mat, Erzen, Shkumbin dhe Seman. Së bashku me Semanin (Devollin dhe Osumin), Vjosa krijon një grykëderdhje në ultësirë të madhe.

Pellgu ujëmbledhës ndërkufitar i Vjosës mbulon afërsisht 6,800 km² (4,540 km² në Shqipëri), dhe lumi rrjedh në drejtimin JL-VP në një gjatësi prej 272 km (190 prej të cilave ndodhen në Shqipëri) nga vargmalet e Pindit në Greqi deri në grykëderdhjen e Vjosës dhe më pas në detin Adriatik. Pellgu ujëmbledhës i Shqipërisë kalon në rrethet e Korçës, Beratit, Gjirokastrës, Vlorës dhe Fierit. Vjosa dhe degët e saj formojnë një ekosistem natyror funksional mjaft të madh për të zbutur shqetësimet e jashtme të zonave të tjera të transformuara që gjenden pranë dhe përgjatë korridorit të lumit, ku këto të fundit nuk arrijnë të ndikojnë ndjeshëm në proceset hidrologjike natyrore. Megjithatë, ekosistemi është jashtëzakonisht i brishtë dhe i ndjeshëm, kështu që mund të ndryshohet në mënyrë dramatike nga çdo ndryshim në regjimin e ujit në rrjedhën e sipërme ose në rrjedhën e poshtme (Sovinc, 2021).

Në kontekstin gjeologjik, hidro - morfologjik, hidrologjik dhe ekologjik, lugina e Lumit Vjosa mund të ndahet në tre nënnyjësi:

- Pjesa e sipërme e Lumit Vjosa karakterizohet nga gryka të thepisura midis Përmetit, Këlcyrës dhe Dragotit, të përshkuara nga zona me kone depozitimi dhe ujëmbledhës të mëdhenj. Lugina e Lumit Vjosa zgjerohet në rrjedhën e sipërme të zonës së Dragotit, me përjashtim të grykës së Poçemit.
- Pjesa e mesme, përgjatë shtrirjes që përfshin bashkimin me lumin Drino, ku ndodhet qyteti i Tepelenës, është e njohur për brigjet e mëdha me rërë dhe zhavorr të formuara nga lumi i degëzuar. Në rrjedhën e poshtme të Selenicës, zona e Pellgut Ujëmbledhës të Lumit Vjosa zvogëlohet, lugina hapet dhe lumi fillon të gjarpërojë. Fushat e përmbytyes së lumit Vjosa njihen si një nga ekosistemet bregdetare më të mrekullueshme të Gadishullit Ballkanik, të karakterizuara nga proceset e tyre natyrore hidro-morfodinamike lumore. Përroi i gjerë i degëzuar, brigjet dhe ishujt e brigjet e mëdhenj të zhavorrit, speciet bimore pioniere, shelgjet, plepat dhe brukat i japin luginës së Vjosës një karakter të jashtëzakonshëm.
- Pjesa e poshtme karakterizohet nga shtrirja e Lumit Vjosa dhe formimi i gjarpërimeve të gjera. Mes qyteteve të Fierit dhe Vlorës, Lumi Vjosa kalon nëpër Ultësirën e Myzeqesë dhe derdhet drejt Detit Adriatik. Grykëderdhja e Lumit Vjosa ndodhet në veri të Lagunës së Nartës, ku ai del në det.

Klima: Pellgu Ujëmbledhës i Lumit Vjosa është pjesë e zonës klimatike kodrinore juglindore, që luan një rol të rëndësishëm në klimën e rajonit, duke ndikuar në temperatura dhe reshje.

² <https://www.desinventar.net/>

Klima e Pellgut të Vjosa mund të karakterizohet si mesdhetare, me verë të thatë dhe të nxehtë dhe dimër të butë e të lagësht. Pjesa perëndimore e Pellgut është më e ngrohtë se ajo lindore për shkak të lartësisë më të ulët dhe afërsisë me detin.

Vlerat mesatare të temperaturës variojnë nga 10.7 në 17.5 °C përgjatë luginës së Lumit Vjosa dhe nga 6 në 10 °C në zonat malore. Temperaturat mesatare maksimale në pjesët e sipërme, të mesme dhe të poshtme të Pellgut Ujëmbledhës të Vjosës variojnë ndërmjet 26.9 dhe 35.8 °C. Muajt më të nxehtë janë qershori, korriku dhe gushti, me temperatura mesatare ditore midis 20°C dhe 24°C. Vlerat maksimale mesatare më të larta janë ndërmjet 26°C dhe 36°C, dhe vlerat maksimale absolute të vëzhguara janë 41.6°C të regjistruara në Fier (6 korrik 1988) dhe 43.5°C në Selenicë (18 korrik 1973). Muajt më të ftohtë janë nga dhjetori në shkurt, me temperatura mesatare ditore nën 5°C.

Reshjet mesatare vjetore në pellgun e lumit variojnë nga 950 deri në 1600 mm, ndërsa reshjet vjetore afatgjata arrijnë në 1076,2 mm, nga të cilat rreth 66% bien në vjeshtë dhe dimër. Reshjet minimale zakonisht ndodhin në muajt e verës (qershor, korrik dhe gusht), ndërsa më shumë në nëntor dhe dhjetor. Numri i ditëve me shi varion nga 85 deri në 100 ditë në vit. Të dhënat e klimës në zonë janë marrë nga Climate 6 Explorer (Wickel et al., 2017). Reshjet në Luginën e Vjosës variojnë mesatarisht nga më pak se 1000 mm në rajonin bregdetar dhe në rajonin më verilindor deri në 1600 mm kryesisht në kreshtat malore të Pellgut Ujëmbledhës të Drinos. Reshjet më të larta, të dominuara nga zona klimatike mesdhetare, e cila ndahet në zona orografike (nga bregdeti në malet e larta), ndodhin në kreshtat e para të larta drejt detit Adriatik, ku sipas konveksionit dhe ngritjes së masave ajrore të lagështa gjatë dimrit, mund të pritët pjesa më e madhe e reshjeve. Muaji më i lagësht është shkurti, ndërsa gusht-shtator është periudha më e thatë e vitit.

Fushat e përmytjeve të lumit Vjosë: Përmytjet në rrjedhën e sipërme dhe të mesme me pjerrësi më të lartë janë të shkurtra, ato përfshijnë Vjosën e poshtme për disa javë. Përmytjet e shtratit të lumit mbulojnë rregullisht të gjithë kanalën aktiv dhe janë përgjegjës për zhvendosjen e kanaleve dhe për përtëritjen e bimësisë së re mbi prurjet dhe ishujt e zhavorrit. Përmytjet e rregullta, por më pak të shpeshta (përmytjet të gjitha >1-5 vjet) janë të një rëndësie të madhe për kushtet ekologjike në fushat e përmytjeve të ulëta. Ato formojnë dhe i japin trajtë fushave të përmytjeve ngjitur me kanalën aktiv dhe mbi ishujt kryesorë. Shkurre shëlgjesh dhe plepi, në rrjedhat e sipërme dhe rrapi krijojnë bimësinë fillestare, shpesh duke stabilizuar tokën të paktën deri në përmytjen tjetër të madhe.

Në zonat më të larta të fushës së përmytjes aktive (përmytjet mbi 5-30 vjet), gjenden vetëm mbetje të pyjeve të përmytjeve, kryesisht të dominuara nga plepat. Shumica e këtyre pyjeve u shndërruan në tokë bujqësore me kalimin e viteve. Në fushën e mbetur të përmytjeve morfologjike (përmytje të gjitha >30-300 vjet) mund të gjenden vendbanime të shumta dhe infrastrukturë urbanë.

Përmytja e fundit e regjistruar nga lumi Vjosë është më datat 8 - 11 Janar 2021. Pra, përmytjet e ndodhura nga kjo kohë, janë shkaktuar nga mosfunksionimi i kanaleve, tubacioneve dhe stacioneve të pompimit në qytetin e Vlorës.

V. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të VKM-së nr. 1108, datë 30.12.20215 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe administrimit të ujërave të bashkisë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit” është formuluar urdhri i Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, dhe Ministrit të Pushtetit për Çështjet Vendore me nr. 594, datë 24.11.2016 "Për transferimin kapital të aseteve". Në vijim, është kryer transferimi i infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave tek Bashkitë. Gjatë analizimit të përmbajtjes së tabelës nr.1/1 “Transferimi i skemave kulluese” të urdhrat të mësipërm, u konstatua se, i janë transferuar Bashkisë Vlorë disa kanale, të cilat janë jashtë territorit të Qytetit të Vlorës., sipas tabelës nr.1/1 është transferuar vetëm godina e hidrovorit (si ndërtesë), ndërsa kanali që dërgon ujin tek hidrovori nuk është transferuar.

Sa më sipër urdhrat e dalë në zbatim të VKM-së kanë sjellë paqartësi në përmbushjen e kompetencave, midis “SHRUKV” SHA apo Bordi i Ujitjes/Kullimit në Bashkinë Vlorë, përsa i përket pastrimit dhe mirëmbajtjes së këtij kanali.

Gjithashtu në procesverbalin e mbajtur në datë 21.01.2016 me objekt: “Për transferimin nga Bordi Rajonal i Kullimit Fier në Bashkinë Vlorë, infrastruktura e ujitjes e kullimit dhe aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme”, u konstatua se ka ndryshime në parametrat e pajisjeve, të cilat janë transferuar referuar VKM-së, konkretisht, fuqia e pompave nuk është 1400 Kw por **1200 Kw**, kapaciteti total i hidrovorit nuk është 21 m³/sek por **16 m³/sek**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 dhe 6 faqe 23-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë në bashkëpunim me “SHRUKV” SHA të marrin të gjitha masat duke komunikuar në formë shkresore për të saktësuar komponentët e infrastrukturës së Ujitjes/Kullimit që kanë në ngarkim në territorin e Bashkisë Vlorë.

Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Bordin Rajonal të Kullimit Fier, të marrin të gjitha masat duke komunikuar në formë shkresore për të korrigjuar pasaktësitë në të dhënat mbi kapacitetin e hidrovorit, sipas VKM-së nr. 1108, datë 30.12.2015, dhe procesverbalit të datës 21.01.2016, për pasqyrimin e fuqisë reale të pompave dhe kapacitetin real të hidrovorit, me qëllim planifikimin e mundshëm për investime të reja

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të transferimit tek Bashkia Vlorë i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit u konstatua se, procesi i transferimit ka mungesë të dokumentacionit teknik shoqërues në lidhje me kanalet, plan vendosjen, profilet gjatësore/tërthore të tyre, parametrat e digave dampave dhe tombinove ekzistuese, të cilat janë pjesë e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Aktualisht, sektori i bordit të ujitjes dhe kullimit pranë NSHP, Vlorë nuk disponon informacione teknike në lidhje me kanalet që ka në ngarkim, sipas skemave të transferuara me VKM-në nr.1108, datë 30.12.20215, pasi mungojnë hartat e azhornuara me informacione (planvendosje, profilet gjatësore/tërthore etj.) në lidhje me kanalet, argjinaturat. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 33-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masa për të përfunduar procesin e transferimit, duke përpiluar dhe kërkuar dokumentacionin teknik të plotë, përfshirë hartat dhe të dhënat e azhornuara për kanalet ujitëse dhe kulluese, argjinaturat dhe veprat e marrjes. Në pamundësi të arritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional, NSHP Vlorë të marrin masat e nevojshme për azhornimin e informacionit të plotë teknik në lidhje me infrastrukturë që ka pasur në ngarkim

(duke përfshirë hartat dhe të dhënat e azhornuara, për kanalet ujitëse/kulluese, argjinaturat dhe veprat e marrjes).

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të kryera nga NSHP Vlorë, u konstatua se me urdhrin e prokurimit me nr. 26, datë 12.09.2023 është realizuar procedura e prokurimit publik me objekt “*Mirëmbajtjen e hidrovorit*” me fond limit në shumën prej 2,916,667 lekë pa TVSH dhe fitues OE “S” SHPK, me vlerë kontrate në shumë prej 2,766,214 lekë pa TVSH.

Punimet kryesore referuar preventivit të punimeve përfshinin: riparime elektrike, ndërrim pjesësh të sistemit elektrik, mirëmbajtjen e pompave nr. 1, 3, 4, riparimin e pompës Ganz 500 nr. 1, si dhe riparimin e kapakëve të pompave nr. 3 dhe 4. Sa më sipër rezulton se pompa nr. 2, e cila ka pasur defekte që para vitit 2020, nuk ishte përfshirë në preventiv për riparim ose zëvendësim. Mos riparimi i saj ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë negativisht në efikasitetin e përgjithshëm të sistemit, duke ulur gatishmërinë dhe duke shkaktuar ndërprerje gjatë operimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 33-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Nga ana e NSHP, Vlorë të merren të gjitha masat, për të kryer investime në riparimin ose zëvendësimin e pompës nr.2 të hidrovorit të qytetit me qëllim zgjidhjen përfundimtare të problemeve të shfaqura në hidrovor. Gjithashtu të siguroj që procedurat e ardhshme të prokurimit të mbështeten nga një planifikim i saktë dhe i detajuar i investimeve, duke marrë parasysh problematikat kritike, defektet dhe çështje të tjera të mundshme.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në hidrovorin e Qytetit të Vlorës, u konstatua që dokumentacioni i kërkuar sipas Udhëzimit nr. 12, datë 30.12.2019 “*Për rregullat e kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit*”, nuk mbahej rregullisht. Mungonin dokumentet referuar nenit 12.7 në pikat “e” dhe “f” të udhëzimit, konkretisht skemat elektrike dhe mekanike, si dhe skema e furnizimit me energji elektrike, që janë të nevojshme për një shfrytëzim të sigurt dhe efikas të hidrovorit. Po ashtu, shënuesi i niveli kritik të ujit nuk ishte i vendosur në hidrovor, duke e bërë të vështirë reagimin në kohë ndaj përmbytjeve. Ndryshimet në strukturën organizative të Bashkisë Vlorë gjatë vitit 2024 (Vendim i Kryetarit të Bashkisë me nr. 42, datë 18.04.2024 dhe nr. 126, datë 01.10.2024), si dhe mos mbajtja e rregullt e dokumentacionit e bëjnë të pamundur kryerjen e kontrolleve rutinë, pasi specialistët që ishin të ngarkuar për këtë detyrë janë hequr nga struktura e re. Sipas strukturës së re organizative, Përgjegjësi i Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit në NSHP nuk ka staf në varësi, që të kryejë kontrollet në zbatimin e udhëzimit për mirëmbajtjen dhe funksionimin e hidrovorit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 33-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Nga ana e NSHP Vlorë, Sektori i Bordit të Ujitje-Kullim të merren të gjitha masat për të zbatuar në mënyrë korrekte procedurat e kontrolleve, si dhe mbajtja e rregullt e dokumentacionit në subjekt, në përputhje me përcaktimet rregullative. Nga ana e NSHP Vlorë të merren masa për korrigjimet dhe plotësimin e dokumentacionit që duhet të mbahet në hidrovor referuar Udhëzimit nr. 12, datë 30.12.2019 aktuale. Gjithashtu të merren masa për vendosjen e shënuesit të nivelit kritik të ujit në hidrovor. Nga ana e Bashkisë Vlorë të merren masa për të vlerësuar situatën në lidhje me plotësimin e mungesës së specialistëve ose ristrukturimin e Sektorit të Bordit Ujitje-Kullim nëse është e nevojshme, për të garantuar kryerjen e kontrolleve rutinë dhe zbatimin e udhëzimeve të mirëmbajtjes. Kjo gjë do të përmirësojë menaxhimin dhe gatishmërinë e hidrovorit, duke shmangur përmbytjet dhe problemet e tjera operacionale.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Ujitjes dhe Kullimit në NSHP Vlorë, u konstatuan problematika për mënyrën se si dalin mjetet në terren. Nga viti 2023 deri në qershor të vitit 2024, makineritë e rënda dilnin në terren me urdhër shërbimi të firmosur nga drejtori i NSHP Vlorë, ndërsa pas qershorit të vitit 2024 nuk rezultoi të ketë gjurmë dokumentare, që të justifikojnë daljen e mjeteve në terren. Nga 2 kontrolle të kryera në terren rezultoi se mjetet ishin duke punuar në territorin e qytetit pra jashtë planeve të punës. Përdorimi i mjeteve të NSHP Vlorë për qëllime të tjera nga pastrimi i kanaleve që Nshp ka në ngarkim, ka sjellë mosrealizimin e planit vjetor në masën rreth 80% të sasisë së kanaleve që janë parashikuar për t'u pastruar për vitin 2024. Sa më sipër veprimet janë në kundërshtim me pikën 13.3 të Udhëzimit nr.12, datë 30.12.20019, ku kërkohet miratimi i ministrit për lëvizjen e makinerisë, si për punime brenda drejtorive, ashtu edhe për punime për llogari të subjekteve private ose shtetërore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 33-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: NSHP Vlorë të marrë masat që çdo rast i daljes së makinerive të rënda në terren, të jetë i dokumentuar dhe i firmosur nga Titullari dhe Përgjegjësi i Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit në NSHP.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në hidrovorin e Qytetit të Vlorës u konstatuan mangësi thelbësore si vijon:

- Hidrovori punon pa pompa rezervë, në shkelje të kushteve teknike të operimit dhe përcaktimeve të ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”. Për këtë shkak gjatë situatave të reshjeve intensive i gjithë sistemi i hidrovorit punon në mbingarkesë, duke sjellë nxehjen e popmave. Kjo mangësi i detyron që specialistët që operojnë në hidrovor të fikin pompat derisa sistemi të rivihet edhe njëherë në punë në kushte optimale.
- Linja elektrike që furnizon me energji hidrovorin e Qytetit të Vlorës është e vjetër 6 KË. Nga auditimi i hidrovorit rezultoi se gjatë situatave të reshjeve intensive kjo linjë elektrike nuk e përballon ngarkesën, duke shkaktuar ndërprerje të energjisë në hidrovor. Kjo situatë konfirmohet edhe nga relacioni me nr. 1520 Prot., datë 17.10.2024 i dërguar nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit në NSHP Vlorë drejtuar Titullarit të NSHP, ku ndër të tjerat është kërkuar dhe lidhja e hidrovorit me një linjë me tension më të lartë 20 KW.
- Mungon një gjenerator i dedikuar për emergjencat, si në rast të mungesës së energjisë ose përmbajtjeve. Ky fakt konfirmohet edhe nga relacioni me nr.1520 Prot., datë 17.10.2024 si dhe në kërkesën e blerjes së një gjeneratori nga ana e NSHP Vlorë, për rastet e shkëputjes së energjisë dhe për raste emergjence. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 33-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: Nga NSHP Vlorë të merren masa për të siguruar mbarëvajtjen e punës së hidrovorit, si dhe funksionalitetit të tij duke:

- përmbushur kushtet teknike për të siguruar funksionimin pa ndërprerje të hidrovorit;
- përmirësuar linjën elektrike të hidrovorit, nga 6 KW në një tension më të lartë 20 KW, me qëllim përballimin e ngarkesës dhe shmangien e ndërprerjes së energjisë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë deri në shkurt të vitit 2024 janë pastruar rreth 58.42 km kanale, janë identifikuar si kanale emergjente për pastrim, ato të Kullimit Myzeqe, Lllakatund, Dukat-Tragjas, dhe Babicë, si dhe disa skema ujitëse.

Pavarësisht kësaj, kanalet në zonat e Novoselës dhe Nartës janë në gjendje të rënduar për shkak të bllokimeve dhe mbetjeve të grumbulluara, duke krijuar rrezik për përmytje. Sipas planit vjetor të punimeve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për vitin 2024 parashikohet me mjetet që ka në dispozicion kjo ndërmarrje të pastrohen 155 km kanale që NSHP ka në ngarkim. Rezulton se deri në nëntor të vitit 2024 janë rreth 32.49 km kanale të pastruar, pra kemi mosrealizim të planit vjetor në masën rreth 80% të sasisë së parashikuar për t'u pastruar për vitin 2024. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 33-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë, të marrë masa të menjëhershme për pastrimin e kanaleve të cilat janë klasifikuar si urgjente në zonat e Novoselës dhe Nartës me qëllim shmangien e rrezikut të përmytjeve. Nga NSHP Vlorë, të merren masa për përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të burimeve, me qëllim realizimin e pastrimit të plotë të kanaleve të parashikuara, duke adresuar problemet e identifikuar dhe shmangur mosrealizimin e planeve vjetore.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë deri në shkurt të vitit 2024 janë pastruar rreth 58.42 km kanale, janë identifikuar si kanale emergjente për pastrim, ato të Kullimit Myzeqe, Llakatund, Dukat-Tragjas, dhe Babicë, si dhe disa skema ujitëse. Pavarësisht kësaj, kanalet në zonat e Novoselës dhe Nartës janë në gjendje të rënduar për shkak të bllokimeve dhe mbetjeve të grumbulluara, duke krijuar rrezik për përmytje. Sipas planit vjetor të punimeve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike për vitin 2024 parashikohet me mjetet që ka në dispozicion kjo ndërmarrje të pastrohen 155 km kanale që NSHP ka në ngarkim. Rezulton se deri në nëntor të vitit 2024 janë rreth 32.49 km kanale të pastruar, pra kemi mosrealizim të planit vjetor në masën rreth 80% të sasisë së parashikuar për t'u pastruar për vitin 2024. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 33-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë, të marrë masa të menjëhershme për pastrimin e kanaleve të cilat janë klasifikuar si urgjente në zonat e Novoselës dhe Nartës me qëllim shmangien e rrezikut të përmytjeve. Nga NSHP Vlorë, të merren masa për përmirësimin e planifikimit dhe menaxhimit të burimeve, me qëllim realizimin e pastrimit të plotë të kanaleve të parashikuara, duke adresuar problemet e identifikuar dhe shmangur mosrealizimin e planeve vjetore.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në qytetin e Vlorës zbatohet projekti me objekt: “*Punime rehabilituese për sistemin e shpërndarjes së ujit në Vlorë, Albania*”, të lidhur me kontratën datë 14.09.2023 midis operatorit ekonomik (i huaj) “*A G L*” dhe “*Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Vlorë*” SHA, me vlerë 16,794,130.30 Euro pa TVSH.

Nga auditimi në terren u konstatua se në akset ku janë kryer punimet për shtrimin e tubave nuk është realizuar kthimi i tyre në gjendjen fillestare, por janë mbushur me çakëll dhe në shumë vende ka një disnivel të theksuar midis kanalit dhe asfaltit ekzistues, të cilat krijojnë vështirësi në qarkullimin e mjeteve. Në të gjitha rrugët e hapura gjatë përmytjes, disniveli i kanaleve ka shërbyer si depozita uji dhe nuk e ka lejuar atë të largohet në rrjedhje normale. Gjithashtu, rrjedha mund të ketë marrë me vete edhe sasi çakulli, duke kaluar në sistemin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të ndotura, e kështu duke krijuar probleme në funksionimin e tyre. Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike për realizimin e punimeve rezultoi se grafiku i punimeve është ndryshuar, nga ai i paraqitur në marrjen e lejes infrastrukturore, pa u konsultuar dhe miratuar nga Bashkia Vlorë, si enti pronar i rrugëve. Bashkia Vlorë nuk ka ngritur një grup pune për monitorimin e punimeve të projektit dhe nuk ka një plan veprimi dhe grafik se si do të operohet për realizimin e punimeve, cilat rrugë do të hapen, si do të menaxhohet trafiku, kjo e detajuar mujore, për realizimin e punimeve sipas kushteve të kontratës, për kontrollin e

territorit në administrim. Sa më sipër veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; si dhe VKM-në nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”. Vonesat në kthimin e rrugëve në gjendjen fillestare kanë sjell ndikim në mjedis duke mos përmbushur kërkesat e parashikuara në kundërshtim me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar; kreu III “Mbrojtja e përbërësve të mjedisit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 33-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë, për projektet aktuale në zhvillim dhe ato në të ardhmen, të marrë masë për krijimin e grupeve të punës, të cilat duhet të koordinojnë me institucionet që realizojnë projekte infrastrukturore në territorin e saj, si dhe me sipërmarrësit (kontraktor, mbikëqyrës).

Këto grupe duhet të sigurojnë monitorimin e vazhdueshëm të punimeve, me qëllim parandalimin e problematikave që mund të ndikojnë në jetën e qytetarëve, duke sjellë ndryshime në aspektet ekonomike, sociale dhe mjedisore.

Menjëherë e në vijimësi

9.2 Rekomandimi: Bashkia Vlorë, nëpërmjet INUV-së të marrë masa për penalizimin e sipërmarrësve dhe mbikëqyrësve, të cilët kanë ndryshuar grafikun e punimeve të paraqitur për marrjen e lejes infrastrukturore, pa njoftuar dhe marrë më parë lejen nga Bashkia Vlorë, si enti pronar i rrugëve lokale të Qytetit të Vlorës.

Menjëherë e në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile (AKMC) sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për periudhën 2022 - 2023 dhe 8-mujori e vitit 2024 ka shpërndarë transfertat e kushtëzuara nga buxheti i shtetit, me kod 91707AG – “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve”, me kod 91707AB – “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”. Nga auditimi u konstatua se, fondi i përdorur në vitet e fundit nuk ka kaluar 25% në nivel qarku, ndërsa Bashkia Vlorë ka përdorur vetëm 70% të këtij fondi. Kjo tregon se nga ana Bashkisë Vlorë dhe institucioneve të tjera nuk janë marrë masa për të gjeneruar fonde dhe për të tërhequr investime, për rrjedhojë mungesa e tyre ka ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e pasojave social ekonomike dhe ekologjike nga përmbytja e fundit. Mos hartimi i projekteve parandaluese dhe mungesa e gjenerimit të fondeve të kushtëzuara nga ana e institucioneve përgjegjëse është në kundërshtim me ligjin 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, datë 18.07.2019, VKM-në nr. 414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” si dhe ligjet për buxhetin e viteve përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 66-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe përgjegjëse, të marrë masa për rritjen e kapaciteteve profesionale në hartimin e projekteve, që ndikojnë në parandalimin e përmbytjeve, e cila do të mundësojë aplikimin dhe gjenerimin e fondeve, si dhe realizimin e investimeve që do të kontribuojnë drejtpërdrejtë në shmangien e pasojave sociale, ekonomike dhe ekologjike në zonën e administrimit të saj.

Menjëherë e në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Qeveria Shqiptare ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në përputhje me direktivën e BE.

Nga auditimi u konstatua se, për Qarkun dhe Bashkinë Vlorë nuk gjenden gjurmë ku të jenë përgatitur dhe miratuar vlerësimi i riskut në nivel Qarku dhe në nivel Vendor jo më pak se një herë në tre vjet. Gjithashtu, të gjitha institucionet e tjera përgjegjëse, si ato qendrore dhe lokale, nuk kanë realizuar studimin për menaxhimin e riskut në nivel kombëtar, i cili duhet të përshtatet me kushtet klimaterike aktuale, të cilat kanë pësuar ndryshime të dukshme gjatë viteve të fundit. Mos vlerësimi i riskut nga institucionet përgjegjëse është në kundërshtim me ligjin 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, datë 18.07.2019, kreu II, nenet 8-14. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 66-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: AKMC në koordinim me institucionet e tjera përgjegjëse, të kryej Planin e Menaxhimit nga Përmbytjet (PMP) si dhe Vlerësimin e Riskut nga Përmbytjet (VRP), për Qytetin e Vlorës si një rast pilot, duke bërë një analizë të thelluar me kushtet aktuale të territorit dhe klimaterike, të cilat kanë pësuar ndryshime të theksuara vitet e fundit për ti dhënë një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë. Zbatimi i PMP të vihet në fuqi pas marrjes së opinionëve, miratimeve, vlerësimeve, etj. zyrtare nga subjektet përgjegjëse që janë faktor kryesor në realizimin e infrastrukturës së nevojshme për parandalimin dhe përballimin e përmbytjeve.

Menjëherë e në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit (DUK) Fier nuk ka hartuar dhe miratuar plane mujore për veprimtarinë e institucionit dhe planet mujore sipas sektorëve për vitin 2023. Për vitin 2024 janë hartuar planet mujore sipas sektorëve, por nuk rezultojnë të miratuara nga Titullari i Institucionit, por vetëm nga Përgjegjësi i Sektorit përkatës, duke mos respektuar kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Bujqësisë nr.12, datë 30.12.2019 dhe në Rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e DUK Fier”, neni 9 dhe neni 10 (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 23-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier në bashkëpunim me sektorët e varësisë, të marrë masa në vijimësi, për hartimin dhe miratimin e planeve mujore të institucionit dhe sektorëve përkatës, me qëllim përmbushje të kërkesave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë e në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se DUK Fier në Sektorin Vlorë, ka në administrim 6 skema kullimi, konkretisht: - Skema e kullimit Myzeqe e cila ka 12 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 26 km; - Skema e kullimit Myzeqe Hidrovor Akërni, e cila ka 9 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 45 km; - Skema e kullimit Hidrovor Goricë, e cila ka 7 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 22 km; - Skema e kullimit Llakatund VLK4, e cila ka 6 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 18 km; - Skema e kullimit Llakatund VLK5, e cila ka 11 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 23 km; - Skema e kullimit Dukat-Tragjas, e cila ka 25 kanale kryesore kulluese me gjatësi totale 34.3 km. Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion, rezultoi se nuk janë pastruar për një periudhë mbi 10 vjeçare, në total 66 kanale me gjatësi 133 km.

Gjithashtu referuar akt-konstatimeve të mbajtura nga grupi i punës në Sektorin Vlorë gjatë verifikimeve dhe inspektimeve në terren me datat 14.03.2023, 24.11.2023 dhe 28.03.2024, u konstatua se: Kanali kullues KK3 Akërni, Kanali kullues KUL Orikum dhe Kanali kullues KK2 Akërni, rezultuan **më shumë se 15 vjet të pa pastruar**. Sektori Vlorë i është drejtuar DUK Fier, me shkresat: datë 28.10.2023, datë 25.08.2024 dhe datë 14.02.2024, “Mbi gjendjen e objekteve të mbrojtjes dhe kullimit dhe masat që duhen marrë për përballimin e sezonit të dimrit”. Nga këto raportime, ka rezultuar se shumë objekte kanë pasur problematika që kërkojnë ndërhyrje për të siguruar mbrojtjen e argjinaturave dhe rehabilitimin e kanaleve kulluese. Mungesa e mirëmbajtjes vjetore e të gjithë sistemit të kullimit është një nga shkaktarët

kryesorë të këtyre problemeve, duke theksuar edhe mungesën e kapaciteteve teknike, pasi në Rajonin e Vlorës disponohet vetëm një mjet eskavator për pastrimin e kanaleve. Mos kryerja e proceseve të mirëmbajtjes vjetore në të gjithë sistemin e kullimit, është në kundërshtim me përcaktimet në Udhëzimin e Ministrit nr.12, datë 30.12.2019 dhe në Rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e DUK Fier”, neni, pika 1 “Mirëmbajtja”. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 23-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, Sektori Vlorë dhe sektorët e tjerë të varësisë, të marrin masa për të realizuar pastrimin e plotë të kanaleve kulluese dhe sigurimin e argjinaturave, duke përcaktuar më parë objektet më prioritare që do t’i nënshtrohen procesit të pastrimit dhe mirëmbajtjes. Realizimi në kohë i këtyre proceseve ndikon pozitivisht në rritjen e gatishmërisë për përballimin e situatave, që krijohen nga reshjet me intensitet të lartë dhe minimizimin e riskut të përmbytjeve.

Deri më datë 31.09.2025

13.2 Rekomandimi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier të marrë masa, për të rritur kapacitetet teknike dhe mjetet e punës në sektorët e varësisë, në veçanti në Sektorin e Vlorës, për të realizuar në kohë dhe me cilësi, kryerjen e punimeve për mirëmbajtjen vjetore në të gjithë sistemin e kullimit.

Deri më datë 31.09.2025

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se DUK Fier kryen inspektime rutinë, por mungon dokumentacioni justifikues për kryerjen e inspektimeve për dy periudha të vitit 2024 Prill-Maj dhe Shtator-Tetor. Konkretisht, mungojnë procesverbalet përkatëse lidhur me kontrollet e punimeve të kryera në mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, remonteve të hidrovoreve, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së plotë të argjinaturave mbrojtëse të lumenjve dhe funksionaliteti i infrastrukturës së kullimit sipas projekteve teknike, për periudhën e pritshme me reshje. Gjithashtu, administrohen procesverbale kontrolli për pjesën e poshtme të rrjedhës, detyrë që duhet bërë tri herë në vit, me qëllim konstatimin e pengesave të shkarkimeve dhe marrjen e masave për shkarkim normal të ujërave.

Sa më sipër veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit nr.12 datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit” dhe Rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e DUK Fier”. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 23-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier dhe sektorët e varësisë, të marrin masa për kryerjen e inspektimeve të vazhdueshme, veçanërisht në dy periudhat vjetore të përcaktuara, duke dokumentuar plotësisht gjendjen e objekteve të inspektuara pas kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes, në koherencë me periudhat e reshjeve stinore. Gjithashtu, të kryhen kontrole 3 herë në vit, duke i dokumentuar, lidhur me gjendjen e poshtme të rrjedhës, me qëllim marrjen e masave për shkarkim normal të ujërave.

Menjëherë e në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se DUK Fier nuk ka hartuar regjistrat e shfrytëzimit, ku plotësohen të dhënat përkatëse për mbikëqyrjet, vrojtimit, matjet, duke shënuar mbushjet, zbrazjet, shkarkimet, manovrimet e portave, matjet, kontrollet e incidenteve që konstatohen, (filtrime, rrjedhje uji, plasaritje, etj.), ngjarjet hidrometeorologjike të veçanta, lëkundje sizmike dhe pasojat e tyre, punimet e mirëmbajtjes, përmirësimet dhe riparimet e kryera. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit nr.12 datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për

mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit” dhe Rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e DUK Fier”. (Trajtuar më hollësisht në pikën .5, faqe 23-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier të marrë masa për hartimin e regjistrave të shfrytëzimit (elektronikë dhe manual), si dhe plotësimin e tyre në vijimësi me të dhënat përkatëse.

Menjëherë e në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se nga DUK Fier, Sektori i Hidrovorëve, nuk administrohen procesverbale formale në lidhje me kontrollet dhe inspektimet e ushtruara në hidrovore, ku mbi bazën e gjendjes së konstatuar përcaktohen nevojat për remonte vjetore të tyre, por të dhënat pasqyrohen në formë “shënimesh” në blloqe.

Gjithashtu, rezulton se niveli i tensionit në Hidrovorin Akërnë nuk është i qëndrueshëm, pasi në linjën e furnizimit të hidrovorit marrin energji subjekte private, duke ndikuar në uljen e kapacitetit të punës së hidrovorit. Për të krijuar vijimësi të punës së hidrovorit duhet që të furnizohen me dy linja elektrike paralele, gjë e cila nuk është realizuar. Sa më sipër veprime në kundërshtim me në Udhëzimin e Ministrit nr.12 datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 23-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, Sektori i Hidrovorëve, të marrë masa të kryejnë inspektime të vazhdueshme lidhur me gjendjen teknike të hidrovorëve, duke dokumentuar në formë shkresore të dhënat që konstatohen si dhe të përcaktojë nevojat për remonte vjetore të tyre. Gjithashtu, të merren masa për të realizuar dy linja elektrike paralele që furnizojnë hidrovorin, si dhe përmirësimin e nivelit të tensionit në Hidrovorin Akërnë, duke kryer shkëputjen e të gjithë lidhjeve të subjekteve private nga linja e energjisë së furnizimit të hidrovorit.

Menjëherë e në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrit të aseteve të DUK Fier u konstatua se, asetet mbi të cilat është vendosur sistemi kullues dhe i mbrojtjes nga përmytjet, së bashku me strukturat përkatëse, nuk janë regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Sa më sipër, veprime në kundërshtim të Ligjit nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit nr. 24/2017, datë 09.03.2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 23-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrin masa për të vijuar procesin e regjistrimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme, të aseteve së bashku me strukturat përkatëse, mbi të cilat është vendosur sistemi kullues dhe i mbrojtjes nga përmytjet.

Deri më datë 31.09.2025

18. Gjetje nga auditimi: Në Vlorë derdhen në det në total **13 kanale të ujërave të zeza si dhe 2 kanale të ujërave të bardha por të ndotura**. Në bregdetin e Zvërnecit derdhen 4 kanale të ujërave të zeza si dhe 1 i ujërave të bardha të ndotura. Në bregdetin e plazhit të vjetër derdhen 4 kanale të ujërave të zeza, si dhe në zonën e Lungomares derdhen 5 kanale të ujërave të zeza, (3 në pjesën e fillimit të saj, dhe 2 kanale të ujërave të zeza tek zona e “Ish Akademisë së Marinës”), si dhe 1 kanal i ujërave të bardha të ndotura pranë “Ish Akademisë së Marinës”.

Ujërat e zeza përpara se të vijnë në det nuk janë të trajtuara. Këto kanale në pjesën dërmuese të tyre **nuk janë të pastruara për më shumë se 30 vjet** me justifikimin se, shkak për mospastrimin e tyre janë ndërtimet pa leje, të cilat në shumë vende kanë zvogëluar hapësirën “prerjen tërthore” të kanaleve. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 6, faqe 33-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë të marrë masat për ngritjen e një grup pune me specialistë nga **Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bordi i Ujitjes dhe Kullimit dhe “URUKV” SHA** për identifikimin e:

- të gjitha ndërtimeve të ngritur brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të kullimit të ujërave sipas legjislacionit në fuqi, si dhe pjesëve të dëmtuara të sistemit të kullimit me qëllim kthimin në gjendjen e tij funksionale.

- të gjitha kanalizimeve të ujërave të ndotura që derdhen në sistemet kryesore të kullimit të ujërave.

Në përfundim, të hartohen regjistrat përkatës, planimetritë që tregojnë zonën nën shërbimin e ujitjes dhe të kullimit, inventarin e pasurive, regjistrin e kontratave të mirëmbajtjes, rehabilitimit dhe ndërtimit të infrastrukturës, regjistrin për inspektimet në infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe veprave të mbrojtjes nga përmytja.

Menjëherë

18.2 Rekomandimi: Bashkia Vlorë të kërkojë nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë, të marrë masa duke nxjerrë urdhër kufizimi për objektet që rezultojnë të jenë legalizuar në kundërshtim të përcaktimeve të kuadrit ligjor duke cenuar infrastrukturën publike brenda brezit mbrojtës të sistemeve kryesore të ujitjes dhe kullimit.

Menjëherë e në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga vlerësimi që grupi i auditimit i ka bërë situatës së shkaktuar nga përmytjet masive në qytetin e Vlorës, u konstatua se ka dy zona problematike, të cilat përmytjen edhe me reshje mesatare dhe konkretisht, zonat që në gjuhën vendore quhen “Albano dhe Romina” dhe “Kisha Ortodokse”. Nga ana Bashkisë Vlorë dhe “SHRUKV” SHA, nuk ka ndonjë projekt të mirëfilltë për investim thelbësor në këto dy zona. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 33-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me “SHRUKV” SHA, të marrin masa të menjëhershme, duke i kërkuar edhe institucioneve qendrore që mbulojnë problemet e infrastrukturës (MIE dhe AKUM), hartimin e një projekti për infrastrukturën nëntokësore, me qëllim zgjidhjen përfundimtare të përmytjeve në këto dy zona problematike.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Nga gjashtë Stacionet e Pompimit të Ujërave të Ndotura, tre kanë dalje emergjente në det në rastet që ka reshje të dendura. Për të zvogëluar përmasat e përmytjes, (fenomen i ndodhur edhe më datë 04.10.202), në Impianti e Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) Vlorë, ka pasur ndërprerje të financimeve të huaja. Projekti ka probleme të dukshme në tërësinë e tij dhe nuk ka realizuar objektivat e kontratës së nënshkruar të cilat janë vendosja në efikasitet të plotë e pompave në rastet emergjente. Në projektin fillestar, të financuar nga fondet IPA të BE-së, parashikohej ndërtimi i një impianti për trajtimin e ujërave të ndenjura. Ky impiant u ndërtua, por fatkeqësisht nuk e kryen funksionin për të cilin ishte dhënë financimi nga BE, pasi nuk është kryer sipas një projekti që do të jepte zgjidhje përfundimtare por vetëm remont i tij. Ai funksionon vetëm për largimin e mbetjeve mekanike dhe yndyrat/vajrat nga ujërat e ndotura por jo nga elementët kimikë dhe bakteriologjikë, që janë problemi kryesor i ndotjes së ujërave që derdhen në det.

ITUN funksionon me gjysmën e kapaciteti, dhe në kohën kur nuk përballon prurjet në stacion (që nuk janë vetëm të ndotura por edhe të bardha) derdhen në vaskën e thithjes së hidrovorit. (Trajtuar më hollësisht në pikën 5, faqe 33-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1 Rekomandimi: Bashkia Vlorë dhe “SHRUKV” SHA në bashkëpunim me MIE dhe me ministritë e tjera të linjës, të përdorin të gjitha rrugët tekniko-ligjore që rrjeti i kanalizimeve dhe stacionet e pompimit të jenë funksionale me kapacitetin e plotë të tyre, duke përdorur me efikasitet fondet e donatorëve dhe buxhetin e shtetit për investime kapitale, bazuar në vlerësimin e nevojave sipas masterplanit kombëtar dhe nevojave që vijnë nga qeverisja vendore. Ndërhyrja për përmirësimin dhe funksionimin e rrjetit të kanalizimeve të shkarkimeve të lëngëta, në zonat urbane, duke respektuar kriteret e mbrojtjes së mjedisit, është nevojë e domosdoshme.

Menjëherë e në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE

B.1 Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 135 “Të drejtat dhe detyrimet”, pika 2.c dhe neni 157 “Shkarkimi”, pika 1, të Ligjit nr. nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, i rekomandojmë Asamblesë së Përgjithshme të “SHRUKV” SHA (Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Kryetarit të Bashkisë Vlorë, Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe Kryetarit të Bashkisë Selenicë) vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe marrjen e masës “Shkarkim nga detyra” për:

1. **Z. J.Gj.** - (Kryetar)
2. **Znj. A.D.** - (Anëtar)
3. **Znj. A.Ç.** - (Anëtar)
4. **Z. O.D.** - (Anëtar)
5. **Z. J.Gj.** - (Anëtar)
6. **Znj. E.T.** - (Anëtar)
7. **Znj. N.A.** - (Anëtar)
8. **Z. S.K.** - (Anëtar)

Në cilësinë e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të “SHRUKV” Sha, nuk kanë dëgjuri të plotë për veprimtarinë e institucionit, fushat ku vepron dhe detyrat e tij; nuk kanë marrë masat e nevojshme nëpërmjet vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës për përmirësimin e veprimtarisë së “SHRUKV” SHA dhe në veçanti të sistemit të kullimit të qytetit të Vlorës.

B.2. Për punonjësit me kontratë pune.

Bazuar në nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, I rekomandojmë Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe marrjen e masës disiplinore “**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna**”, për:

1. **Th. S.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë të Ujitjes dhe Kullimit Fier (DUK) nuk ka zbatuar detyrat funksionale, në territorin që mbulon, lidhur me marrjen e masave për të kryer inspektimin në periudhën Shtator - Tetor 2024, për kontrollet e punimeve të kryera në mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, remonteve të hidrovorëve, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së plotë të argjinaturave mbrojtëse të lumenjve dhe funksionaliteti i infrastrukturës së kullimit sipas projekteve teknike, për periudhën e pritshme me reshje, veprime në mospërputhje me pikën Neni 13 të ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, pikën 4 të VKM nr. 437, datë 17.5.2017 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë”, dhe pikën 2.3.3 të Udhëzimit të Ministrit të MBZHR nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”.

B.3 Bazuar në nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i rekomandojmë Drejtorit të DUK Fier vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe marrjen e masës disiplinore “**Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna**”, për:

1. V.H., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Vlorë, DUK Fier, pasi nuk ka zbatuar detyrat funksionale, në territorin që mbulon me aktivitet Sektori Vlorë, lidhur me marrjen e masave për të kryer inspektimin në periudhën Shtator - Tetor 2024, për kontrollet e punimeve të kryera në mirëmbajtjen e kanaleve kulluese, remonteve të hidrovoreve, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së plotë të argjinaturave mbrojtëse të lumenjve dhe funksionaliteti i infrastrukturës së kullimit sipas projekteve teknike, për periudhën e pritshme me reshje.

C. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

C.1. Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat që kanë kryer respektivisht detyrën e administrator dhe kryetar/anëtar të këshillit mbikqyrës e aktualisht nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre, Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte: “Shkarkim nga detyra” për:

1. **Z. S.K.**
2. **Znj. E.H.,**
3. **Z. Sh.L.**
4. **Z. D.Xh.,** në cilësinë e administratorëve.
5. **Z. Z.S.**
6. **Z. T.Z.**
7. **Z. N.V.** në cilësinë e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

VI. ANEKSET

Aneksi nr. 1: Lista e kanaleve të kullimit

Emertimi i skemes se kullimit	Siperfaqja qe kullon	Gjatesia kanalit	Ne administrim BRK	
		Ha	Km	Pare/Kolektore
	Total			
	Totali Vlorë			
	Kullimi Myzeqe	1,100	26	1
	Kanali Kryesore		26	
1	K. K-1		10.5	12 vjet
2	K - 5		1.5	
3	K - 1		1	
4	K - 2		1.2	
5	K - 23		1.3	
6	K - 3		0.9	
7	K - 13		1.8	
8	K - 14		2	
9	K - 15		1.5	
10	K - 26		1.5	
11	K - 29		2	
12	K - 30		0.8	
	Kullim Myzeqe me Hid. Akerni	4,500	45	1

	Kanali Kryesore		45	
1	KK - 2		13	përfunduar
2	KK - 3		9.6	përfunduar
3	KK - 4		6.5	Viti 2008
4	K - 20		1.5	
5	K - 21		1.1	
6	K - 22 (paralel me rrugen e hid. Akerni)		2.2	
7	K - 23		6.4	
8	KK - 24		4.7	
9	<i>Perroi I Coballareve</i>			
	Kullim me Hid. Gorice	1,050	22	1
	Kanali Kryesore		22	
1	Gorice Right		4.5	
2	Gorice Left		3	
3	KUL Panaj		5	I bërë
4	KUL Left		3	
5	K.M. Hid Qyt		2	
6	KBD		1.7	
7	KM - 1		2.8	
	Kullimi Lllakatund VLK 4	1,600	18	1
	Kanali Kryesore		18	
1	Babice		3.7	
2	Ceprati		3.5	
3	Lllakatund (<i>perroi Lllakatund</i>)		2	
4	Mekatit		1.8	
5	KK - 3		3.5	
6	KK - 4		3.5	
	Kullimi Lllakatund VLK 5	1,200	17+6	1
	Kanali Kryesore		17	
1	K - 1 Ar		0.8	
2	K - 2 Ar		1.15	
3	K - 3 Ar		2.25	
4	K - 4 Ar		1.75	
5	K - 5 Ar		2.35	
6	K - 6 Ar		2.4	
7	K - 7 Ar		2.4	
8	K - 8 Ar		1.05	
9	K - 9 Ar		1.25	
10	K - 10 Seleni		1.6	
11	<i>Perroi I Otimes Armen</i>		6	I bere
	Dukat-Tragjas	1,800	34.3	1
	Kanali Kryesore		34.3	
1	Right Br. Orikum		3	Bere 0.8 km
2	Left Br. Orikum		2.5	
3	K. Per Gimar		3.5	
4	KUL BM		2.4	
5	KUL BD		2.5	
6	KUL TRA		2	
7	TR 1		1.1	
8	TR - 2		0.7	
9	TR - 3		2	
10	TR - 4		0.8	
11	TR - 2D		1.9	
12	TR - 3D		1.5	
13	TR - 4D		0.8	
14	5 - A		0.8	
15	KK - 11		1.2	
16	KK - 12		1.1	
17	KK - 21		1	
18	KK - 31		1	
19	BM - 1		0.6	
20	BM - 2		0.5	
21	BM - 3		0.6	
22	BM - 4		0.7	
23	KK - 6		0.7	
24	KK - 7		0.7	

Aneksi nr. 2: Kanalet e planifikuara dhe të pastruara për vitet 2023, 2024

Planifikimi i objekteve për Vlorën - viti 2023

Nr.	Objektet	Plan			Bashkia	NJ. AD
		Volum m ³	Gjatësi ml	Sip. ha		
2	KK3 Myzeqe	35,000	4,776	4,600	Vlorë	Novoselë
4	KKP Bunavi Llakatund	28,000	3,500	800	Vlorë	Shushicë
5		63,419	1,417	1,100	Selenicë	Selenicë
	SHUMA	126,419	9,693			

Realizimi viti 2023

Nr	Objektet	Realizim		
		Sip. ha	Volum m ³	Gjatësi ml
1	KK3	4,600	48,451	4,449
2	KKL Oriku	1,300	7,345	506
3	K. Uj. Llakatund	1,000	4,477	3,800
4	K.Uj. Armen	1,200	2,868	2,700
5	V.M Llakatund	1,000	7,126	574
6	V.M Armen	1,200	12,646	823
	Emergjencia		19.06.2023	
1	V.M Armen	1,200	1,390	70
2	V.M Llakatund	1,000	1,608	110
	Emergjencia		01.07.2023	
1	V.M Armen	1,200	2,043	130
2	V.M Llakatund	1,000	600	70
	Emergjencia		18- 25.08.2023	
1	V.M Llakatund	1,000	2,221	60
	SHUMA		90,775	13,292

Planifikimi i objekteve për Vlorën - viti 2024

Nr	Objektet	Plan			Bashkia	NJ. AD
		Volum m ³	Gjatësi ml	Sip. ha		
1	KK2 Myzeqe	21,000	3,000	4,600	Vlorë	Novoselë
2	KK3 Myzeqe	107,000	596	4,600	Vlorë	Novoselë
3	KKP i dërgimit Akërn	1,666	80	4,600	Vlorë	Novoselë
4	KKP Bunavi	28,000	3,500	800	Vlorë	Bunavi
5	KKP Otimes Armen	63,419	1,417	1,100	Selenicë	Armen
	SHUMA	221,085	8,593			

Realizimi viti 20234

Nr	Objektet	Realizim		
		Sip. ha	Volum m ³	Gjatësi ml
1	K. Uj. Llakatund	800	8,107	5,700
2	K.Uj. Armen	1,200	17,785	12,750
3	KK3 Akërn	4,600	10,626	596
4	KK2 Akërn	4,600	20,606	2,975
5	V.M Armen	1,200	15,738	1,180
6	V.M Llakatund	1,000	12,129	960
7	KK i dërgimit Akërn	4,600	1,666	80
	Emergjencia			
8	V.M Llakatund e Armen	1,200	2,283	70
9	V.M Llakatund	1,000	1,628	150
10	V.M Llakatund	1,200	555	30
			91,123	24,491

Aneksi nr. 3: Lista e kanaleve të hapura dhe tubacioneve të mbyllura kaluar në UK Vlorë

Nr.	Emërtimi	Adresa	Gjatësia
1	Kanal i hapur trapez, tek hidrovori dhe në vazhdim kanali i fushës Pk1 – Pk6	Te Hidrovori – ish fuSHA e aviacionit	1,610 ml
2	Kanal i hapur te ish fush e aviacionit Pk7 – Pk10	Te Hidrovori – ish fuSHA e aviacionit	2,350 ml
3	Kanal i hapur trapez, te ish fush e aviacionit Pk5 – Pk12 + Degëzime	Te Sh. Sorosi	2,180 ml
4	Kanal i hapur trapez nga Rr. “Miss Durhan” e në vazhdim + degëzimet Pk13 – Pk16 – Pk 17, Kanali Naunkës	St. Trenit - Rr. “Miss Durhan”	1,940 ml
5	Kanal i hapur trapez, në lagjen “10 Korriku”, Pk35 - Pk39	L. “10 Korriku”	700 ml
6	Kanal i hapur, Përroi tek ish F. Çimentos PK37 - Pk38	Ish F. Çimentos	1,300 ml
7	Tubacion me qemer D = 1500; S2.03 Pik 6 – Pk21; mbyllur; Viti i ndërtimit 1940	K. Fushës – Kryqëzim – Mesht	1,050 ml
8	Tubacion me qemer D = 1200; S 1.2 m ² Pik14 – Pk18; mbyllur; Viti i ndërtimit 1940;	Rr. “Adriatik”	360 ml
9	Tubacion me qemer D = 1200; S1.2 m ² Pik21– Pk22; mbyllur; Viti i ndërtimit 1940	Ish - Gjyqi	420 ml
10	Tubacion me qemer D=1100; S1.78 m ² Pik3 – Pk24 960ml; myllur; Viti i ndërtimit 1940	Rr. e Drashovicës	960 ml
11	Tubacion me qemer D = 1200; S1.12 Pik25 – Pk26; mbyllur; Viti i ndërtimit 1940	Rr. “Bashkia”	480 ml
12	Tubacion me qemer D = 1200; S1.12 Pik27 – Pk28; mbyllur; Viti i ndërtimit 1940;	Topana	470 ml
13	Tubacion me qemer D = 1200; S1.12 Pik29 – Pk30; mbyllur; Viti i ndërtimit 1940	Topana – Mesht	280 ml
14	Tubacion me qemer D = 1500; S 1.78 Pik21 – Pk32, mbyllur; Viti i ndërtimit 1940	Topana	550 ml
15	Tubacion me qemer D = 1500; S1.78 Pik21 – Pk32; mbyllur; Viti i ndërtimit 1940	K. Fushës – Kryqëzim – Mesht	530 ml
16	Tubacion rrethor D = 1500; S203 Pik18 – Pk35; mbyllur; Viti i ndërtimit 1940	Adriatik	1,150 ml
17	Kanal i Ujërave të larta, i hapur; Pk1 - Pk2 - Pk3 - Pk4;	Nga Hidrovori deri te ish Parku i Mallrave	700 ml
18	Kanal i mbuluar i ujërave të larta me panele Z/A HD = 4.5 m; Soletina Pk4 - Pk19;	Lirim –Taverna	5,700 ml
19	Kanal i ujërave të Larta, Trapezoidal betonuar muret dhe shtresa poshtë Pk19 - Pk20 i hapur;	Nga Taverna - te Spitali	1,600 ml
20	Kanal i ujërave të Larta, trapezoidal i veshur me beton tek Pik34 - Pik35, i hapur;	Rr. Kalldremit - Ura K. Kolloqifit	900 ml
21	Kanal i ujërave të Larta, i betonuar me soletina përsipër me dy seksione Pik35 - Pik 36; i mbuluar;	Rr. “Ura” - det	460 ml
22	Tubacion B/Arme D = 2000 mm kryesor që derdhet në K/Fushës Pk6 - Pk18, i mbuluar;	St. Trenit - H. Fushë	900 ml
23	Tubacion K.U.B D = 1,000mm, Pik34 - Pik 40 (në aks të rrugës); i mbyllur	Kinoteatri - Bisht i Kalldrëmit	700 ml
Në total janë 18,360 ml kanale të hapura dhe 8,670 ml kanalet të mbyllura			

Aneksi nr. 4: Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit, Bashkia Vlorë

Tabela 1 - Transferimi i skemave ujëtare te Bashkia Vlorë

Bashkia	Skema Ujtëse/Kodi	Emërtimi	Burim Ujor	Kanale të I dhe të II Km	Kanale I Km
Vlorë	VLU-3	Llakatund - Selenicë	Lumi Shushica +stp		114
Vlorë-	VLU-10	Kallafet Rezervuar	Rezervuar (Kallafet)	34	
Vlorë-	VLU-9	Babicë (Rezervuar)	Rezervuar (Babicë)	43	

Vlorë-	VLU-2	Myzeqe e Vlorës	Stp. Mifol nr.2, Panaja, Zvërnec, Bestrovë	85	
Vlorë-	VLU-57	Jonufër kanal	Lumë (Izvor)	8	
Vlorë-	VLU-1	Myzeqe e Vlorës	Stp. Mifol nr. 1	208.3	
Vlorë-	VLU-6	Dukat - Tragjas	Lum+Stp	71.1	
Vlorë-	VLU-8	Bunavis Rezervuar	Rezervuar (Bunavis)	7	
Vlorë-	VLU-11	Kaninë Rezervuar 1	Rezervuar (Kaninë 1)	3	
Vlorë-	VLU-12	Kaninë Rezervuar 2	Rezervuar (Kaninë 2)	2	
Vlorë-	VLU-17	Bestrovë	Rezervuar	9	
Vlorë-	VLU-48	Sherishtë ST. Pomp.	Lumë (Kallafet)	6	
Vlorë-	VLU-49	Risili St. Pomp.	Kanal (Penkovë)	9	
Vlorë-	VLU-52	Izvor St. Pomp.	Lumë (Izvor)	2.8	
Vlorë-	VLU-53	Jonufër St. Pomp.	Kanal (Jonufër)	1.2	
Vlorë-	VLU-V4	Ekonomite		25	
		TOTAL	15 pasuri	514	114

Tabela 1/1 - Tabela për transferimin e infrastrukturës së kullimit (Sipas Skemave Kulluese)

Bordi Kullimi	Bashkia	Emërtimi i skemës së kullimit	Sip. Që kullon (e projektuar) Ha	Kanale të I	Kanale të II	Kanale të III
QË ndodhen në territorin e Bashkisë Vlorë						
49	Vlorë	Kullimi Myzeqe	1,100		1	1
50	Vlorë	Kullimi Myzeqe me Hid. Akërn	4,500		1	1
51	Vlorë	Kullimi me Hid. Goricë	1,050		1	1
52	Vlorë	Kullimi LLakatund VLK 4	1,600		1	1
53	Selenicë	Kullimi LLakatund VLK 5	1,200		1	1
54	Vlorë	Dukat-Tragjas	1,800		1	1

Aneksi nr.5: Grafiku i punimeve

ID	Task Name	Baseline Duration	Duration	Baseline Start	Start	Baseline Finish	Finish
1	WS VLORA Time Schedule 12-02-2024_Rev.0	630 days	630 days	Mon 12/11/23	Mon 12/11/23	Sun 8/31/25	Sun 8/31/25
2	Rehabilitation Works for the Water Supply System of Vlora, Albania; BMZ-Nr. 2013 66	630 days	630 days?	Mon 12/11/23	Mon 12/11/23	Sun 8/31/25	Sun 8/31/25
3	COMMENCEMENT DATE	0 days	0 days	Mon 12/11/23	Mon 12/11/23	Mon 12/11/23	Mon 12/11/23
4	Mobilization	480 days	473 days	Mon 12/11/23	Mon 12/11/23	Thu 4/3/25	Thu 3/27/25
5	Installation of temporary site fence, site offices, storages, toilets,	28 days	28 days	Mon 12/11/23	Mon 12/11/23	Sun 1/7/24	Sun 1/7/24
6	Checking Benchmarks and Topographical data	10 days	10 days	Mon 1/8/24	Mon 1/8/24	Wed 1/17/24	Wed 1/17/24
7	Checking Design and all drawings	30 days	30 days	Sat 12/16/23	Sat 12/16/23	Sun 1/14/24	Sun 1/14/24
8	Utility Connections	15 days	15 days	Tue 12/26/23	Tue 12/26/23	Tue 1/9/24	Tue 1/9/24
39	DMA 02	352 days	447 days	Sat 2/17/24	Sat 2/17/24	Sun 2/2/25	Thu 5/8/25
40	Setting out of the pipeline axis; Submission & Approval of the Shop drawings	14 days	14 days	Sat 2/17/24	Sat 2/17/24	Fri 3/1/24	Fri 3/1/24
41	Delivery to the Site of Pipe And Fittings	30 days	30 days	Fri 5/31/24	Fri 5/31/24	Sat 6/29/24	Sat 6/29/24
42	SUMMER BREAK	93 days	93 days	Sat 6/15/24	Sat 6/15/24	Sun 9/15/24	Sun 9/15/24
43	Excavation and Installation of Pipe and Fitting	152 days	152 days	Mon 9/16/24	Mon 9/16/24	Fri 2/14/25	Fri 2/14/25
44	Demolition of the road layers	145 days	145 days	Mon 9/16/24	Mon 9/16/24	Fri 2/14/25	Fri 2/7/25
45	Excavation & disposal of surplus material	145 days	145 days	Mon 9/16/24	Mon 9/16/24	Fri 2/14/25	Fri 2/7/25
46	Realization of bedding layer	145 days	145 days	Mon 9/16/24	Mon 9/16/24	Fri 2/14/25	Fri 2/7/25
47	Installation of Pipe OD 63-315, Tot L=8,85	145 days	145 days	Mon 9/16/24	Mon 9/16/24	Fri 2/14/25	Fri 2/7/25
48	Mechanical works & House Connections	152 days	152 days	Sat 9/21/24	Mon 9/16/24	Fri 2/14/25	Fri 2/14/25
49	Installation of 407 HC Type A-D	150 days	150 days	Sat 9/21/24	Mon 9/16/24	Wed 2/12/25	Wed 2/12/25
50	Installation of WMB and Water Meter	33 days	33 days	Mon 1/13/25	Mon 1/13/25	Fri 2/14/25	Fri 2/14/25
51	Infrastructure Crossing	61 days	61 days	Mon 12/9/24	Mon 12/9/24	Fri 2/7/25	Fri 2/7/25
52	Backfill of the trench and temporary road reinstatement	145 days	145 days	Mon 9/16/24	Mon 9/16/24	Fri 2/7/25	Fri 2/7/25
53	Testing and disinfection of the pipeline	30 days	40 days	Wed 1/29/25	Wed 1/29/25	Sun 3/9/25	Sun 3/9/25

75		DMA 04	325 days	433 days	Fri 2/2/24	Thu 2/8/24	Sun 12/22/24	Tue 4/15/25
76	✓	Setting out of the pipeline axis; Submission & Approval of the Shop drawings	15 days	15 days	Thu 2/8/24	Thu 2/8/24	Fri 2/16/24	Thu 2/22/24
77	✓	Delivery to the Site of Pipe And Fittings	20 days	68 days	Fri 2/9/24	Thu 2/8/24	Thu 3/7/24	Mon 4/15/24
78	✓	SUMMER BREAK	93 days	93 days	Sat 6/15/24	Sat 6/15/24	Sun 9/15/24	Sun 9/15/24
79		Excavation and Installation of Pipe and Fitting	240 days	240 days	Mon 2/19/24	Mon 2/19/24	Tue 10/15/24	Tue 10/15/24
80	☒	Demolition of the road layers	240 days	276 days	Mon 2/19/24	Mon 2/19/24	Wed 11/20/24	Wed 11/20/24
81	☒	Excavation & disposal of surplus material	240 days	276 days	Mon 2/19/24	Mon 2/19/24	Wed 11/20/24	Wed 11/20/24
82	☒	Realization of bedding layer	240 days	276 days	Mon 2/19/24	Mon 2/19/24	Wed 11/20/24	Wed 11/20/24
83	☒	Installation of Pipe OD 63-315, Tot L=9,255	240 days	276 days	Mon 2/19/24	Mon 2/19/24	Wed 11/20/24	Wed 11/20/24
84		Mechanical works & House Connections	70 days	128 days	Wed 7/10/24	Mon 9/16/24	Tue 1/21/25	Tue 1/21/25
85	☒	Installation of 575 HC Type A-D	128 days	128 days	Wed 5/15/24	Mon 9/16/24	Tue 1/21/25	Tue 1/21/25
86	☒	Installation of WMB and Water Meter	56 days	56 days	Wed 7/31/24	Wed 11/27/24	Tue 12/10/24	Tue 1/21/25
87	☒	Infrastructure Crossing	34 days	34 days	Fri 10/18/24	Fri 10/18/24	Wed 11/20/24	Wed 11/20/24
88	☒	Backfill of the trench and temporary road reinstatement	140 days	320 days	Mon 2/19/24	Mon 2/19/24	Fri 1/3/25	Fri 1/3/25
89	☒	Testing and disinfection of the pipeline	30 days	30 days	Tue 1/21/25	Tue 1/21/25	Wed 2/19/25	Wed 2/19/25
90		Permanent Road reinstatement	35 days	35 days	Sat 12/21/24	Thu 2/20/25	Wed 3/26/25	Wed 3/26/25
91	☒	Disconnection of the old pipes and water	20 days	20 days	Thu 3/27/25	Thu 3/27/25	Tue 4/15/25	Tue 4/15/25

Aneksi nr.6: Shpërndarja dhe realizimi i fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile dhe investimeve infrastrukturore

Emertimi	Transferita te kushtezuara						Investime		
	Buxheti		Realizimi		Realizimi Perqindje		Buxheti	Realizimi	Realizimi Perqindje
	91707AB	91707AG	91707AB	91707AG	91707AB	91707AG			
VITI 2022	39,743,431	-	8,866,519	-	22%		20,380,248	20,338,506	100%
Bashkia Vlore	2,989,678	-	2,987,468	-	100%				
Bashkia Konispol	2,453,183	-	2,453,124	-	100%		20,380,248	20,338,506	100%
Bashkia Selenice	279,996	-	279,976	-	100%				
Bashkia Himare	17,829,390	-	-	-	0%				
Bashkia Finiq	1,078,882	-	1,078,849	-	100%				
Bashkia Sarande	13,045,170	-	-	-	0%				
Bashkia Delvine	2,067,133	-	2,067,102	-	100%				
VITI 2023	17,100,890	49,259,184	5,410,479	20,076,976	32%	41%	11,993,085	11,913,750	99%
Bashkia Vlore	9,000,000	16,294,994	2,499,953	2,406,336	28%	15%	-	-	
Bashkia Konispol	-	1,919,110	-	1,917,887		100%	41,742	-	0%
Bashkia Selenice	-	5,090,541	-	5,090,541		100%	11,951,343	11,913,750	100%
Bashkia Himare	2,400,934	15,000,000	852,516	-	36%	0%	-	-	
Bashkia Finiq	699,956	2,200,000	698,596	2,200,000	100%	100%	-	-	
Bashkia Sarande	5,000,000	6,651,982	1,359,414	6,360,000	27%	96%	-	-	
Bashkia Delvine	-	2,102,557	-	2,102,212		100%	-	-	
VITI 2024 8-mujori	24,602,634	42,930,717	5,890,206	-	24%	0%	83,148,678	-	0%
Bashkia Vlore	8,000,000	19,421,667	5,890,206	-	74%	0%			
Bashkia Konispol	-	1,871,183	-	-		0%	11,409,456	-	0%
Bashkia Selenice	1,913,203	3,000,000	-	-	0%	0%	21,476,784	-	0%
Bashkia Himare	5,652,470	10,000,000	-	-	0%	0%			
Bashkia Finiq	1,319,279	1,500,000	-	-	0%	0%	36,875,945	-	0%
Bashkia Sarande	7,717,682	5,000,000	-	-	0%	0%			
Bashkia Delvine		2,137,867				0%	13,386,493		0%
Totali 3 vite	81,446,955	92,189,901	20,167,204	20,076,976	25%	22%	115,522,011	32,252,256	28%

Aneksin nr. 7: Disa nga përmbytjet më të mëdha në Shqipëri

Koha e përmbytjeve	Lumenjtë që dalin nga shtrati	Vendi i përmbytur	Dëmtimet	Shkaku i përmbytjes
Dhjetor 1962 dhe Janar 1963	Lumi Drin dhe Buna	Niveli i ujit ishte rreth 80 cm edhe në qytet. Nënshkodra, Shkodra dhe Lezha ishin plotësisht të përmbytura	U përmbytën 70 mijë ha toka bujqësore dhe të gjitha qendrat e banuara që ndodheshin në këto zona, qytetet Shkodër, Lezhë, mbi 10 mijë njerëz u evakuan	Prurjeve të shumta të lumenjve Drin, Buna si dhe gjithë lumenjtë e tjerë në veri.
Shtator 1995-Janar 1996	Gjithë lumenjtë e Shqipërisë	Zonat Shkodër, Lushnjë, Krujë, Laç, Durrës, Lezhë dhe fshatrave përreth tyre	Përmbytjet në mbi 20 mijë hektarë të herëpashershme. U shndërruan në gërmadha shtëpi	Prurje të shumta të të gjithë lumenjve të

		ndjenë pasojat e mëdha të përmbytjeve.	banimi, në raste të veçanta duke marrë dhe jetë njerëzish, por edhe evakuime të shumta.	Shqipërisë në veri dhe në Jug të vendit.
22-30 Shtator 2002	Drini, Buna dhe Ishmi	Rreshjet e shumta, krijuan një situatë të rëndë për zonat e Milotit, Lezhës, Torovicës, Zadrimës e Shkodrës.	U përmbytën mbi 16.000 ha tokë bujqësore dhe u prekën 7500 familje. U evakuuan shumë familje nga zonat e përmbytura.	Rrëshet e shumta në të gjithë zonën veriore të Shqipërisë
Shkurt-Mars 2004	Drini, Buna, Ishmi	Zonat fshatare në Veri të Shqipërisë kanë pësuar dëme e vështirësi rikuperimi për vite me radhë	U përmbytën qindra hektarë tokë dhe u dëmtuan rreth 400 banesa.	Rrëshet të shumta në të gjithë zonën veriore të Shqipërisë
Dhjetorit 2005,	Dalja nga shtrati e lumit Vjosa	Preku kryesisht në zonat Jugore të Shqipërisë.	U përmbytën rreth 7000 hektarë dhe u dëmtuan rreth 350 banesa, biznese dhe qendra socialkulturore	Rrëshet të shumta në të gjithë zonën veriore të Shqipërisë
2010 -2011	Lumi Drin dhe Buna	Niveli i ujit ishte mbi 1 metër në qytet. Nënshkodra, Shkodra dhe Lezha ngjanin si Venecia	Situata u përsërit dy vjet rresht, ku të përmbytura do të rezultonin mbi 14000 hektarë tokë, 1200 godina e mbi 12 mijë njerëz u deshën të evakohen	Prurjeve të shumta në Drin tre hidrocentralet, Fierza, Komani, Vau i Dejës,që ndodhen përgjatë këtij lumi u detyruan të hapnin portat e shkarkimit
Shkurt 2015	Lumi Vjosë me burime nga Mali i Pindit në Jug. lumenjtë Devoll, Osum Seman	Fshatrat përgjatë rrjedhës së poshtme të Vjosës, si Mifol, Novoselë, Bishan, Fitore e Poro do të mbuloheshin nga uji.	9992.6 hektarë tokë, e përmbytur, 709 banesa të dëmtuara plotësisht ose pjesërisht nga vërshimi i Vjosës, 300 biznese, 16 shkolla dhe 10 ura të dëmtura, 3500 bagëti të mbytura	Shkak kanë qenë rrëshet e mëdha që prej maleve të Pindit e deri përgjatë gjithë luginës së Drinos dhe Luginës së Përmetit, Tepelenë, Mallakastër e Vlorë
29 Nëntor 2017	Lumi Vjosë me burime nga Mali i Pindit	fshatrat përgjatë rrjedhës së poshtme të Vjosës,	10622 hektarë tokë, 4700 banesa, 41 biznese, u dëmtuan 56 shkolla dhe 65 ura në të gjithë Shqipërinë.	Shkak kanë qenë rrëshet e mëdha që prej maleve dhe luginave si dhe vërshimit të të gjithë lumenjve e përrrenjve më të vegjël të Vjosës.
8-11 Janar 2021	Lumi Drin dhe Buna Lumi Vjosë me burime nga Mali i Pindit	Zonat Shkodër dhe Lezhë si dhe fshatrat përgjatë rrjedhës së poshtme të Vjosës	7450 hektarë tokë të përmbytur në veri dhe jug të vendit, banesa dhe biznese të dëmtuara, disa rrugë të bllokuara përkohësisht për rrëshqitje dherash; disa ura të dëmtuara rëndë.	Rrëshet e mëdha që gati njëjavore prej maleve dhe luginave. Vërshimi pothuaj i gjithë lumenjve e përrrenjve në gjithë hapësirën shqiptare.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT